



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
23 SHTATOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
23. SEPTEMBAR 2010. GODINE**

**SHTATOR – SEPTEMBRA
2010**

E enjte, 23 shtator 2010, ora 10:00

Drejton seancën: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Mund t'ia fillojmë seancës me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta, kur thuhet deri në 3 minuta, do të thotë, mund ta kryejë edhe për 2 minuta.

Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj - Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Është viti i tretë i kësaj qeverisje apo Qeverie të qeverisjes pa ligj, ku karakteristikat e mëposhtme tregojnë për karakterin qeverisës, i cili ka prodhuar këtë rrëmujë, ku shtetësia dhe sovraniteti i Kosovës po vijnë në pikëpyetje përditë.

Unë sot në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do t'i përmend tri karakteristika, të cilat tregojnë dhe flasin për karakterin qeverisës të kësaj Qeverie.

Karakteristikë e parë me të cilën identifikohet kjo Qeveri është që të punojë pa ligj, sidomos kur janë në pyetje tenderët. Po i referohem këtu insistimit që me çdo kusht, çdo tender që merret duhet të jetë për personat e preferuar, dhe kjo përveç se është korrupsion po bën që edhe sot, tri vjet pas pavarësisë së Kosovës, ne të kemi tabela të UNMIK-ut dhe jo tabela të Kosovës, dhe kjo krejt, sepse fituesi real i tenderit në fjalë asnjëherë nuk paska qëlluar të jetë i preferuari.

E dyta karakteristikë është mungesa e përgjegjësisë për shtet, dhe këtu do t'i referohem kodit të telefonisë. Kosova edhe sot, të nderuar deputetë, vazhdon të operojë me kod të Serbisë, edhe sot, tri vjet pasi që jemi shtet sovran dhe i pavarur. Derisa në janar të vitit 2005 në 100- ditshin e qeverisjes Haradinaj, atëherë kryeadministratori Soren Jessen Petersen kërkoi që të kemi kodin tonë të telefonisë, sot edhe tri vjet pas në Qeverinë Thaçi, ne vazhdojmë që të operojmë me kod të Serbisë. Kjo është e papranueshme dhe në një farë forme po na bënë të dyshojmë që keni nostalgji për një sistem të kaluar, apo çka është në pyetje?

Edhe e treta, ajo që e ka përcjell këtë Qeveri, do të thotë, gjatë gjithë kohës, është mashtrimi dhe nuk është për të qeshur, është e dhimbshme, është për të qarë. Mashtrimi, nuk do të flas për gjithë ato mashtrime që i keni bërë gjatë fushatave zgjedhore, milionat e kryeministrit Thaçi, milionat fantom të shpërndarë nëpër komuna përkatëse. Do të flas për diçka që është folur në Parlamentin e Kosovës, në prill të vitit 2008, do të thotë, po thuaj se tri vjet më parë.

Këtu kam një transkript ku kryeministri Thaçi, në pyetjen e një deputeti se kur do ta rregullojë furnizimin me energji elektrike thotë: Kemi një strategji që kemi nxjerr si Qeveri e Kosovës dhe kjo strategji do të jetë një strategji që të kemi furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike brenda 9

deri në 12 muaj, për të vazhduar- strategjia do të ndihmojë për herë të parë të kthejë rrjedhën e fondeve nga buxheti në sektorin energjetik, kështu që paratë, mjetet do të rrjedhin në drejtim të kundërt, nga sektori energjetik në buxhetin e Kosovës. Ndërkaq, ajo se çfarë ka ndodhur pas kësaj deklarate nga kjo foltore e Parlamentit të Kosovës është që mbi 200 milionë euro para të qytetarëve të Kosovës, të cilat janë paraparë të investohen në sektorë të ndryshëm: në shëndetësi, në bujqësi, në blegtori apo në sektorë të cilët do të përmirësonin mirëqenien dhe zhvillimin ekonomik të vendit, në fakt janë dhënë nga kryeministri Thaçi, i cili në këtë foltore thotë që ai për 12 muaj do të ndryshojë rrjedhën e mjeteve nga buxheti i Kosovës, të cilat, sipas tij, kanë shkuar nga buxheti i Kosovës në KEK, prej 15 milionë eurove janë rritur në 200 milionë euro. Dhe, ndërkohë, në këto vite ka vazhduar të prodhohet terr dhe kjo do të thotë që këto janë mashtrime ordinere të cilat më së tepërmi iu kushtuan qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit për Integritet, deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ja çu nastojati da govorim o nekim životnim pitanjima, danas neću govoriti o pitanjima države. O tome ću možda govoriti drugi put, ako bog bude dao da budem živ, ali danas ću govoriti o djelovanjima javnih kompanija i snabdevanju strujom, vodom, obaveštavanju, odnosno informisanju i o nekim drugim pitanjima.

Ovih dana sam bio ponovo u prilici da kao i mnoge moje kolege i građani Kosova da se suočim sa jednim pitanjem, tačnije rečeno sa nedostatkom struje, koje postoji u mnogim dijelovima Kosova, ne samo u Peći, nego i u Prizrenu i u Kačaniku, i u Ferizaju; Mitrovici i bilo gdje.

Jedno od pitanja koje trebamo postaviti sebi jeste da li mi imamo pravo da posle 11. godina dopustimo da ovo pitanje bude već zaboravljeno, potisnuto u stranu i da uprkos nekim naprecima koji jesu napravljeni, uprkos boljem snabdevanju strujom koje evidentno da postoji na celom Kosovu, ali da takođe evidentiramo da postoje djelovi, čitava naselja, udaljena sela, ljudi koji nemaju privilegije ili nemaju rođake ili familije, ili moćnike u energetske korporaciji, u Ministarstvu, u Vladi ili bilo gde drugde. Govorimo o naseljima koja su prepuštena sama sebi i koja nemaju struje po 5 dana, 10 dana, 15 dana i niko na haje za njih. To je fenomen koji je i dalje prisutan, rekoh, uprkos poboljšanjima koje postoje u većem djelu gradova, ipak u nekim naseljima je ovo veliki problem, i bilo je upravo i u vreme Ramazana i posle njega značajnih problema vezano sa time, a posebno ovih dana ponovo, tako da ona pitanja koja bih postavio jeste da građani u ovim dijelovima, građani Kosova, bez obzira dali pripadaju nevećinskim zajednicama ili najbrojnijoj zajednici, bez obzira na sve, oni imaju pravo da budu zaštićeni, imaju pravo da budu snabdeveni strujom, jer je to elementarni uslov za život.

Ponavljam ponovo, posle 11 godina mi nemamo pravo da kažemo – pa eto bolje, ali nema veze, guraćemo ovako. Mislim da celi svet i sve zemlje u okruženju imaju stalno snabdevanje i KEK, i Ministarstvo i Vlada i svi mi imamo obavezu da konačno riješimo ovo pitanje. Podsjetio bih takođe na jedan sistem koji se nepravedno upotrebljava, odnosno zloupotrebljava sistem A,B,C, ja ga komotno mogu nazvati, to je moj personalni stav, idiotskim sistemom, jer on dopušta da unutar jednog, da tako kažem, sistema A, B ili C postoje ljudi koji stalno plaćaju struju i nikako je nemaju. A postoji u onom drugom onih koji je nikako ne plaćaju, i takođe je imaju, zato što imaju sreću da žive u kvartu koji možda bolje plaća struju ili žive u nekom naselju gdje živi neko od upravnika i neko od moćnika ili koji je blizak ministarstvu, KEK-u ili Vladi i zbog toga imaju struju. Mislim da je nepravda da stotine, hiljada domaćinstava koje plaćaju struju, nemaju je. To se mora riješiti. Sistem A,B, C ne vredi, mora se uspostaviti sistem o kome se govori i koji je, toliko puta

spominjam, pretplatnički sistem. Jednostavno, to je svuda u svetu prihvaćeno, imaćeš struje onoliko koliko uplatiš, dakle oni koji plaćaju struju, moraju je imati, oni koji ne plaćaju, ne trebaju je imati, osim onih koju mogu biti izuzeti na osnovu raznih privilegija, siromaštva, jetima, socijalnih slučajeva i tako dalje, onih koji nisu u mogućnost da je plate.

Drugo pitanje o kome bih govorio, jeste pitanje obaveštavanja. Imali smo jedan značajan događaj prije nekoliko dana i ponovo jedan slučaj javne kompanije, u ovom slučaju Radio-televizije Kosova, koja se jednostavno malo osvrnula ili uopšte nije prikazala jedan važan događaj. Bila je javna debata prošlog ponedjeljka, odnosno prije 3 dana, javna debata o Zakonu o gradu Prištine. Imao sam zadovoljstvo da budem prisutan u ime, odnosno kao član Komisije, jer su takođe bili značajni ljudi iz drugih parlamentarnih komisija, ministarstva, Vlade, grada Prištine, dakle jedan eminentan skup. Desilo se da Radio-televizija Kosova to veće jednostavno se kratko osvrnula u 2 minute jednim prenosom, odnosno reportažom, prilogom koji je išao u jedno dve minute, sa nekom starom arhivskom slikom, bez tona, bez glasa, bez slike, nekom slikom izvađenom iz naftalina. To je primer lošeg obaveštavanja, sakrivanja istine, izbegavanja istine i onaj način koji se ne sme dozvoliti, jer se govori o javnom događaju, značajnom događaju. Znači, ovde sam spomenuo dva primjera koji se tiču delovanja javnih kompanija, takozvanih nezavisnih ili samostalnih, a ponavljam jer sam to govorio mnogo puta I ranije...

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka kërkuar fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ka muaj që pandërprerë në adresë të institucioneve të vendit vijmë porosi nga miqtë tanë ndërkombëtarë, porosi këto që ia donë të mirën këtij vendi dhe janë shumë të qarta për obligimet që kanë institucionet vendore, se mungesa e rezultateve në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit rrezikon perspektivën e shtetit të Kosovës, rrezikon stabilitetin politik, ekonomik dhe social. Dhe, këto porosi jo vetëm që nuk merren seriozisht, por krijohet përshtypja e injorimit në tërësi nga vetë qeverisja e vendit dhe kjo përbën shqetësimin që tregon për gjendjen në të cilën ndodhet sot sistemi institucional i Kosovës.

Duke pasur parasysh se në institucionet e vendit tek qeverisja aktuale nuk ekziston vullneti politik për një gjë të tillë dhe në anën tjetër tek institucionet ndërkombëtare të thirrura në Kosovë, me deklaram të pavarësisë së vendit dhe me Kushtetutë për të vendosur rend dhe ligj, duke qenë njëkohësisht një ndër misionet më të shtrenjta ndërkombëtare e që përpos retorikës, të cilën e kanë mbjellë për dy vjet me radhë, për luftë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, nuk ka sjell gjë tjetër dhe me plot të drejtë qytetarët e Kosovës e konsiderojnë këtë retorikë të komprometuar që i ka skaduar afati.

Ky Kuvend, të nderuar deputetë, duhet ta pyesë veten dhe të korrigjojë se a është në nivelin e përgjegjësisë kushtetuese si organi më i lartë përfaqësues i vendit? Dhe, ne themi se jo. Një politikë e vendosur për shtet kushtetues dhe ligjor është ajo çka i duhet sot Kosovës dhe jo çfarë është duke u bërë tani.

Të nderuar deputetë,

Çështjen tjetër të cilën dua ta ngre në emër të Grupit Parlamentar, së pari dua t'ua rikujtoj se para sa muajve ky Kuvend nuk pat guximin të demonstrojë rolin kushtetues për të nxjerr një rezolutë dhe për

ta fuqizuar rolin e vet si organi më i lartë përfaqësues i vendit dhe po atëherë doli në pah e ashtuquajtura Strategji famoze për veriun, një skenar të cilit i besoi edhe Kuvendi i Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ku mbeti ai trumbetim aq i madh për atë dokument, pse u harrua aq shpejtë? A duhet ky Kuvend të kërkojë llogari, apo dikush tani e ka kuptuar atë që Lidhja Demokratike e Dardanisë, me vite të tëra e ka theksuar për opinion se në veri të vendit, strukturat e UNMIK-ut janë të bashkëdyzuara me strukturat paralele serbe dhe kanë penguar kthimin e qytetarëve të Kosovës në pronat e tyre. Kjo realisht dhe faktikisht përbën pengesën më të madhe për shtrirjen e autoritetit të institucioneve të Republikës së Kosovës në pjesën veriore të vendit dhe kur kësaj i shtojmë edhe neglizhencën dhe papërgjegjësinë e institucioneve vendore, kemi një situatë e cila për mendimin tonë nëse vazhdon këssoj, mbetet e pashpresë.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë vlerëson se demonstrimi i rolit kushtetues të Kuvendit të Kosovës nga deputetët, është ajo që kërkohet tani. Nëse deputetët, të zgjedhurit e qytetarëve të vendit nuk e bëjnë një gjë të tillë, atëherë krijohet mundësia që këtë përgjegjësi ekskluzive të Parlamentit të Kosovës ta ushtrojë dikush tjetër apo nuk besoj që dikush nga ne dëshiron t'i jepet mundësia që qytetarët e Kosovës, pa vullnetin e tyre të trokasnin në dyert e Kuvendit edhe atëherë do të jetë vonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me deklaratimet e lira.

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Euforia e institucioneve tona se mendimi këshillëdhënës i GJND-së i 22 korrikut të vitit 2010 lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës i ka zgjidhur të gjitha nyjet në përmbylljen e dosjes së Kosovës, siç e pamë, nuk zgjati shumë. Rezoluta konsensuale e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e 8 shtatorit nxori dilema të reja, derisa edhe Prishtina edhe Beogradi nxituan ta shpallin këtë rezolutë si fitore të tyre, ne patëm thënë që kjo mund të quhet fitore e diplomacisë evropiane, por jo e asnjërës palë nga palët e përmendura. Kaluan vetëm disa ditë dhe kjo eufori filloi të shuhet, për më tepër të dy palët filluan të shprehen paksa të hutuara në atë se çfarë kishte ndodhur. Tashti nuk na interesojnë shumë shqetësimet e Beogradit të cilat po i shohim dhe të cilat po mundohen ta shesin shumë shtrenjtë rezolutën e tyre famoze edhe tashmë konsensuale, domethënë, duke ngritur edhe dilema të tilla se Beogradi nuk e ka alternativë vetëm Brukselin e që në fakt edhe kjo përbën shqetësim për ne. Përball këtyre shqetësimeve pala kosovare nuk duket shumë e shqetësuar, siç po e shohim, por nuk janë të vogla dilemat se çfarë do të përmbajë pakoja e bisedimeve me Serbinë, referuar asaj që quhet teori dhe praktikë diplomatike, kjo çka po ndodh sot mund të quhet proces paranegociator. Dhe, jo shumë si opozitë, por në funksion të ndërgjegjësimit të opinionit, mendoj që qëllimi kryesor i këtij sistemi paranegociator është që ai duhet të qartësojë paraprakisht, po thuaj deri në detaje, gjithçka që lidhet me bisedimet e ardhshme me Serbinë. Këtu mendoj në çështjet që do të jenë pjesë e agjendës së bisedimeve, pastaj: formatin, kohën, vendin dhe ndërmjetësit e këtyre bisedimeve.

Është po ashtu e rëndësishme që në këtë proces paranegociator, i cili siç po shihet se do të jetë i nivelit më të lartë, përfshirë kryeministra dhe presidentë, asnjë pëlqim a vendim për çështjet e

agjendës dhe të formatit të bisedimeve të mos jepet paraprakisht nga krerët ekzekutiv të vendit. Të gjitha çështjet që lidhen me hartimin e agjendës të prezantohen dhe të marrin vizën e Parlamentit të Kosovës, kjo është minimumi i përgjegjësisë institucionale të secilit nga krerët tanë shtetërorë.

Çështje imediate e konsideroj po ashtu edhe përfshirjen medoemos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës si bashkëndërmjetëse ...

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Rexhep Hoti e ka fjalën.

REXHEP HOTI: Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është një kënaqësi e veçantë që opozita më në fund ka filluar t'i shprehë mendimet e veta shumë më lirshëm se sa deri më tash. Gjithashtu i mirëpresim gjithmonë propozimet dhe nuk ka ndodhur ndonjëherë që ajo të ofrojë diçka në Kuvend dhe të mos i jepet shans për të diskutuar. Duhet t'i themi gjithashtu se ka filluar një praktikë shumë e dëmshme, opozita ka filluar ta shajë vetveten në Kuvend, ju lutem keni kujdes. Kuvendi nuk është Qeveri, i keni të gjitha mundësitë, ofroni substancën tuaj alternative e mos shani në këtë drejtim, kjo nuk ju ofron alternativë. Me këtë po dëshmoni se jeni shumë larg një opozitë konstruktive, lëreni ato gjëra. Sa i përket çështjes së bisedimeve Kosova kurrë nuk ka qenë më e favorizuar në aspektin ndërkombëtar se sa deri me tani. E lus opozitën të mos prejudikojë gjëra që shkojnë në dëm të popullit dhe të institucioneve të Kosovës. Ju i keni dëgjuar ndërkombëtarët në lidhje me çështjet edhe të rezolutës, por keni dëgjuar edhe propozimet e pozitës nga ky Kuvend, sa i përket çështjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me iniciativën e Partisë Demokratike Evropa përfundimisht ka filluar konsultime shumë zyrtare me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pas zbritjes së çështjes së Kosovës në Bruksel po kjo opozitë ka bërë të qartë se krahas Brukselit do të jetë edhe Uashingtoni.

Prandaj e mirëpresim gjithmonë shembullin që opozita ta ofrojë substancën e vet, por ju lutem mos e bastardonin Kuvendin, sepse këtu jeni të zgjedhurit e popullit dhe është e drejta e juaj, shfrytëzoni atë të drejtë, por mos e shani vetveten se ne si pozitë kemi nevojë për opozitën, e në qoftë se ju nuk do ta bëni këtë, ne do detyrohemi ta bëjmë edhe vetë opozitën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Lexoni Rregulloren e pastaj kërkoni fjalën, a keni të drejtë ta kërkoni apo jo. Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetari i Kuvendit!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Vërtet unë sot e mora fjalën për një çështje që ndoshta nuk do të tingëllojë shumë populiste që po shihet se shumë kolegë të mi të nderuar po luajnë me këtë letër, është çështja për dhënien e ndihmës nga 1000 euro nga Qeveria e Kosovës, për prodhuesit e rrushit.

Duke marrë parasysh parimet themelore të politikës ekonomike të një vendi që pretendon të zhvillojë demokracinë parlamentare, shtetin ligjor, pa dyshim edhe ekonominë e lirë të tregut, një veprim i tillë nuk ka të bëjë as me subvencione, nuk ka të bëjë as me harmonizim në aspektin e kornizës ligjore, por nuk ka të bëjë as me ndihmën e bizneseve. Një veprim i tillë ka bërë deskriminim, qoftë pozitiv, qoftë negativ, qoftë për prodhuesit e këtij sektori apo për prodhuesit të tjerë, andaj, është çështja shumë delikate, nuk është në pyetje blerja e paqes sociale nga individë apo nga grupe, apo nga Qeveria e Kosovës. Një gjë e tillë duhet të planifikohet mirë edhe me kornizën buxhetore, duhet të planifikohet mirë në aspektin e subvencionimit të atyre degëve, të cilat vërtet kanë nevojë për

subvencione duke marrë parasysh garën në region, por një veprim i tillë padyshim do të reflektojë pasoja negative. Në fakt, në parim nuk jam kundër subvencioneve, por ato duhet të planifikohen me kohë, duhet të planifikohen edhe nga Qeveria dhe të hyjnë në kornizën ligjore të buxhetit të Kosovës e të njëjtën kohë duhet të planifikohen edhe nga zhvillimi sektorial, qoftë në Ministrinë e Bujqësisë, qoftë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Duke marrë parasysh të gjitha këto defekte që mund të prodhojë një veprim i tillë i Qeverisë, unë mendoj se kjo çështje duhet të zgjidhet me rishikimet buxhetore që ka mundësi të bëhen dhe vërtet ato biznese apo ata sektorë të cilët kanë nevojë për subvencione të realizojmë apo t'i japim mjetet sipas nivelit dhe zhvillimit strategjik që ka Kosova.

Unë mendoj se një diskriminim, qoftë pozitiv, qoftë negativ dhe atë qoftë për sektorin e prodhimit të rrushit apo sektorë të tjerë, do të reflektojë negativisht tash te prodhuesit të tjerë, qoftë të rrushit, qoftë prodhues të tjerë të produkteve tjera bujqësore, në vendet tjera. Andaj, një qasje e tillë ad-hoc nuk është e mirë dhe nuk i bën nderë as Qeverisë, nuk i bën nderë pa dyshim asnjë organi ...

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti kryetar i Parlamentit të Kosovës, doktor Jakup Krasniqi!

Ju përsëndes juve edhe stafin tuaj, e përsëndes zëvendëskryeministrin, po ashtu edhe krejt ministrat që i ke aty. Po ashtu, i përsëndes zonjat dhe zotërinjtë deputetë.

Sot kam një lutje për të gjithë ju, unë nuk di kur jam përfaqësues i romëve të Kosovës, më përfaqësojnë mua grupet- serbë, shqiptarët a është puna që duhet të jetë romi aty në atë grup. Tash isha në Hungari dhe ishte grupi jonë që ka përfaqësuar për dekadën e romëve, asnjë romë s'ka qenë edhe po më pyesin pse unë s'kam qenë? Po them s'kam ditur që është mbajtur. Ashtu edhe në Shkup ka qenë dekada e romëve para disa kohe, prapë neve s'po na thërrasin. Po ju lus, a janë ata romë që po shkojnë atje apo duhet romi të jetë në atë grup? Po ju lus juve si kryetar i Parlamentit të Kosovës, zoti doktor Jakup Krasniqi, që të mos u japësh leje që të shkojnë t'i përfaqësojnë romët, serbët edhe shqiptarët, po le të shkojnë romët se ata kanë përgjegjësi për këtë. Kur unë sot nuk i kam shkollat e mia, nuk kam kurrgjë edhe shkon e na përfaqëson tjetërkush i merr krejt çka më takon mua, si romëve, si popullit tim a unë nuk di gjë, ata shukatin vetëm sikur të mos ishte kurrgjë. Kësaj radhe po ju njoftoj se vërtet jam i brengosur edhe unë edhe populli im. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe neve na vjen keq që nuk jeni përfaqësuar ju. Grupe s'ka, do të thotë çdo grup e ka marrë fjalën. Tash po shkojmë sipas radhës.

Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, për fjalën e dhënë!

Tani kur po futemi në fazën finale të privatizimit të PTK-së po lajmërohen shumë dobësi qeverisëse dhe po fillon faza e paraqitjes së problemeve reale të Kosovës. Dobësimi, lëshimi pe, apo ndoshta edhe pazari mes korrupsionit dhe krijimit të politikave, janë vetëm disa prej fenomeneve që kanë përshkruar Kosovës për disa vjet. Vetëm arsyeja që është dhënë nga Qeveria e Kosovës për privatizimin e PTK-së se PTK përballlet me probleme të korrupsionit, është lëshim pe para korrupsionit. Por kjo mund të jetë edhe pazar mes atyre të cilët janë të thirrur për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Normalisht, mund të jetë ngritja e pazarit duke i frikësuar se ata kanë fuqi dhe mund të marrin hapa konkret në kapjen e" peshqve të mëdhenj dhe të vegjël", siç patën deklaruar zyrtarët më të lartë të EULEK-sit, dhe pastaj futet pazari, normalisht si llojeve të

ndryshme si biseda politike teknike, por ndoshta edhe forma të tjera të korrupsionit për të cilët ... shumë zyrtarë ndërkombëtarë nuk kanë imunitet dhe nuk janë imunë ndaj korrupsionit.

Po citoj një prej titujve të gazetës .. krerëve të EULEK-sit nga deputeti Tali, korrupsioni brirë s'ka normalisht, po i numëroj vetëm disa veprime që kanë shtyrë që të futemi në një proces që tash edhe mund të diktohet, Dardafon Versus, Dardafon. net. Po ky veprim korrupsionit, të mos themi hajni e pastër në pikë të ditës jo vetëm që nuk mund të arsyetohet, por vetëm mos marrja e asnjë hapi konkret, të lë të kuptosh se këto me të vërtetë janë të përzier" peshqit e mëdhenj", këtu mund të jenë përzier se në vendet prej nga vijnë ata nuk u tolerohen hajni të tilla, dhe kjo s'ka asgjë të bëjë me politika të shteteve prej nga vinë, ka të bëjë me hajni. Licenca e telefonisë mobile në Shqipëri, rritje të arsyeshme dhe pa rregulla e numrit të punësuarve dhe tenderët e vegjël e të mëdhenj. Me fjalë të tjera EULEK-si po na bënë brirë dhe çuditërisht EULEK-si nuk i paska parë. Kjo nuk është më ironike, kjo po bëhet fyese për qytetarin e Kosovës. Hajt mos pyet shumë se edhe ne i kem do punë t' i kryejmë kish për të thënë EULEK-si.

Aferat e vazhdueshme por edhe bastisjet që i bëri EULEK-si duke mos i vazhduar me asnjë hap konkret të lenë të kuptosh se dikush këtu ka hyrë në mes. Nejse s'ka problem që ka hy me ndërmjetësim, po çka ka futur në pazar? Çka ka futur në pazar mund të jetë brengosëse për qytetarët e Kosovës, ndoshta pazari është edhe aq i madh sa PTK, por edhe tenderët e tjerë të shumëpërfolur janë cikërrima, ndoshta së paku pse mos të lajmërojmë, t'i shtymë t'i lajmërojnë fitimet nga korrupsioni dhe t'u vëmë taksë, t'i taksojmë, kështu së paku të gjithë do të fitojnë nga diçka. Jo vetëm fjalja që përdora është cinizëm, por veprimet e EULEK-sit janë cinizëm shumë, shumë më i madh. Tash po dihet se kush po donë ta fusë korrupsionin në pazar në sigurinë e Kosovës, dhe po krijojnë pasuri në emër të sigurisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ky ishte edhe në bazë të kohës që kemi diskutuesi i fundit, bile ka kaluar pak.

Këto janë deklarime jashtë rendit të ditës dhe vërtet mua po më vjen keq, që po ngritën disa çështje që kanë mundësi të hyjnë në rend të ditës me një kërkesë nga grupet parlamentare, por si duket kemi për qëllim veç për të folur, por jo për të ndihmuar më shumë.

Vazhdojmë për pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Që po e lexoj me rend, po gjithnjë në emër të grupeve parlamentare kanë përparësi, radhën e kanë : Gjylnaze Sylaj, Zylfije Hundozi, Synavere Rysha, Driton Tali dhe Myrvete Pantina. Mbani në mend këta emra dhe lajmërohuni në seancën e radhës.

Vazhdojmë- Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund t'i parashtojë më së shumti dy pyetje.

Po fillojmë nga pyetja e parë. Deputetja Donika Kadaj- Bujupi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete mund ta lexoni pyetjen.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: I nderuar kryetar,

Përderisa nuk do të marrë përgjigjen, nuk e kam bërë pyetjen veç për ta lexuar, por ta di a do të kemi përgjigje, prandaj po pres që kryeministri të kthehet, veç mos e hiqni prej rendi të ditës, qysh po ndodh shpesh.

KRYETARI: Një sqarim. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Përsëri deputetja Donika Kadaj - Bujupi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Do ta pritni apo e do fjalën deputete? Regjia fjalën e ka deputetja Donika Kadaj -Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Përsëri po pres derisa të kthehet kryeministri Thaçi dhe besoj që do t'i japë përgjigje pyetjes.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Deputeti Shkumbin Demaliaj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputet a do ta lexosh pyetjen? Jo. Vazhdojmë. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

Deputete, a do ta lexosh pyetjen?

Fjala për deputeten Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me qenë se kryeministri nuk është këtu dhe besoj që asnjëri ndoshta nga Qeveria nuk do të përgjigjet, unë dua vetëm t'i them deputetit Hoti se atë çka tha për opozitën janë të pavërteta, por unë për të shprehur konstruktivitetin tim opozitar dhe mirëkuptim, po e fal, sepse është për herë të parë deputet dhe gjatë përvojës do të mësojë. Faleminderit!

KRYETARI: Ka mundësi për të mësuar. Mirë.

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi.

Regjia fjalën deputetit Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Pyetjen deri diku të njëjtë ia kam drejtuar ministrit Bukoshi në muajin korrik, por me qenë se është ende aktuale, por me një version paksa të ndryshuar, po ia drejtoj edhe tash. Ministri i Shëndetësisë, Bujar Bukoshi ka iniciuar procedurën e shkarkimit të drejtorit ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, zotit Ali Sadria. Drejtori Ekzekutiv i QKUK-së në mënyrë shumë transparente pat bërë publike shumë afera korruptive që përcjellin punën e QKUK-së, si dhe pat bërë publike aferën e shpronësimit të tokave, apo dhënien në shfrytëzim ndërmarrjeve private në mënyrë të paligjshme dhe paushall, të tokave publike që për dekada me radhë kanë qenë në shfrytëzim të QKUK-së. Pyetja ime e atëhershme ka qenë- cilat janë arsyet e shkarkimit, por tash është një version i ndryshuar- cilat janë arsyet e atëhershme të shkarkimit që ju keni iniciuar dhe tani pse u kthye në punë si drejtor i QKUK-së, cilat janë arsyet e kthimit?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Pyetje e njëjtë, përgjigje gati e njëjtë, por edhe pyetja ngjan. Po, nëse e marrim që kanë ndryshuar disa variacione, esenca mbetet prapë. Unë kam kërkuar shkarkimin e atij, e kam shkarkuar drejtorin e QKUK-së, për arsye që unë konsideroj se janë me vend. Procedura nuk ka ecur si duhet dhe Komisioni i shkallës së parë, për shkak të mungesës së domethënës, fakteve, ose evidencave, nuk ka ecur procedura dhe është shqiptuar një masë e dënimit ose ndëshkimit. Zoti Sadrija ka marrë masën e ndëshkimit, domethënë, ka dalë si fajtor, të themi ashtu, ne nuk kemi qenë të kënaqur me shkallën, me masën e shqiptuar dhe kemi bërë një ankimim në

Komisionin e shkallës së dytë, domethënë, procedura vazhdon. Në ndërkohë, zoti Sadriu ka shkuar në bazë të atij vendimi, ashtu qenkan rregullat, procedurat, unë s'kam tjetër, përveç që t'i respektoj këto, është kthyer në punë. Kjo është gjendja e tanishme. Për t'u kthyer në esencën e pyetjes tuaj si u shkarkua një herë e prapë erdh, ato masa ose ato aktivitete që ai paska marr t' i denoncojë, t'i zbulojë ose këto afera të them ashtu, shpronësimi edhe parregullsi të tjera, zotëriu ka tash shansin edhe ta vazhdojë se as atëherë, as tash, as në të ardhmen, nuk do të ketë kurrfarë opstruksioni në këtë drejtim. Unë jam, po ashtu një ithtar i mirë që gjithçka të bëhet transparente edhe të luftohet korrupsioni dhe të gjitha këto gjëra, domethënë, absolutisht ajo është vijë e njëjtë. Pse tani, u kthye, u kthye se janë rregullat të atilla, duhet t'i respektojmë ato, s'di a mjafton kjo?

KRYETARI: A ke pyetje shtesë, deputet?

NAIM RRUSTEMI: Vetë bërja publike e shpronësimeve të pronës së QKUK-së, pronës publike, ka ngjallur hezitime tek qytetarët e Kosovës dhe ka mbjell dyshime të mëdha dhe arsyet pse unë e kam bërë këtë pyetje janë që t'i japin përgjigje pyetjes- A do t'i shpalosë drejtori i QKUK-së shpronësimet që kanë ndodhur në QKUK? Edhe ju zoti ministër, në njërën prej seancave patët deklaruar publikisht se në muajin shtator do t'i bëni publike të gjitha shpronësimet e QKUK-së. Tash është fundi i muajit, ne kem pritur muajin, edhe një javë e keni, ka qenë fjalë publike e dhënë ose ndoshta do të presim deri në tetor. Por si do që të jetë, kjo ishte ajo sa i përket dyshimeve të mbjella tek qytetarët, mosbesimi ndaj Qeverisë ndoshta edhe e meriton në mënyrë të tillë, sepse Kosova i ka disa procedura disiplinore edhe gjatë procesit të shkarkimit, por edhe gjatë procesit të kthimit, kështu që ju lutem nëse mund të jepni përgjigje....

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën, ju të tjerët mos u përziëni!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Me atë timen unë i kam respektuar të gjitha procedurat edhe po ashtu edhe këtu zotohem se të gjitha ato procedura për të cilat unë jam i obliguar t'i respektoj, do t'i respektoj. Është çështje tjetër në këto, në disa edhe një përplasje të administratës apo mos punës, apo neglizhencës, unë me këtë rast do ta kisha shtuar edhe një komponent të rëndësishëm. Ky rast tani ka një tendencë që të politizohet, tmërrsisht. Unë me qëllim iu kam shmangur këtij politizimi ose karshilluku që kush ka të drejtë. Pra, të mos kem unë të drejtë, por punët të rregullohen në QKUK, sepse është një punë më prioritare që në QKUK të ecën, nëse kjo komplikohet ose politizohet, atëherë çrregullimet e mëtejme që do të vinin le ta marrë përgjegjësinë për atë kush i shkakton këto gjëra. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Ministri nuk është këtu deputet, është jashtë vendit do të thotë kam informacion, doni ta bëni pyetjen. Regjia fjalën deputetit Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Në këtë kontekst do të apelohe në dispozitën e nenit 45, paragrafi 11 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila virtualisht është ligj, sepse ka miratuar legjislativi, e cila nuk përfillet në shumë raste edhe këtu është poenta, që kur nuk jepet përgjigja në pyetjen shkrimore për përgjigje gojore, ndër të tjera, Zyra për Informim e Kuvendit e lëshon një njoftim për media brenda 24 orëve, këtë nuk e bën në kontekst me pyetjen. Mirë, tash në këtë rast mund të jetë e justifikuar, qenka në botën e jashtme, mirëpo, ç' bëjmë kur nuk është ose ky ose ndonjë ministër tjetër në botën e jashtme ose në rrugë zyrtare, por nuk përgjigjet e neglizhon pyetjen e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Vazhdojmë me të njëjtin deputet. Pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Zotëri ministër Yagcilar,

Për shkak Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, të cilën aktualisht të cilën ju e administroni.

Një, kontraktimet për punë nuk bëhen konform me ligjin.

Dy, përshkrimet e punëve dhe të detyrave në punë nuk standardizohen dhe nuk miratohen nga udhëheqësi i Personelit.

Tre, procedurat disiplinore nuk aplikohen në mënyrat e caktuara me dispozitat ligjore, rregullative, aplikative,

Edhe tjetër, ndërprerjet apo pushimet e punës nuk aplikohen konform me ligjin e aplikuar dhe përfundimisht pse nuk përfillen vendimet përfundimtare të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës? Të gjitha këto kanë mbështetje në komente edhe në fusnota. Faleminderit

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Smaka,

Sa i përket pyetjes është një pyetje përgjithësuar kështu që për të hyrë në thellësi të pyetjes duhet dhënë disa edhe pyetje të sakta edhe përgjigjet të jenë të sakta. Por sa i përket këtyre çështjeve çdo vit edhe përbrenda Ministrisë bëhet auditimi i brendshëm, por gjithashtu ekziston edhe auditimi i përgjithshëm. Por edhe në auto auditive ekzistojnë disa lëshime, ne jemi duke u munduar të bëjmë që të gjitha kërkesat ose rekomandimet t'i zbatojmë, por dihet se ekzistojnë probleme edhe thjesht mund të themi kur është një çështja e një punësimi ekzistojnë 1000 intervenime, por kur është edhe për largimin prapë ekzistojnë 1000 intervenime. Nuk është edhe aq lehtë këto çështje të rregullohen, por besojmë edhe me Kuvendin edhe me zbatimin e ligjeve këto çështje do të rregullohen më saktësi.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Konsiderata për juve si personalitet edhe ministër, mirëpo pyetja është parimore. Pse? Në qoftë se këto pyetje edhe nën pyetje nuk janë konkrete unë nuk di ç'është precizja edhe koncizja, edhe krejtësisht konkrete, bie fjala pse nuk përfillen vendimet përfundimtare, ndër tjera, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, që praktikisht është Gjykatë Supreme e Kosovës, që vendimi përfundimtar është dokument që njëjtësohet me ligjin, pse nuk zbatohet? Ju e thatë edhe më vjen keq, unë kam respekt për pozicionin e juaj, që keni presione politike, po e zëmë, që ato janë abuzime edhe korruptime, se nga pushtetarët që bëjnë influenza negative për të mos u përfillur vendimi i formës së prerë, kontrata, punësimi i paligjshëm, kjo është mjaft eksplikative edhe brengosëse, kjo nuk është dukuri vetëm në Ministrinë e juaj, por edhe në disa ministri....

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Unë dëshiroj edhe një herë ta ritheksoj këto çështje bëhen edhe përmes auditimit të brendshëm edhe përmes auditimit të përgjithshëm, por kur janë instancat si

gjykatat, Gjykata Supreme, ne sigurisht zbatojmë me përpikëri këto çështje. Por ekzistojnë probleme edhe për këto çështje është edhe auditimi i përgjithshëm ku për këtë vit shembull i kemi 9 rekomandime, vitin e kaluar kanë qenë 15 rekomandime. Kështu që besojmë me zbatimin edhe Kuvendi edhe Qeveria do të ecim përpara dhe do t'i rregullojmë këtë çështje, pa lëshime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

Vazhdojmë, deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

Regjia fjalën deputetes Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me qenë se pyetja ime ka të bëjë me pagat e mësimdhënësve, në qoftë se ndonjëri nga anëtarët e Qeverisë është i gatshëm të përgjigjet, unë do ta kisha lexuar pyetjen, përndryshe do ta pres kryeministrin të përgjigjet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Deputete, e ke fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Çështja- krijimi i Agjencisë së Mërgatës, sipas Ligjit për mërgatën e Kosovës nr. 03/L-171, i cili ndihmon organizimin e Mërgatës në shtetet e ndryshme ku jeton mërgata kosovare. Pyetja është- Sipas nenit 5 të Ligjit për Mërgatën e Kosovës Qeveria a ka themeluar Agjencinë e Mërgatës së Kosovës, e cila ushtron dhe zbaton autoritetin dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj?

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zonja Hulaj, faleminderit për pyetjen!

Ju e dini, sipas ligjit ka qenë obligative që të themelohet një agjenci e tillë, më herët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka qenë Zyra për Mërgatën apo Zyra për Diasporën sido që e quajmë, tani më është themeluar një agjenci e tillë, po funksionon ka bërë edhe aktet sekondare apo legjislacionin sekondar dhe ne mendojmë që do të jetë funksionale, me një autonomi të plotë dhe me një përkujdesje më të madhe, në veçanti pas miratimit të ligjit në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë deputete?

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

Sipas nenit 7, paragrafi 1 i Ligjit të Mërgatës e kam edhe një pyetje shtesë, kryeshefi ekzekutiv a është përfaqësuesi i Mërgatës?

KRYETARI: Përgjigje, zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Me ardhjen në Qeveri nga ne ka qenë një kryesues i asaj zyre apo drejtor i zyrës, zoti Naim Dedushaj, që është konsideruar si një njeri që ka

ardhur nga diaspora, ne nuk e kemi ngucur atë pozicion, e kemi lënë edhe më tutje, por tani ka nevojë që të shpallet një konkurs dhe me siguri do ta kemi parasysh që edhe prejardhja e tij po e quaj kështu do të jetë nga njerëzit që e kanë njohur dhe e njohin diasporën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e fundit. Deputetja Drita Kadriu, pyetje për ministrin Lutfi Haziri. Ministri nuk është këtu. Unë këtu çka kam i kreu, Naim. Mirë, faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 15 shtator 2010

Pyes, nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Nuk ka. Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 15 shtator 2010.

Vazhdojmë, në sallë kemi 43 deputetë, që do të thotë mund të vazhdojmë me pikat e radhës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë projektligjin.

Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për shërbimet e sigurisë private të sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Hartimi i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private ka filluar që nga muaji prill i vitit 2007. Në hartimin e këtij drafti kanë qenë të përfshirë përfaqësues të shoqatave për sigurinë private, përfaqësuesit e misionëve ndërkombëtare në Kosovë ku interesim të veçantë kanë shprehur përfaqësuesit e NDP-së, ICO-së, EULEKS-it dhe i CITAP-it.

Duke u mbështetur u mbështetur në rëndësinë dhe peshën që ka ky ligj për Kosovën dhe qytetarët e saj shihet qartë se bëhet fjalë për projektligj me prioritet të lartë për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të madhe për faktin se ekziston një numër i madh i kompanive private të sigurimit si dhe bën rregullimin ligjor për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të sigurisë private dhe përcakton kushtet për të ushtruar këtë veprimtari.

Projektligji ka për qëllim që t'i adresojë çështjet që kanë të bëjnë me subjektet afariste që merren me ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të sigurisë private, format e ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private, dhënia dhe marrja e licencave për kompanitë private të sigurimit dhe punëtorët e sigurimit, standardet profesionale për ushtrimin e kësaj veprimtare, trajnimet themelore dhe të specializuara për punëtorët e sigurimit, mbajtjen e evidencave të subjekteve afariste dhe punëtorëve të sigurimit si dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

Projektligji ka X kapituj me gjithsej 53 nene.

Projektligji për shërbimet e sigurisë private ka implikime buxhetore, por gjithashtu krijon të hyra nga licencimi i kompanive private të sigurimit dhe punëtorëve të sigurimit për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Projektligji ka deklaratën e pajtueshmërisë të Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritetit Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Projektligji krijon stabilitet legjislativ për veprimtarinë të cilën e rregullon. Nga arsyet e theksuara më lart, propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë Projektligjin për shërbimet e sigurisë private në parim dhe ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në procedurë të mëtutjeshme. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtarin e Kryesisë, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Unë dua të ju informoj që elektronika ime prezentë i jep 83 deputetë, në fakt në sallë nuk janë as 40 deputetë, ta keni parasysh, janë 38 deputetë në sallë. Ju lus tërhiqni kartelat e gjithë deputetëve që nuk janë këtu.

Ftoj sipas radhës deputetët, pas prezantimit të projektligjit po e hapim debatin për diskutim në parim. Ne po vazhdojmë sipas praktikës që e kemi bërë t'i diskutojmë ligjet dhe votimi të bëhet në fund, pastaj sot ose nesër sipas kohës që mund të na mbetet.

Ftoj kryetarin ose raportuesin e Komisionit për funksional të Ministrisë së Brendshme, zotin Rustem Mustafa, që ta merr fjalën lidhur me ligjin.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë së pari po ju njoftoj se Rregullorja e re e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e dimë që ka hyrë në fuqi, por unë ju njoftoj se nga administrata e Kryesisë së Kuvendit dje ka ardhur në Komision Ligji për armë, kështu që nuk kemi mundur të punojmë me Rregullore të re, ngase ka qenë koha e shkurtër, mirëpo ne jemi të njohur me ligjin, sidomos me këtë që sapo folëm, sepse e kemi pasur edhe një herë në komision, e kemi kthyer në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Unë kam bërë çmos të kontaktoj me anëtarët e Komisionit dhe jemi pajtuar që të kalojmë ligjet në lexim të parë.

Ligji, pajtohem me kryeministrin që e sheh shumë të rrugës dhe shumë të nevojshme, po bëjmë projektligjin për shërbime të sigurisë private që përmes tyre mund edhe të prodhohet siguri edhe ta ndihmojmë sigurinë në përgjithësi. Ne kemi parë që janë bërë përmirësime të dukshme dhe me përjashtim ndonjë rasti teknik nuk do të ketë nevojë të ndërhyhet më tutje në ligj dhe ne në emër të Komisionit pranojmë dhe i rekomandojmë Kuvendit që të shkojë në lexim të parë ky ligj. Ju faleminderit! Edhe gjithashtu kam folur edhe në emër të Grupit Parlamentar.

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani sipas radhës kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, është paraqitur deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka konstatuar se projektligji i plotëson aspektet kryesore që të hyjë në lexim të parë dhe të vazhdojë procedurën më tutje.

Ky projektligj e rregullon mënyrën e licencimit, kushtet dhe mbikëqyrjen e ushtruesve të veprimtarisë nga kompanitë private të sigurimit. Po ashtu është bërë deklarata dhe analiza e implikimeve buxhetore, do të thotë, ka shpenzime, sepse rritet numri i punëtorëve të administratës që do të merren me këtë çështje, po ka edhe të hyra nga licencimi i kompanive private. Në fakt këtu mungon një segment i vlerësimit buxhetor, sepse këto janë ndërmarrje biznesore dhe krijojnë të hyra tjera për Qeverinë e Kosovës, kjo nuk është analizuar dhe ndoshta në të ardhmen do të bëhet. Ka edhe disa vërejtje për këtë projektligj, ka disa të themi lajthitje në përdorimin e termeve të ndryshme, për shembull në vend të verifikimit të së kaluarës përdoret kontrolli i së kaluarës, kjo diku përdoret si verifikim diku si kontroll, pastaj në vend të policës së sigurimit përdoret fjala policë e tjera, po janë çështje që mund të rregullohen në procedurë.

Ka edhe disa çështje tjera që lidhen me çështjen e aktiviteteve të këtyre kompanive, por në përgjithësi mund të thuhet se ky projektligj në aspektin e formulimeve gjuhësore dhe logjike është dukshëm më i mirë se shumë projektligje që kanë ardhur deri më tash dhe Grupi Parlamentar e përkrah në parim dhe do ta japë kontributin në procedura të mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sa për njoftim tuajin kam një reagim nga administrata Ligji i është shpërndarë deputetëve sipas dokumentit më datën 8.9.2010. Andaj unë duhet t'i besoj dokumentit të vulosur. Sipas radhës në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah projektligjin. Ne kemi një rregullore të UNMIK-ut që është duke ushtruar ky funksion i kompanive private të sigurisë edhe tri vjet pas pavarësisë po nuk mund t'i themi se projektligji është në lexim të parë, është leximi i tretë që bëhet për këtë projektligj, sepse projektligji ka ardhur me të njëjtën tretman siç ka ardhur edhe më herët, por ne kem pasur më herët edhe në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri është shqyrtuar projektligji edhe në leximin e parë, ka ardhur për t'u votuar në leximin e dytë. Është dashur të rikthehet edhe një herë për shkak se në dy fusha ka qenë një konflikt interesi edhe për çështje tjera që e rregullojnë edhe një ligj që sot e kemi menjëherë që të shqyrtohet pas tij, por edhe Ligji për mbajtjen e armëve, për shkak se ky ka qenë një konotacion, një konflikt interesi midis kësaj që kompanitë e sigurimit fizik mund ta ushtrojnë funksionin e tyre.

Përkrahim projektligjin edhe besojmë se edhe gjatë punës në komision edhe ato vërejtje të vogla që mund të jenë brenda këtij do të largohen edhe do të dalë një ligj i ri. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues!

Ky akt ligjor, i përgatitur në këtë etapë, është i pranueshëm sipas Grupit Kuvendor të AKR-së. Kam dy – tri vërejtje parimore.

Ne neni 4 po e zëmë, duhet medoemos të riformulohet asisoj që të krijojë pozicione, kushte krejtësisht të barabarta për kompanitë e jashtme që do të kishin konkurruar në vendin tonë për ta marrë punën se kjo do të shkonte në dobinë e synimeve tona makro për integritet të gjëra për investime e tjera, te katërshi.

Te neni 11, paragrafi 8 edhe neni 44, paragrafi 6, sikundër këtij diksioni të këtij formulacioni, atëherë do të sikundër të miratohej, do të bëhej shkelje e Kushtetutës. Sa i përket të drejtës në mjetin juridik në procedurë, do të thotë, medoemos duhet të riformulohet ashtu që pala të ketë të drejtë edhe të precizohet se kujt, të mos thuhet që ka të drejtë ankese kujt, kurrë e tjera e tjera, medoemos se në praktikë krijohen huti të mëdha, aq më parë kur të gjithë s'mund të jenë juristë edhe numri i madh i juristëve nuk janë të përgatitur edhe janë juristë, por nuk janë juristë çfarë do të duhej të ishin se le më ata që nuk janë juristë.

Edhe vërejta më serioze parimore do të konsistonte në dispozitën e nenit 49 ku është cenuar substanca e parimit themelor juridik ndërkombëtarisht e pranuar që quhet e drejta e fituar. Nuk mund të bëhet asnjëherë në shtetin e së drejtës kjo praktikë që miratohet një akt ligjor edhe më pastaj sipas tij akti apo cilido akt juridik tjetër që të nulloheshin të drejtat e fituara në procedurë, nëse janë fituar në procedurë ligjore edhe në konformitet me aktin juridik, domethënë material. Prandaj, kjo është një çështje që po përsëritet shpeshherë, këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm se natyrisht dispozitat e këtilla do të binin në procedurë, bie fjala në Gjykatën Kushtetuese do të shpalleshin edhe të gjitha aktet juridike individuale të miratuara në bazë të këtyre dispozitave do të binin, prandaj, do të krijoheshin edhe pakënaqësi të mëdha edhe harxhime të panevojshme. Këto janë objeksionet parimore, natyrisht ky dokument konsiderohet se është i nevojshëm edhe shkon në favor të sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shqyrtuar me vëmendje të posaçme Projektligjin për shërbimet e sigurisë private. Grupi jonë parlamentar e përkrah në parim, domethënë, në lexim të parë këtë ligj shumë të një rëndësie të veçantë dhe të gjitha vërejtjet tona do t'i japim me shkrim në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë juve,

Zonja e zotërinj deputetë,

Ne deri më tani kemi pasur disa ligje për siguri, mirëpo sot e dëgjuam prej ministrit të Punëve të Brendshme një ligj vërtet që në parim s'kemi çka të diskutojmë ashtu një ligj para nesh s'ka qenë kurrë edhe ne Grupi "7+" me vëmendje e kemi lexuar edhe e kemi përpunuar, në parim e përkrahim edhe le të shkojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk është paraqitur askush.

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Danas znamo da imamo jako važan zakon pred nama i ovaj Nacrt zakona znamo da reguliše sve aktivnosti u oblasti privatnog obezbeđenja, izuzev normalno aktivnosti koje reguliše Zakon o policiji i u kompetenciji je Ministarstva za unutrašnje poslove.

Nacrt zakona je jako bitan, materija sa kojom treba da se bavi je jako bitna. Mi kao parlamentarna grupa jako smo ovo precizno pristupili Nacrtu zakona. Znamo da je ovaj Nacrt zakona po treći put pred nama ovde poslanicima, bio je sproveden na ime UNMIK-ove Uredbe, a zato što znamo da u Evropi postoji pored vladine institucije, kao što je policija, i privatni sektor za obezbeđenje.

Ovaj zakon je u stvari, znamo da pripada u delokrugu Zakona za socijalno osiguranje, tako je pripadao ranije, i sada ima istu svrhu Zakon o osiguranju, da li je to bezbednosti imovine, lica i sada što je jako važno, samo imamo jednu primedbu da se malo pazi kada je davanje licenci za ovu delatnost pojedinim grupacijama i građanima koji će formirati praktično jedinicu ili kako ovaj zakon nalaže, službu za pružanje specijalnih usluga obezbeđenja. Ova služba bi praktično trebala da ima sve kategorije koje ovaj zakon traži kao što znamo za čuvanje, prostoriju za čuvanje oružja, kao što znamo potrebnu opremu kada su u pitanju vozila i ostalo i normalno kada je ljudski faktor u pitanju, kada je u pitanju prošlost, naročito prošlost ovih aktera u ovom organu i što je jako važno, ovo je jedna novina ovde na Kosovu i smatramo da treba oko licenciranja zato što znamo svi da kada su u pitanju zakoni i kada su u pitanju subjekti na terenu, licenciranje otkazuje od strane svih ministarstava, ali pošto je ovo jako važan zakon, jako važna delatnost sa kojom će se baviti te organizacije, da kažem ti centri za obezbeđenje i moramo ovo da pazimo kada je u pitanju i ljudski faktor i oprema, i mesto, i adresa, i delatnost i da normalno policija nadgleda i da budu pod kontrolom Ministarstva unutrašnje poslova.

Posebno apeliramo na gospodina ministra da ovakve pojmove, kao operativce koji će biti bliski odbrani, da ovo imaju u vidu da to budu stvarno kvalitetne institucije na terenu.

Toliko od naše grupe, mi ćemo posebno da damo predloge i prilog komisijama funkcionalnim u doradi ovog zakona kada su u pitanju amendmani, i mislim da ovaj zakon kao grupa mi podržavamo i treba da stupi na snagu što brže. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të grupeve nuk ka të paraqitur më, sipas renditjes fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritet arritjen e këtij ligji dhe konsideroj që është një ligj shumë i rëndësishëm sa i përket rregullimit të kësaj materie, sepse në vendet demokratike kompanitë private të sigurimeve kryejnë një rol shumë të rëndësishëm për sigurimin e jetës dhe të pronës së qytetarëve dhe mendoj që aplikimi dhe rregullimi i kësaj çështje me ligj duke iu përshtatur standardeve të Kosovës, po duke i marrë për bazë edhe standardet ndërkombëtare sa i përket kësaj fushe janë shumë me rëndësi.

U tha për rëndësinë, nuk s'do të flas më gjatë për rëndësinë. Unë do të ndalem në disa nene të cilat mendoj që duhet Komisioni funksional pas këtij leximi t'i inkorporojë apo t'i sqarojë disa çështje që unë i kam hasur gjatë leximit. Për shembull mendoj që te neni 2 të përkufizimet ku janë diku 41 pika konsideroj se është i stërzgatur ky nen sa i përket përkufizimeve dhe ka mund të jetë më i thjeshtë, sepse janë disa përkufizime që s'do të duhet të ishin se nënkuptohen se çka do të thotë. Mendoj që duhet të sqarohet ku bëhet fjalë për aprovimin e standardeve nga Agjencia e Kosovës për Standardizim, duhet të konkretizohet cila agjenci është se kemi disa agjenci si për standardizim të produkteve, standardeve në arsim e tjera e tjera, domethënë thanë duhet të saktësohet cila është kjo agjenci dhe në kuadër të cilit dikaster qeveritar a po vepron dhe mos të ketë mandej ngatërime sa i përket të drejtës së qytetarëve për të aplikuar dhe për t'i parashtruar ankesat e tyre.

Te kushtet, mendoj duhet sqarohet edhe ekipi në kuadër të atij divizioni i cili do t'i lejonte apo do t'i suspendonte lejet përkatëse për t'u marrë me këtë veprimtari dhe ky divizion konsideroj që duhet t'i ketë profesionistët e kësaj fushe dhe të mos jenë ata zyrtarë thjesht pa një përvojë të caktuar që e njohin këtë veprimtari.

Mendoj që duhet të kihet kujdes sa i përket kompanive të huaja ndërkombëtare që e kryejnë këtë veprimtari. Ne kemi pas luftës që kanë ardhur kompani dhe shumë kush s'ka ditur se kush qëndron mbrapa tyre dhe është thjesht një punë të cilët kanë mund me shumë sukses ta kryejnë kompanitë vendore, janë diskriminuar sa i përket edhe marrjes së punëve dhe mendoj që në udhëzime administrative duhet të ketë edhe kushte shtesë sa i përket kompanive private të huaja të sigurimit që kryejnë këtë veprimtari në Kosovë.

Tek kushtet e licencimit apo të punësuarve, unë i kam vërejt disa nene si për shembull te neni 18 ku flet për kushtet e licencimit të punëtorëve të specializuar të sigurimit, thuhet këtë moshën e arritur 21- vjeçare, mandej menjëherë kërkohet përvoja e punës prej 3 vjetëve, thjesht konsideroj që duhet të eliminohet kjo. Nuk duhet të eliminohet ku bëhet fjalë për menaxherin e sigurimit, për shembull tek disa nene tjera ku flitet për menaxherin e sigurimit apo zyrtari i sigurimit që pajtohem që duhet të kenë përvojën e punës, por jo punëtorët të cilët mund të jenë në moshën 21 vjeçare, ndërsa nëse llogaritet 3 vjet përvojë pune, atëherë do të kuptohet që ai duhet të jetë prej moshës 18 vjet në punë në këtë fushë. Konsideroj që arritja e moshës është në rregull, po përfundimi i shkollimit të mesëm është mirë, përfundimi i trajnimit profesional është mirë, po të kërkohet mosha 3 vjeçare në këtë fushë të sigurimit është diskriminim për gjeneratat e reja që mund të aftësohen që të kryejnë një detyrë në këtë fushë dhe këto të eliminohen nga këto nene, vetëm aty ku bëhet fjalë për menaxherin e sigurimit ai të ketë përvojën e punës në këtë fushën e sigurimit.

Konsideroj që me amendamente duhet të eliminohet çdo formë e përgjimit është thënë këtu po ka mbet si e pasaktësuar, sepse vëzhgimi me anë të mjeteve vizive, kamerave lejohet, por nuk lejohet përgjimi as personit fizik as kompanive, domethënë në forma të tilla që ato përgjime shpesh mund të keqpërdoret dhe të cenojnë privatësinë e individit, qytetarit dhe konsideroj që me amendamente të veçanta duhet të saktësohet se në cilat fusha çka është vëzhgimi, çka është përgjimi dhe kjo nuk është përcaktuar as në përkufizime as në nenet përkatëse.

Përndryshe, ligji, në përjashtim të këtyre që i thashë, është në rregull dhe unë do ta mbështes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Së pari e falënderoj Qeverinë e Kosovës e posaçërisht Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka sjell një ligj të hartuar jashtëzakonisht mirë dhe jo vetëm ligji që tani po e lexojmë, por edhe ligjin që do ta kemi pas kësaj- Ligjin për municion, janë ligje të cilat janë hartuar, sistemuar mirë dhe natyrisht që Kuvendi i Kosovës do të ketë pak punë apo komisionet parlamentare do të kenë pak punë që ta sjellin në leximin e dytë.

Por ajo për çka e mora unë fjalën është, e ka marrë edhe disa herë, mirëpo ende po mbetet praktikë e vjetër që me të gjitha ligjet po dëshirojmë t' i kualifikojmë veprat dhe këtu po bëjmë gabim. Nuk kemi mundësi me asnjë ligj të kualifikojmë as veprën penale, as a është kundërvajtje apo vepra tjera. Këto vepra janë të kualifikuara në ligjet bazike dhe të mos ndodhë situata për shembull nëse e marrim tash nenin 45, për mrekulli janë të sistemuar të gjitha shkeljet, mirëpo nuk mund ta kualifikojmë si kundërvajtje dhe janë disa nga arsyet pse.

Së pari ju e dini që do të kemi një organizim të ri të sistemit të drejtësisë për pak kohë dhe ne detyrimisht pas një viti do të detyrohemi ta ndryshojmë dhe plotësojmë, nuk kemi nevojë të shkruajmë, sepse qëllimi i ligjit nuk është t' i kualifikojmë veprat. Nëse dikush nuk e zbaton nenin përkatës, nenin 45 dhe nenet tjera, ai detyrimisht do të marrë një gjobë që është gjoja administrative 1000 euro, 2000 euro, 5000 euro, s'është me rëndësi, nëse ai nuk e paguan këtë gjobë, atëherë procedura kalon pranë organeve të drejtësisë pranë gjykatave kompetente dhe gjykatat kompetente mandej e kualifikojnë a është për kundërvajtje, varësisht prej vlerës që e ka dhe mandej më lehtë edhe e shqiptojnë dënimin, natyrisht e kam gjobën gjithsesi por për moszbatim me kohë të gjobës parashohin edhe dënime tjera që shqiptohen në aspektin e nxjerrjes së aktgjyqimeve prej gjykatës kompetente.

Prandaj, sugjeroj që të gjitha këto nene ku është përmend kundërvajtje të eliminohen që mos ta marrë fjalën këtë po e them edhe me qëllim të Komisionit funksional parlamentar edhe në ligjin tjetër ku e kanë klasifikuar si vepër penale prodhimin e municionit apo marrjen edhe atje të eliminohet, sepse nuk është vepër penale, veprat penale shumë mirë i qartëson Kodi Penal dhe ne nuk kemi mundësi. Dhe do të ishte me interes që të mos përsëriten gjërat, për shembull në nenin 49 thuhet që pas hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk lëshohet asnjë licencë me Rregulloren aktuale të UNMIK-ut.

Mandej në dispozitat përfundimtare thuhet në nenin 52 me hyrjen në fuqi të këtij ligji çdo legjislacion tjetër sekondar që është në fuqi dhe që rregullon kompanitë e licencuara për sigurim nuk duhet zbatohet. Domethënë, është çështje e njëjtë nuk kemi nevojë t'i kemi dy nene, sepse vetvetiu me hyrjen në fuqi nuk ka mundësi të përdorët asnjë rregullore e keni thënë shumë në nenin 51, por neni 49 në disa nene janë të panevojshme.

Edhe një herë po them ligji është jashtëzakonisht i mirë edhe ligji që vjen pas këtij ligji jashtëzakonisht i shkruar mirë dhe do ta kemi shumë lehtë si komisione parlamentare, përveç këtyre intervenime që të mos i kualifikojmë vepra penale.

E kam edhe një sugjerim, po ju them qartë prej kryetarëve të gjykatave, ju lutem mos na vendosin në këtë pozicion se po i kualifikoni veprat dhe ne s'po dimë çka të bëjmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për shërbimet e sigurisë private është sa i rëndësishëm, po aq edhe i ndjeshëm dhe këtë e tregoi edhe vetë ministri në prezantimin e tij kur e tha se ka filluar që nga viti 2007, që është edhe e vërtetë, por tregon se është një fushë që kërkon me të vërtetë një angazhim dhe një mbikëqyrje më të madhe të këtij sektori.

Nevoja për rregullimin e kësaj fushe me kornizë ligjore është e domosdoshme për shkak se këtë projektligj e shoh si një kontribuues të sigurisë së përgjithshme në Kosovë, duke marrë parasysh faktin se institucionet ekzistuese të sigurisë në Kosovë nuk janë në gjendje t'i përgjigjen çdo sfide që duhet të mbrojtjes së pronës dhe jetës së individit.

Qëllimi i këtij projektligji është ta rregullojë fushën e veprimtarisë së kompanive private: kushtet e veprimtarisë, pastaj të drejtën për licencime, kushtet për licencim, ushtrimin e aktiviteteve, kualifikimet profesionale, autorizimet, një gjë shumë e rëndësishme është përdorimi i forcës, që është definuar në ligji, pastaj pajisjet e tyre dhe posedimi i armëve.

Një çështje tjetër me rëndësi që rregullon projektligji është gjithashtu edhe bashkëpunimi me institucionin e Policisë, do të thotë bashkëpunimi me Policinë dhe janë paraparë gjithashtu dispozitat që duhet t'i përmbajë çdo projektligj që janë ato të mbikëqyrjes, mbikëqyrja bëhet nga inspektori si dhe dispozitat ndëshkuese.

Megjithatë duke marrë parasysh në praktikë se nuk ekziston ende një kontroll e mjaftueshme e këtyre kompanive private, zoti ministër unë ju propozoj që të keni një pasqyrë të saktë se sa kompani private ndodhen në Kosovës. Mendoj se kjo është shumë e rëndësishme dhe përveç zbatimin e ligjit me qenë se sipas memorandumit shpjegues thotë se të hyrat nga kompanitë private do të jenë 40 mijë euro. Unë mendoj se ekziston një numër shumë më i madh i kompanive private dhe se të hyrat duhet të jenë shumë më të mëdha. Këtë e them sepse ekziston një paqartësi financiare lidhur me zbatimin e ligjit, sidomos ajo e cila ka të bëjë me formimin e një mekanizmi shumë të rëndësishëm siç është Komisioni i Ankesave për sigurinë private. Pasi që buxheti nuk i ka paraparë konsideroj se një mënyrë për të siguruar se ligji do të zbatohet në praktikë është që të keni një pasqyrë të saktë të numrit të kompanive private.

Një çështje tjetër është se sa i përket legjislacionit të BE-së, se sa është i harmonizuar do të theksoj se BE-ja nuk ka të paraparë ndonjë legjislacion të posaçëm për këtë fushë, por e ka një rregullore me të cilën rregullon, gjegjësisht sigurinë private në aviacion.

Ndërsa, sa i përket një vërejtje, unë kisha dashur të shoh se nuk do të jenë veç burrat në këto kompani private, por se do të ketë edhe gra të cilat do të punojnë dhe do të kontribuojnë në siguri. Sipas disa studimeve në kompanitë private në Kosovë janë diku vetëm 1 deri në 2%.

Përndryshe ligji është i hartuar mirë dhe në parim e mbështes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit,

I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë do të përpiqem që të jap një kontribut sado të vogël në këtë projektligj, përkundër faktit që po më duket me këto projektligje Qeveria po krijon organe paralele të shtetit. Unë po përpiqem të gjejë këtu dallime të cilat ekzistojnë në mes të kompetencave që i kanë këto kompani të sigurimeve dhe Policisë së Kosovës dhe po më del që shumë pak, kompetenca ma tepër ka Policia se sa që kanë këto kompani të sigurimeve. Në veçanti të çështja e kontrolleve edhe ndalimit të qytetarëve, përkundër faktit se këtu thuhet që në objektet të siguruara, ndërkaq ju e dini që tashmë po thuaj se nuk ka asnjë

objekt madje as një shitore e cila nuk sigurohet prej kompanive të sigurimit. Dhe, logjikisht kjo i bie që kompanitë e sigurimit kanë të drejtë t'i ndalojnë qytetarët në cilindo objekt që sigurohet nga ana e tyre. Madje, sipas kësaj që shihet këtu brenda një kohe shumë të shkurtër edhe Policinë e Kosovës ka mundësi që do ta sigurojnë kompanitë e sigurimit, domethënë kjo është logjika e mbrapshtë që po ndodhë në ndërtimin e sistemit të këtij vendi.

Zoti ministër,

Nuk di sa e keni vlerësuar drejtë këtë, por ky ligj bie në kundërshtim me të drejtat e njeriut, sepse u jep autoritet organeve të paautorizuara jo shtetërore që të ndalojnë njerëz, që të legjitimojnë njerëz, që është në kundërshtim edhe me normat ndërkombëtare.

Nëse i shikoni nenet, në vazhdimësi të kompetencave dhe të drejtat. Nëse, përpos Policisë së Kosovës dhe përpos pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka edhe këtu autoritete të tjera private të cilët legjitimojnë njerëz të cilët bartin armë të zjarrit, të cilët e përdorin forcën, madje këtu në një vend thuhet nëse munden proporcionale për t'i garantuar të drejtat e njeriut atëherë kjo nuk është kurrëgjë tjetër përpos edhe një polici. Po e them nuk do të jetë kohë e largët kur edhe Policinë e Kosovës do ta ruajnë këto kompani të sigurimit dhe pastaj Policia e Kosovës do të na ruaj neve, domethënë kjo është logjika e ndërtimit të mbrapshtë të sistemit të sigurisë në vend. E di që mund të keni edhe këtu edhe në kuadër të Qeverisë ka njerëz të cilët janë të interesuar të shkojnë përpara këto kompani të sigurimeve, sepse mund të kenë pjesë në to, por kësaj po shkatërrohet në tërësi sistemi i sigurisë në Kosovë.

Po pyes, zoti ministër dhe po dua një përgjigje, jo për mua për qytetarët e Kosovës, përpos autoriteteve shtetërore kush tjetër ka të drejtë që të legjitimojë njerëz, kush tjetër ka të drejtë që të kontrollojë njerëz, kush tjetër ka të drejtë që të kufizojë lirin e lëvizjes së njerëzve? Me këtë ligj që ju na keni sjell sot kanë edhe kompanitë private të sigurimit, që është në kundërshtim edhe me Kushtetutën edhe me normat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

E di që do të duhej pasur diçka të tillë por nuk mund të kenë kompetenca kaq të mëdha, ne, Policisë së Kosovës që është institucion shtetëror i ka disa kontrole është Komisioni Parlamentar, është Inspektorati i Policisë dhe ka një kontroll civile demokratike, ndërkaq ndaj këtyre kompanive nuk ka ndonjë autoritet i cili i kontrollon në vazhdimësi sjelljet e tyre. Edhe sot madje në këtë gjendje çfarë jemi ju përditë e shihni se çfarë maltretimesh në raste të ndryshme kanë qytetarët e ndryshëm nga ana e pjesëtarëve të kompanive të sigurimit. Po them edhe një herë, nëse keni menduar ta bëni edhe një polici paralele për ta ruajtur Policinë e Kosovës, është çështje krejt tjetër, por kësaj po i shkëlmi rënd të drejtat e njeriut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rrustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, për fjalë!

Unë veç desha ta ngrit një shqetësim timin a i lexon Qeveria emrat e ligjeve së paku, sepse këtu në faqen e parë që na ka dhënë Qeveria po thotë në mbështetje të vendimit të Qeverisë për aprovimin e Projektligjit për industrinë e sigurisë private, edhe këtu thotë Projektligji për shërbimet e sigurisë private. Domethënë, veç të jenë konsekuent të na tregojnë që me të vërtetë i lexojmë eventualisht mund ta transmetojnë edhe ndonjë mesazh tjetër që me të vërtetë ne i trajtojmë këto kompanitë e sigurisë private si industri ku mund të bëjnë para. Edhe ashtu jemi mësuar me sektorë tjerë, si për shembull edhe rryma është mall, po edhe më e keqja, uji blihet e ndoshta e kanë pasur mendjen veç nuk kanë qenë të koncentruar edhe e kanë qitur titullin e ligjit tjetërfare. Kështu që mirë është kur të

na vinë ligjet të jenë së paku në vijë, s'është ndonjë dijeni shumë e madhe e nevojshme edhe ashtu po krekosen kot, së paku t' i lexojnë emrat e ligjeve për brendësi edhe mos t' i lexojnë, ndoshta ne i lexojmë më në detale këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Naser Rugova, e ka fjalën.

NASER RRUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është një ligj i rëndësishëm që ka të bëjë me shërbimet e sigurisë private në vend, i cili mbulon sektorë të caktuar ku institucionet kompetente për siguri të vendit, qoftë për shkak të natyrës, privatësisë apo edhe angazhimeve tjera, por është edhe një formë alternative e sigurisë që i lejon të drejtë qytetarit të bëjë zgjedhje vetë.

Unë shkurt do t' i potencoj dy çështje: Standardet profesionale të Kosovës duhet përcaktohen mirë, duhet të adresohen qartë, sepse kemi të bëjmë me disa kompani të sigurimeve në Kosovë, me një numër të theksuar, sidomos të njerëzve të rinj që janë të punësuar në këto kompani dhe këtu si Kuvend duhet t' i orientojmë drejtë, qartë dhe në bazë të kompetencave profesionale të licencimit të këtyre kompanive.

Çka desha të theksoj që është shumë me rëndësi, në një nga paragrafët e këtij projektligji thuhet që: përgjimi i telefonatave për 3 muaj për tërë klientët e kompanisë. Atëherë zoti ministër, konsideroj që kompanitë e sigurimeve kur lidhin marrëveshje, qoftë me persona juridikë apo fizikë kompani apo mekanizma institucional, që është legjitime, sepse këto aplikohen edhe në vendet me demokraci më të zhvilluar, duhet të kemi parasysh privatësinë edhe të klientit, por edhe të kompanisë dhe duhet të kemi kujdes, sepse këtu cenohet privatësia dhe konsideroj që mund të ketë edhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut që bie ndesh edhe me Kushtetutën e vendit. Andaj, komisionet funksionale, në veçanti Komisioni funksional gjegjës, vërtet duhet të ketë kujdes sa i takon kësaj çështje dhe duhet të harmonizohet ashtu si është e paraparë në direktivat e Bashkimit Evropian, që i takon këtij legjislacioni.

Te e fundit shtetet anëtare të BE-së hartojnë legjislacion nacional dhe nuk ka legjislacion unik, as në direktivat të caktuara, po as në asquis communautaire, andaj ne duhet t' ia përshtatim sa më mirë ligjit që i shërben sigurisë, privatësisë, por edhe drejtave dhe lirive të njeriut, por edhe ushtrimit të drejtave dhe lirive në punë të kompanive private dhe të punësuarve të tyre, por edhe klientëve dhe aspekteve të caktuara, qoftë publike, qoftë private që ju shërbejnë këto kompani, sepse te e fundit ligji u dedikohet qytetarëve dhe njerëzve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të nderuar ministra, dhe ju kolegë deputetë,

Vërtet nuk desha të lajmërohem kur edhe dëgjova se ligji është i mirë u tha në përgjithësi, mirëpo kur dëgjon aso prirje destruktive që të diskreditohet çdo nismë, çdo punë që ndërmerr Qeveria, është e pamundur njeri të jetë indiferent. Një mbrapshti e tillë e logjikës se gjëja me emër të një kategorie morale nuk duhet të rregullohet një sferë e caktuar e jetës tonë shoqërore është paksa disi e pa akceptuar nga një logjikë e drejtë. Ligji është i rëndësishëm, kështu ligje ka gjithkund në shtetet e qytetëruara në botën e qytetëruar. Është e vërtetë që duhet të ketë kujdes që privatësia e qytetarëve të

ruhet, këtu duhet të kemi një angazhim më të madh në shqyrtimin e ligjeve të shteteve të cilat kanë përvojë në këtë sferë që mos të bie ndesh me privatësinë, përndryshe ligji ka një rëndësi të veçantë mbrojtja e pronës dhe sigurimi alternativ, do të duhet të ishte një ndihmesë e madhe edhe për Policinë e Kosovës. Nuk ka ndërhyrje kompetencash, normalisht në objektet ku sigurohen punëtorët e kompanisë se sigurimeve kanë të drejtë të ndalojnë persona. Bëhet fjalë për objektet ku ata i sigurojnë ose në rast se e sigurojnë një individ mund çdonjëri prej nesh të bëjë një kontratë për siguri personale ose banesës ose të shtëpisë, dhe në rast se ata hetojnë ndonjë lëvizje që rrezikon sigurinë, qoftë të shtëpisë, qoftë të individit, në një afërsi të caktuar, kanë të drejtë të legjitimojnë një individ, por nuk kanë të drejtë të ndalojnë, të arrestojnë, të burgosin e gjëra të tjera.

Kështu që unë mendoj që ligji është shumë i rëndësishëm, është shumë i mirë, prodhon siguri për qytetarët, për pronën, për biznesin e kështu me radhë, kështu që është mirë që të logjikojmë në këtë mënyrë, në mënyrë pozitive. Ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Adem Hajdaraj e ka fjalën.

Deputetit Adem Hajdaraj, fjalën regjia, ju lutem.

ADEM HAJDARAJ: Ju përshëndes, pra, të gjithëve!

Unë desha vetëm nja dy fjalë të ndalem rreth disa formulimeve jo të drejta, përndryshe ligji është i mirë dhe e përkrah natyrisht, parimisht do ta përkrah dhe do ta votoj.

Mirëpo, për shembull neni, domethënë 5, këtu dua të them pika 5 e nenit 28, 27, shkruan kështu: Kompanitë private të sigurimit të licencuara që ofrojnë shërbime vëzhgimi elektronik të pronës duhet të sigurojnë se vëzhgimi elektronik është i kufizuar në, edhe shkruan kështu: Mbikëqyrjen e lëvizjes në dhe ose përreth hapësirës së siguruar. Nuk mund të thuhet kështu, po duhet të jetë: Mbikëqyrjen e lëvizjes në hapësirën e siguruar dhe për rreth saj, e jo dhe vizë, në ose, këto dy lidhëza nuk e plotësojnë gjithë këtë.

E dyta po ashtu 5.2: “Zbulimin dhe identifikimin e prezencës së personave të paaautorizuar në, dhe ose për rreth hapësirës së siguruar”, domethënë, në hapësirën e siguruar dhe përreth saj, ose përreth saj, e jo në, vizë dhe, të dy lidhëzat për ta shkurtuar gjëja.

5.3 “Zbulimin e pronës së zjarrit në, dhe vizë ose për rreth hapësirës së siguruar”, edhe këtu duhet të lidhet, domethënë, të thuhet “Zbulimin e pranisë së zjarrit në hapësirën e siguruar dhe për rreth saj”, domethënë, nuk bënë këtu dhe ose.

Përndryshe, është edhe një gabim aty edhe pika 7 ku thuhet: “Vendosen dhe ose për rreth hapësirës së siguruar”- kjo nuk bënë të thuhet kështu, por të shkruhet: “Në hapësirën e siguruar dhe për rreth saj, ose për rreth saj, përndryshe dhe ose nuk mund t’i përfaqësojë të dy këto pjesë .

Ka edhe ndonjë lëshim të vogël, por ligji është i mirë dhe do ta votoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa i përsëritur parafolësit e mi, dëshiroj ta them një vërejtje në këtë projektligj. Vërejtja ime është në nenin 43, ku flitet për suspendimin e licencës. Thuhet se organi kompetent mund ta suspendojë licencën për periudhën deri në një vit nëse në pikën, domethënë 1.1 çdo informatë e ofruar në lidhje me kërkesën për licencë vërtetohet se është e pavërtetë dhe mashtruese.

Pastaj në nenin, domethënë në pikën 1.2, i licencuari ka bërë gabime dhe ose lëshime në dhënien e informatave gjatë aplikimit për licencë dhe pastaj vazhdojnë, domethënë, raste të tjera kur mundet të suspendohet licenca, pastaj është pika për shembull 1.4. që është gabimisht e formuluar, janë gjetur gjatë inspektimit nga ana e organit kompetent, çka janë gjetur nuk sqarohet. Mirëpo, vërejtja ime është se tek pika 1.1. kemi të bëjmë me ofrimin e informatave të gabuara dhe të dhëna në mënyrë të qëllimshme, derisa e dyta ka të bëjë me gabime të cilat në një mënyrë ndoshta janë nga pakujdesia, të dyja ndëshkohen me ndëshkim të njëjtë, çka do të thotë suspendimi i licencës për një vit.

Tek pika 5 thotë: Në rast të refuzimit të ankesës, i licencuari duhet të dorëzojë licencën menjëherë pas pranimit të vendimit përfundimtar, për çka jam kundër, sepse fillimisht duhet që licenca të lëshohet pasi që të vërtetohen të gjitha dokumentet dhe të gjitha faktet e jo të lëshohet, pastaj të suspendohet. Prandaj, edhe në këtë rast mendoj që duhet të rregullohet pjesa e suspendimit të licencës.

Përndryshe e kam lexuar këtë projektligj, është i formuluar mirë, është i kuptueshëm dhe e përkrah. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Ibrahim Gashi e ka fjalën.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk do të flas shumë, sepse nuk e ndie veten shumë kompetent që të flas për këtë ligj, por natyrisht nga shqetësimet që u ngritën si të them kompetencat e mëdha që jepen kompanive të sigurimeve, sigurisht që edhe unë nuk mund të jem shumë indiferent për faktin se Kosova është një vend që në një farë mënyre ka një traditë të shkurtër shtetërore, një kulturë jo shumë konsoliduar demokratike dhe mbi të gjitha një vetëdije jo shumë të lartë institucionale. Dhe kur i ke këto parasysh, mundësitë e abuzimit me këto kompetenca të një kompanie e cila rekruton njerëz me një kurs njëmuor, duhet pasur parasysh se janë evidente. Dhe nëse i lihet që kompanisë të ketë një gamë të gjerë të kompetencave që një farë mënyre është e krahasueshme me policinë organin si të them profesionalisht shumë më të përgatitur dhe me ligj shumë si të them më legjitim, atëherë mundësia e abuzimit me këto kompetenca në një farë mënyre mund të paragjykohej.

Mua nuk më pëlqen që disa nga kolegët po na mbajnë leksione vazhdimisht, domethënë se roli i deputetëve nuk është për ta atakuar një farë mënyre asgjë që vjen prej Qeverisë. Unë po ju rekomandoj edhe në rastin më herët kur fola po i rekomandoj deputetit që s'është prezent këtu, që nuk ka nevojë të na mbaj këso leksionesh, secili duhet ta dimë që para gjithash jemi deputetë e pastaj mund të jemi proqeveritarë, ndoshta të tillët kanë një farë mënyre benificione të qenit shumë proqeveritarë dhe na mbajnë leksione të tilla neve që të mos jemi antiqeveritarë, po misioni i deputetit dhe roli i Parlamentit është, përveç ligjvënës, është edhe mbikëqyrës ndaj Qeverisë. Prandaj, janë bërë si bajate leksionet e tilla që po na vijnë prej një grupi 1, 2, 3 deputetëve në vazhdimësi.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Gani Geci e ka fjalën.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Po besoj që Ganiu e kreu.

Projektligji për shërbimet e sigurisë private është një prej projektligjeve që i duhet Kosovës, sepse kjo lëmi nuk ka qenë e rregulluar me ligj dhe tash të gjitha kompanitë private duhet të bazohen në këtë ligj. Unë më duhet të ndërlidhem në nenin 42, raportimi i kompanive private të sigurimit, është fjala te neni 42 pika 4.4.1, ku thuhet se tre muaj nga momenti i regjistrimit të gjitha komunikimet telefonike dhe nga qendra e kontrollit duhet t'i dorëzohen dikujt tjetër. Ju e dini se përgjimet telefonike dhe komunikimet telefonike kanë të drejtë të bëhen vetëm me urdhër të prokurorit dhe me urdhër të një gjykate dhe absolutisht nuk ka të drejtë asnjë kompani private e telefonisë që të përgjojë dikën dhe aq më pak që biseda telefonike të dikujt t'i parashtrijë dikund tjetër ose t'i qojë në Ministrinë e Punëve të Brendshme apo në ndonjë ministri tjetër. Prandaj, asnjë kompani private, as nuk ka të drejtë ta përgjojë një bisedë telefonike pa një urdhër të gjykatës ose pa një urdhër të prokurorit dhe në këtë ligj kështu nuk bën të shkojë për arsye se i lejohet kompanisë private të përgjojë biseda telefonike edhe më vonë, këto biseda telefonike t'ua dorëzojë dikujt tjetër.

Ndërsa sa i përket rregullimit të ligjit ky ligj është i rregulluar mirë, është i rregulluar më mirë se të gjitha ligjet që na vijnë nga Qeveria se nganjëherë na vijnë edhe të pakuptimta, fjala me fjalë nuk lidhet edhe nëse lidhet me një kuptim tjetër nga e para në të dytën.

Prandaj, unë personalisht mendoj se duhet ta mbështesim këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Emrush Xhemajli, i fundit është.

Thirrni për votim.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se në parim duhet të mbështetet Ligji për shërbimet e sigurimeve private. Gjatë punimit ata që patën ose që mund të kenë vërejtje duhet të kontribuojnë që t'i përmirësojnë ato gabime, sidomos aty ku u cek më herët në vendet ku mund të ketë ndeshje me parimet e lirive dhe drejtave të njeriut në përgjithësi.

Ndërkaq, si industri e ka bota edhe duhet të jetë edhe te ne kështu siç është në mënyrë të rregulluar. Qe tri herë është kthyer ky ligj, duhet për shkak se edhe janë bërë shumë përmirësime që të kalojë, por edhe për faktin se kompanitë e sigurimeve janë në një gjendje në një pozitë të vështirë, janë duke punuar në kushte ku mungojnë shumë rregulla, shumë nene të ligjeve që e rregullojnë veprimtarinë e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ministri donë të na kursej kohën. Koha është për votim.

Në sallë kemi 70 deputetë, po e votojmë ligjin.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 62 vota "për", 2 "kundër" dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shërbimet e sigurisë private.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione: Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri si Komision funksional dhe komisionet e përhershme. Komisionet duhet që në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë projektligjin.

Urdhëro, zoti Bajram.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri të sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Hartimi i projektligjit për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri ka filluar që nga muaji prill i vitit 2009. Në përpilimin e këtij drafti kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësuesit e misionëve ndërkombëtare në Kosovë, ku interesim të veçantë kanë shprehur përfaqësuesit e ICO, EULEKS-it ICITAP-it, dhe Kosak, UNDP-i, të cilët përmes përfaqësuesve të tyre kanë dhënë disa rekomandime të cilat edhe janë inkorporuar në projektligj.

Duke u mbështetur në rëndësinë dhe peshën që ka ky ligj për Kosovën dhe institucionet e saj, shihet qartë se bëhet fjalë për projektligj me prioritet të lartë për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Nevoja për këtë projektligj është e madhe për faktin se deri më tani kjo fushë nuk ka qenë e mbuluar me ligj, andaj është nevojë imediate nxjerrja e këtij ligji për t'u mundësuar furnizimi dhe pajisja me armë dhe pajisje tjera për agjencitë e autorizuarra shtetërore të sigurisë.

Projektligji ka për qëllim që t'i adresojë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me: prodhimin, riparimin, tregtinë, importin, eksportin, vënien e shenjave identifikuese, evidentimin, sigurinë gjatë deponimit dhe transportit, dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kushtet për armët, municionin dhe pajisjet përkatëse për siguri për nevojat e institucioneve të autorizuarra shtetërore të sigurisë.

Projektligji ka IX kapituj me gjithsejtë 38 nene. Projektligji për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri ka implikime buxhetore, që vlerësohet të jenë përafërsisht rreth 1 milion e 969 mijë e 500 euro, sipas viteve paraqitet. Viti 2010 vlerësohet se nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore, viti 2011, kostoja shtesë buxhetore do të jetë një milion e 601 mijë e 500 euro dhe viti 2012, kostoja shtesë buxhetore do të jetë 368 mijë euro.

Projektligji ka deklaratën e pajtueshmërisë të Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimin Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Projektligji krijon stabilitet legjislativ për fushë veprimtarinë të cilën e rregullon. Nga arsyet e theksuara më lart propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë në parim projektligjin për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet të autorizuara shtetërore për siguri dhe ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës në procedurë të mëtutjeshme. Ju faleminderit për durim!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani e hapi debatin për diskutim në parim. Sipas radhës kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, zoti Mustafa e ka fjalën.

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri do të jetë komision funksional për shqyrtimin e këtij projektligji. E vlerësoj se ky projektligj është i hartuar mirë dhe që duhet të miratohet në parim.

Unë dua të paraqes disa vërejtje në vazhdim lidhje me këtë projektligj.

Në tekstin e këtij projektligji nuk specifikohen se cilat lloje të armëve dhe cilën sasi mund të aprovohen nga ministri, Qeveria apo Kuvendi.

Projektligji nuk definon qartë fushën rregullative të tij. Ky projektligj do të duhet t'i caktonte saktë parametrat, kriteret dhe llojet të cilat mund t'i përdorin institucionet e caktuara të sigurisë.

Në këtë projektligj nuk janë hartuar qartë përkufizimet, rregullat e procedurës administrative dhe dispozitat ndëshkimore.

Projektligji nuk saktëson qartë organin kompetent për përcaktimin e politikave dhe dhënien e lejeve për furnizim me armë dhe municione. Pra, duhet të rishikohen dhe të sqarohen mirë nenet 6 dhe 7 të projektligjit.

Sa i përket harmonizimit gjuhësor të Projektligjit duhet t'i bëhet një lekturë gjuhësore dhe juridike, sidomos tekstit në gjuhën shqipe.

Komisioni ka marrë për obligim që këtë ligj ta punojë më shpejtë me procedurat dhe do të përpiqemi që duke konsultuar edhe sponzorizuesin edhe ekspertë tjerë sa më shpejtë që është e mundur ta dërgojmë në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas Rregullores tani e kanë fjalën kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Basri Musmurati.

BASRI MUSMURATI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe kemi konsideruar se projektligji për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, është nga projektligjet e hartuara mjaftë mirë nga Qeveria e Kosovës.

Me gjithë këtë konsiderojmë se duhet dhënë edhe disa vërejtje që në procedurën e mëtutjeshme, lëshimet eventuale që janë bërë të plotësohen. Për shembull, duhet të ketë përkufizime më të plota të lloji i armëve që nga neni 3, paragrafët 1.6, 1.7, 1.8, 1.12, 1.13, si dhe te nenet 16 dhe 19, që kanë të bëjnë me lejen për tregti me pajisje për qëllime të veçanta.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë në procedurën e mëtutjeshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kryetari i Grupit, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj dhe ne kontributin tonë do ta japim në komisionet në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zotëri kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah projektligjin. Kuvendi i Kosovës ka miratuar një ligj më herët që është Ligji për armët, nuk e dimë, Qeveria e Kosovës sa ka mund t'i harmonizojë edhe t'i nxjerrë aktet e tjera nënligjore lidhur me mundësinë e zbatimit të atij projektligji, sepse po më duket ende janë duke u përsëritur procedurat e UNMIK-ut për pajisje me armë të atyre qytetarëve apo mekanizmave tjerë që lejohen me ligj të kenë mundësi për të mbajtur armë, sepse paraprakisht aty janë përcaktuar edhe forma se si duhet të pajiset po edhe paraprakisht procedurat se si duhet të arrihet për t' u pajisur dikush me armë. Kam pasur rastin të shoh qytetarët e Republikës së Kosovës që janë pajisur me armë, por neve na mungojnë ato poligonet e mëhershme në të cilat duhet të kryhen ushtrime, stërvitje dhe të ketë njohuri sa më shumë, një njeri që mund ta përdorë armën është duke u shkelur pikërisht ai ligj, sepse ato akte nënligjore nuk janë të rregulluara. Këtë po ju them, sepse ka një kolizion mes atij ligji dhe këtij ligji, sepse fund e krye kategorizimi i armëve brenda këtij projektligji dhe atij ligji nuk ka qenë i nevojshëm të përshkruhet në këtë ligj. Ne e dimë sa janë të integruar mekanizmat tonë të sigurisë, por është edhe me vetë ligjet për krijimin e këtyre mekanizmave që përcakton edhe kalibrat e armëve që mund t'i përdorin këta mekanizma të sigurisë deri në fazën e caktuar kur nuk ndryshojmë një ligj të caktuar. E them se kushtimisht është e lejuar me ligj që Forca e Sigurisë të pajiset me armë kalibri deri 12.7 milimetra, në këtë rast iu ka dhënë një hapësirë e mirë kur thuhet për këtë domethënë pajisjet e veçanta, për qëllime të veçanta që jepet një hapësirë edhe më e mirë me këtë projektligj.

Ne do ta përkrahim projektligjin edhe do ta japim kontributin tonë në mekanizmat, konkretisht në këtë rast në Komisionin përkatës për Siguri dhe Punë të brendshme. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së e ka fjalën Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zotëri kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar këtë projektligj. Ne i kemi disa vërejtje sa i përket këtij projektligji. Për shembull tek përkufizimi tek pika 1.14, tek armët e ftohta e kemi krahasuar edhe në Ligjin për armët, është përkufizimi i njëjtë, mirëpo ndoshta do të ishte mirë që të jepej një përkufizim më i mirë në lidhje me këtë.

Pastaj në pikën 1.35 fillimisht shpjegohet arma jo vdekjeprurëse ose armë nënshtruese, çka është gabimi i përkthimit nga serbishtja, jo nënshtruese, po mbizotëruese, do të thotë, përfundimisht duhet të kemi kujdes edhe në përkthimin e projektligjeve. Fillimisht jepet shpjegimi, pastaj jepet përkufizimi i fjalës që duhet të ndërrohet, do të thotë, fjala, pastaj shpjegimi.

Gjithashtu mendoj se duhet të kemi kujdes tek neni 6, tek prodhimi dhe riparimi i PQV-së. Pastaj duhet të kemi kujdes tek kushtet e licencimit sa i përket prodhimit, tregtimit dhe transportit. Te kushtet mendoj se duhet të kemi kushte do të thotë ka më pak, është mirë të ketë kushte më tepër, sepse është një lëmi shumë e rëndësishme.

Por, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e përkrah në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar LDD-së, e ka fjalën deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me që na u përziën partitë politike edhe unë kam një propozim, LDK-ja të shkrihet në PDK, se ashtu- kështu po i bëjnë punët e PDK-së, ndërsa sa i përket ligjit për riparimin, prodhimin, importimin, eksportin dhe vënien e shenjave identifikuese dhe evidentimin e armëve dhe municioneve, dihet se aktualisht Kosova nuk e ka të rregulluar mënyrën dhe kushtet e furnizimit me armë, andaj ky ligj është i punuar mirë. Ne si Grup Parlamentar e Lidhjes Demokratike të Dardanisë, vërejtjet tona do t'i japim gjatë amendamentimit dhe ne e mbështesim në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Beqiri e ka fjalën për replikë.

ISMET BEQIRI: Unë po e them edhe një herë, i pata thënë zotëri Ganiut, unë e respektoj shumë, por, po i them miqësisht çështje është mirë të merret me parti të vet edhe me punë të veta, me sinjeritetin më të madh nuk ka nevojë se unë e kuptoj edhe dozën e humorit e të tjera, po ne jemi një institucion serioz si Parlament, si deputetë. Prandaj e kisha sugjeruar nuk, nuk ka nevojë, sepse edhe unë mund t'ju them hajde shkrijuni edhe të shkriret janë për të ardhur në LDK, ky apo ai subjekt. Unë po them me sinjeritet dhe unë e respektoj, të shkriret me LDD-n e pata fjalën se kuptohet ajo që duhet të vijë, por nuk po merremi me këtë punë, e kisha lutur se nuk është hera e parë dhe nuk po dëshiroj çdo herë të reagoj ka edhe diskutime nganjëherë jo serioze edhe dikujt- dikujt tjetër të kësaj natyre. Është mirë t'i shikojë secili punët e veta, kush është i shkriret ku, me kohë do të shihen të gjitha këto. Prandaj, konsideroj që do të duhej të kishim konsideratë dhe t'i lëmë këto, sepse megjithatë ka disa rregulla që tejkalohen nganjëherë pa nevojë.

KRYESUESI: Hajde ke drejtë një minutë.

GANI GECI: Unë e kuptoj kryetarin e Grupit Parlamentar edhe e di që është LDK, po fatkeqësisht kryetari i tij është nënkryetari i PDK-së, ky është problemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe një herë Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Shikoni, zoti kryesues,

Edhe një herë po e them po e lus Ganiun, miqësisht po i them, mos u merr me punë të kota, sepse ka punë më të mençura dhe ne e dimë kush ku është, e kush ia bën argatin edhe dikujt tjetër, pa u deklarua publikisht. Ku është kryetari ynë, ne e dimë të gjithë, e kush është kryetari yni, prandaj këtu janë joserioze dhe mendoj që megjithatë unë llogaris që kanë nostalgji njerëzit, i kuptoj.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” e ka fjalën Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ju edhe për ministrat që janë këtu.

Ne, që disa kohë kemi pasur disa ligje që jemi ne në Komisionin për Siguri, mirëpo kësaj radhe, vërtet Grupi jonë “7+” kur e kemi shikuar këtë ligjin s’kishim ku ta gjejmë një zbrazëtitirë, mirëpo ligji është në herën e parë në lexim, besoj se në leximin e dytë do të përmirësohen këta sendet që i thanë dikush, a ne gjithqysh e pranojmë këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Mi kao grupa, kada smo razmatrali Nacrt zakona, videli smo da ovaj Zakon o oružju, municiji i opremi ima jasan cilj, gde se utvrđuju zakonske odredbe u vezi opremanja oružjem, municijom i bezbedenosnom opremom, normalno za potrebe državnih institucija za bezbednost.

Videli smo da Nacrt zakona ima određen delokrug rada, gde se definiše proizvodnja, opravka, trgovina, uskladištenje i transport oružja i municije za potrebe Kosovske policije, Kosovske agencije za inteligenciju, za Kosovsku carinu i Agenciju za šumarstvo Kosova. U Nacrtu zakona se identifikuju sve vrste oružja, sve kategorije oružja od vatrenog, eksplozivnog, hladnog oružja do oružja pomoću elektro-šoka i opisane su sve vrste municije. Međutim, u članu 4. date su odgovornosti. Kada su u pitanju odgovornosti, imamo jednu jako važnu primedbu, gde se kaže: Da nadležni organ vodi centralnu (čitam tačku 2. člana 4.) centralnu bazu podataka, koja obuhvata celokupno oružje, svo oružje, municiju i ostalo. Koji nadležni organ, moramo da znamo koji nadležni organ? Znači, nije definisan nadležni organ.

Dalje, kada je u pitanju postavljanje znakova za identifikaciju, evidentiranje i uskladištenje oružja i municije, mora da se da zakonska azbuka koju moramo sprovesti, zakonska azbuka. Ovaj zakon ima obavezu za davanje licenci, kao i ostali zakoni za proizvodnju, opravku, licencu za trgovinu, sa obavezom za posedovanje dozvole za trgovinu, izdate od nadležnog organa. Opet pitam - kog organa? Nema definisano u zakonu, zatim dozvola za transport, ponovo - koji organ? Pored licence moraju da imaju dozvolu, da nemamo da kažem primedbu, kao što imamo kaos u građevinarstvu. Dozvolu za transport, ukazujemo ponovo - na koji organ i Nacrt zakona znamo da definiše mesta za uskladištenje oružja. Potrebno je da se bolje analiziraju kaznene odredbe, gde su na osnovu člana 33. nejasne i mogu se vršiti zloupotrebe pošto su kazne nedefinisane pojedinačno. Znači, potrebna su podzakonska akta i apelujemo na funkcionalnu komisiju, kada su u pitanju amandmani, da se dobro pozabave sa ovim zakonom zato što obavezu sa ovim zakonom, imamo naime međunarodne zajednice i uskladištenje sa međunarodnim zakonima i Evropskom unijom, te imaćemo problema ako ovaj zakon ostane ovako samo opisan i nedefinisan u pojedinim segmentima.

Mi ćemo kao grupa da damo svoj doprinos. Toliko od nas kao grupa i podržavamo ovaj zakon. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për të diskutuar është vetëm një diskutues. Deputeti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje ministrave dhe deputetëve!

Unë, parimisht janë kundër armëve, kuptohet që edhe ne të gjithë që përdorimi i tyre nuk duhet të jetë në duart private. Por, unë mendoj edhe një herë kam fol për këtë problem, se përveç institucioneve, se këtu parashihen edhe këto kompanitë që t'i kenë armët dhe si të furnizohen me armë, duhet të bihet një ligj i posaçëm ose të inkuadrohet këtu në ndonjë nen e drejta e individëve për të pasur armën për ta mbrojtur familjen dhe për të pasur sigurinë e familjes më efikase, sepse askush nuk mund ta mbrojë individin, në qoftë se ai vetë nuk ka mundësi të mbrohet. Dihet se në Kosovë ekziston krimi i organizuar, kemi edhe shembuj gati çdo muaj, shumë të shëmtuar, prandaj ka arsye që kosovarët ta kenë një armë në familje të tyre, se atëherë në këtë mënyrë krimi i organizuar sigurisht do të jetë më i kujdesshëm për vetveten sepse, si thotë populli: "Pyka me pykë nxirret" Prandaj, në qoftë se krimineli, i cili është i armatosur dhe e di se familja përkatëse të cilën ai do ta plaçkitë ose të bëjë diçka tjetër, ka një armë gjithashtu, ai me siguri që do ta kalojë atë numër të asaj shtëpie ose të asaj banese. Kështu, propozoj që ose në këtë ligj ose të nxirret ligj i posaçëm për të drejtën e individit për... Në shtetet demokratike të Evropës dhe në Amerikë, unë vet i kam parë dhe vetë më kanë treguar njerëzit, është krejtësisht e thjeshtë procedura për të nxjerrë një armë të shkurtër ose të gatë, tash nuk e di, por një armë e cila është efikase për ta mbrojtur familjen nga terrori ...

Mendoj se nuk duhet të jemi indiferent ndaj kësaj situate. Është e domosdoshme. Ja, për shembull, edhe veriu i Kosovës, vriten njerëzit atje si zogjtë e pulave, sepse e dinë që ana tjetër është e armatosur. Unë jam i bindur që shpi për shpi ka të paktën një kallashnikov, kurse janë të bindur që shqiptarët nuk kanë kurrëgjë në dorë. Ju lutem që ta merrni këtë si një gjë shumë serioze për hir të sigurisë së individit edhe të familjeve në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Rexhepi, e doni fjalën? Zoti Rexhepi e ka fjalën.

BAJRAM REXHEPI : Ju faleminderit, zoti kryesues!

Desha vetëm një shqetësim që e ngriti zoti Demaliaj, të them se furnizimi i FSK-së me armë të llojeve të ndryshme nuk i nënshtrohet këtij ligji. Ata kanë konsultimet me KFOR-in, kështu që ai është një agjencion në vete, që të gjitha tjerat shkojnë nëpërmjet të këtij ligji. Në fund, desha të falënderohem edhe për përkrahje dhe të apeloj që me të vërtetë ky ligj të shkojë sa më shpejt nëpër procedura për arsye se në Raportin e progresit mund të hasim prapë në kritika se kjo lëmi nuk ka qenë e rregulluar me ligj, janë bërë importime nganjëherë në mënyrë të palicencuar. Ka dyshime se janë bërë edhe keqpërdorime, prandaj sa ma shpejt që të rregullohet ky ligj, ndoshta edhe në Raportin e progresit do të kemi një qasje më pozitive sa i përket kësaj lëmie. Ju falënderoj edhe një herë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë, tani duhet të deklarohe mi për votim.

Në sallë janë 71 deputetë, kemi numër të mjaftueshëm për ta votuar ligjin. Tani u bënë 72-73 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani:

Konstatohet se me 68 vota “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Siguri, Punë të Brendshme, si komision funksional,
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që në afatin prej dy muajsh nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të projektligjit.

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovane kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Ja sam već više puta još ranije pričao o ovom zakonu i kroz vaša pitanja koja su bila postavljena. Svi načelno znamo o čemu se radi. Znao da je socijalni dijalog jedan od bitnih procesa evropskih tokova, to je nešto što moramo mi, ne samo kao Vlada, nego kao društvo da pokrenemo, da uzmemo odgovornost za to. Mi jesmo spremni, to smo više puta pokazali, a ja ću u jednom kraćem ekspozou da vam predstavim šta su osnovna načela ovog zakona i što će samim tim zakonom biti postignuto u buduću.

Kao što znamo, socijalni dijalog je proces pregovora, konsultacija, razmena informacija predstavnika Vlade, predstavnika poslodavaca, predstavnika radnika i to se radi u vezi slučajeva zajedničkih interesa, kao što su politika zapošljavanja, ekonomska i socijalna politika.

Socijalna dimenzija je jedan od vrlo bitnih faktora za razvoj svakog evropskog društva, tako da verovatno jedna osnovna stvar koja se može okarakterisati u samo Evropskoj uniji je baš taj njihov socijalni modalitet. Mi smo kroz zakon pokušali da na ovom njihovom uzornom socijalnom modalitetu nađemo i mesto za nas, nađemo i neki put koji, kao što je do sada bio utvrđen i u zemljama Evropske unije, tako i kod nas. Glavna namera je, naravno, postavljanje pravne strukture, da tu strukturu možemo da postavimo na odgovarajući način. Pravna osnova je prva stvar za naše delovanje. I sama važnost zakona može da ukaze na to da će biti zakon koji će odrediti pre svega odgovornosti, prava i obaveze svih učesnika u ovom dijalogu.

Naravno, Socijalni-ekonomski savet će biti nezavisan. Ja sam u prethodnom periodu već bio informisao da sam Savet sadrži 15. predstavnika, odnosno u ovom slučaju 9. različitih partnera. Partneri ispred Vlade su:

- Ministarstvo za rad, kao nosilac samog socijalnog dijaloga,
- Ministarstvo obrazovanja,
- Ministarstvo zdravlja,
- Ministarstvo ekonomije i
- Ministarstvo trgovine i industrije.

Sa strane poslodavaca u ovom momentu, kao što je utvrđeno, imamo predstavnike Privredne komore Kosova, imamo predstavnike Alijanse kosovskih biznisa, imamo predstavnike (BSPK), Ujedinjenje nezavisnih sindikata Kosova i (KSLK) je takođe ispred predstavnika radnika.

Kao što rekoh, ovo će biti od vrlo bitnog interesa za nas, interesa za građane. Moram da napomenem da smo, primer dajem konkretan jedan, da je socijalno KES, da je Socijalno-ekonomski kancel, odnosno savet bio prvi informisan u to vreme kada smo mi zvanično doneli Zakon o radu, kao jedna od njihove baze, ka Draftligji, kao Nacrt zakona. Ja mislim da je dobra prilika da se i pred same neke objave uspeha, već u to vreme može njima dati na razmatranje. Znači, svi partneri koji su zainteresovani, mogu odmah imati u uvidu to i pre nego što dođe do samog onog objavljivanja.

Jedina moguća alternativa kod nas sada je da se osnaži socijalni dijalog između partnera i napravi jaka pravna baza, jer je do sada ova sfera, naglašavam, bila regulisana nekim podzakonskim aktima, znači naglašavam da je ovo možda prvi put da sopstvenim resursima, da bez uticaja određenih faktora možemo da napravimo zakon onakav kako ga vidimo mi i onako kako će naravno biti po svim pravilima i normama Evropske unije. Ovaj zakon je potpuno u saglasnosti sa zakonima Evropske unije i mi smo kao bazu koristili recimo Povelju za osnivanje Evropskog ekonomskog udruženja, tačka 235, imamo zatim Povelju za osnivanje Evropske unije i naravno Evropska povelja za ljudska prava.

Kao što sam već rekao, ovo je Zakon u jednoj legislaciji Ministarstva za rad i socijalno staranje i, naravno, u samom ... će biti partneri koji su najbitniji. Da ... onako o informacijama koje vi sve znate. Od samog početka mog mandata i ove Vlade, jedno od prvih stvari na koje smo delovali, to je bilo početak socijalnog dijaloga. Moram da podsetim da pre toga, ovaj sastav, ovaj savet u to vreme se zvao Tripartitni savet, nije funkcionisao tri i po godine, tako da je samo njegovo pokretanje bi u određenom momentu dala nama neke zadatke koje smo morali da ispunimo, dalo obavezu Vladi, kao što je posle toga bilo i usvojena ona osnovna načela i osnovna pravila kako treba utvrditi ko su ustvari predstavnici bilo poslodavaca, bilo radnika i koja su ta pravila i norme koje oni moraju da ispune, ta sva dokumenta sigurno i kod vas, od usvajanja Vlade do naših tehničkih grupa. Ja moram da naglasim da što se tiče zadnje procene koje smo radili, u kojoj je bila jedna angažovana grupa stručnjaka koja je radila negde od prilike 60 sati rada, da bi se konačno jasno utvrdilo stanje po kriterijumima koje smo dali, ko je ustvari predstavnik i koliko članova svojih možda ima u ovom savetu.

Znam da je bilo raznih kritika, to je verovatno nešto što se i očekuje od predstavnika i sindikata i predstavnika poslodavaca i to je normalan deo dijaloga. Znači, još jednom ponavljam, mi kao Vlada, Ministarstvo, smo apsolutno spremni, imamo strpljenje, to je najbitnije i kao što jedan naš kolega, državni sekretar Ministarstva za rad Nemačke je bio u poseti pre dva dana, i dok smo

razgovarali u tome, ja sam i njemu napomenuo da bi mogli, recimo, koristiti njihova iskustva da i ove naše predstavnike socijalnog dijaloga nekako uputimo da ih oni pozovu nekoliko dana kod njih, da uporede njihova iskustva sa iskustvima socijalnog dijaloga u Nemačkoj, i oni su naravno pristali. Siguran sam da će naši predstavnici KES-a ovde dobiti taj poziv, ali kao što je i sam državni sekretar rekao: „Pa ministre, to je normalno, to se dešava kod nas da uvek ima dužih pregovora, da uvek ima dužih kritika, bilo kritika, bilo nekih drugih predloga. To je sasvim normalno i treba shvatiti kao normalno“.

Još jednom ponavljam, mi jesmo spremni, mi imamo, naša vrata su otvorena za sve predstavnike, za vas, naravno, poštovani poslanici. Ukoliko budete imali sada ili bilo kad neka druga pitanja vezano sa KES, mi smo tu, ali mislim bez ove pravne baze, nećemo moći. Na našu sreću, nema nekih budžetskih implikacija. Mi smo se potrudili da tehničku bazu napravimo, zaposlili smo i odgovarajuće osoblje koji će se starati o svakom sastanku KES-a. Oni će biti na vreme informisani o svemu, tako da ovim finaliziramo pravnu bazu...

(KRYESUESI: Ia vazhdoni edhe 2 minuta!

NENAD RAŠIĆ:.... ja vas molim da imate to na umu da nam ova pravna baza treba kako bi zvanično počeli sa socijalnom dijalogom, a naravno posle toga sve su sugestije dobrodošle. Hvala vam puno!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pas prezantimit, hapi debatin për diskutim në parim lidhur me ligjin. Kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Gospodo ministri, poslanici,

U ime komisije, najpre, komisija je razmatrala ovaj nacrt zakona i bila je u dilemi dali je potrebno da ova materija bude uređena zakonom, zakonskim aktom ili nekim podzakonskim aktom kao što je bilo do sada, ostavljeno je da se parlamentarne grupe o tome izjasne, da svaka da svoje mišljenje dali je potreban ovakav zakon ili je to moglo ostati na nivou podzakonskog akta, odnosno odluke, jer je postojala odluka Vlade da se ova materija reguliše.

U ime Parlamentarne Grupe „7+“ mi ćemo podržati ovaj nacrt zakona s time što smatramo da ćemo u daljem radu i dati svoj doprinos, takođe ćemo u komisiji pokušati da napravimo dogovor, odnosno da pozovemo zainteresovane strane, pre svega one koje štite radnike, jer u ovom trenutku radnici na Kosovu nisu dovoljno zaštićeni, najmanje su zaštićeni oni radnici koji rade na najtežim poslovima i taj Tripartitni dijalog mislim da treba da se vidi koliko će opet biti radnici zaštićeni. Što se tiče Nacrta zakona, on ima puno stvari koje nisu u skladu sa standardnim jezikom, posebno u prevodu na srpski i bosanski. Mislim da je bukvalno prevođeno sa albanskog jezika i nema nikakve logike „posloprimaoc“ taj stav mislim nema, to je možda na albanskom „punemarres“ i „punedhenes“, međutim imamo termin „radnik“ ili „zaposlen“ i tako dalje, ovo „posloprimaoc“ nekako ne ide. Takođe ima još nekoliko, misli se na „odvijanje rada“. Ovamo „odvijanje radova“, radovi su građevinski i tako dalje, ovde se odnosi na rad ili „skadiranje rokova“ i tako dalje, to je „istek roka“ i tako dalje.

U svakom slučaju, mi kao komisija ali i ka parlamentarna grupa daćemo svoj doprinos da ovaj zakon bude kvalitetniji i u načelu ga podržavamo.

KRYESUESI: Ju faleminderti!

Tani janë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare në radhë. Sipas paraqitjes, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje, ministra!

Kolegë dhe kolege,

Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social është një ligj që së bashku me Ligjin e punës janë ligje bazike në përkrahje të punëdhënësve, të punëmarrësve, domethënë të sindikatave dhe të Qeverisë për të njëjtin qëllim, që të përmirësohen marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore në mes të këtyre partnerëve.

Vendet e BE-së kanë përvojë që nga vitet '50 për themelimin e partneritetit dhe dialogut social në mes shtetit, punëdhënësve dhe punëmarrësve. Dialogu nënkupton bashkëbisedim të barabartë dhe vendimmarrje konsensuale në mes të këtyre palëve me qëllim të shprehjes së demokracisë dhe të rendit shoqëror. Është një organ këshillëdhënës dhe shumë i rëndësishëm në vendimmarrje, ndikon në vendimmarrje, pra. Dialogu ekonomiko-social është instrument i funksionalizimit të një sistemi politik. Në Bashkimin Evropian ekziston Komiteti Ekonomiko-Social, që është organ këshillëdhënës, ndërsa në nivelet nacionale të shteteve ekzistojnë këshillat ekonomiko-sociale, që janë çështje kushtetuese dhe definojnë me ligje të veçanta. Një ligj të tillë po e definojmë edhe ne, pra po e nxjerrim edhe ne sot.

E vërtetë që edhe ne në grupin parlamentar patëm dilema se a do të rregullohet ndryshe apo me ligj, por pas konsultimit të legjislacionit evropian dhe rregullimit të kësaj çështjeje në shtetet e regjionit, pamë se në disa nga shtetet e regjionit është rregulluar me ligj dhe e shpjegova më lart si është e rregulluar në Bashkimin Evropian. Madje, në Francë Këshilli Ekonomiko-Social i cili numëron 230 anëtarë, quhet edhe Parlamenti i tretë, domethënë në përbërje të tij ka shumë anëtarë që ndikojnë në këto çështje.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike jep pëlqimin për miratim në shqyrtim të parë të këtij ligji, me disa vërejtje. Vërejtjet kanë të bëjnë në lidhje me buxhetin dhe me grupet përbërëse sepse, nën një, numërohen grupet përbërëse, numërohen ekspertët, grupet e interesit, pra Qeveria, siç tha ministri, përbëhet prej 15 anëtarësh dhe stafit teknik. Ekspertët janë vetëm këshillëdhënës dhe pa të drejtë vote, duhet të thuhet në ligj, dhe ata mund të thirren vetëm sipas kërkesës së përbërjes së këtij grupi prej 15 anëtarësh, nëse kanë nevojë, ndërsa stafi teknik, duhet të thuhet në ligj, se i takon Ministrisë dhe Ministria duhet ta bëjë edhe buxhetin e këtij stafi. Këtu, në lidhje me buxhetin, duhet të intervenojmë me amendamente dhe sigurisht do ta japim kontributin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Nurisha Hula.

NURISHA HULA: Ju faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Ekonomiko-Social dhe në parim e përkrah këtë projektligj. Gjithashtu, unë si anëtare e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në shqyrtim para se të vijë në Kuvend, e kam përkrahur personalisht dhe i paraqes disa arsye pse duhet të miratohet ky ligj sot këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, Projektligji për Këshillin Ekonomiko-Social paraqet një hap përpara për plotësimin e kriterit në Raportin e progresit Evropian. Ky projektligj rregullon,

zhvillon dhe forcon kohezionin social-ekonomik, gjithashtu përcakton kriteret dhe përfaqësimin social.

Unë i paraqes disa arsye. Pra, e para është se me këtë projektligj rregullohen shumë çështje të deklaratës së Mijëvjeçarit, që me 17 tetor 2008, është miratuar në Kuvendin e Kosovës, pra sfidat e përfshirjes sociale nuk mbesin statike në letër. E dyta arsye është se ngritë prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për Integritim Evropian. E treta arsye është se vlerëson politikat sociale dhe bën politikat nxitjes së punësimit. Prandaj, këto janë kritere dhe arsye shumë të fuqishme pse ky projektligj duhet të votohet sot, në parim.

Vlerësimi i ndikimit buxhetor, këtu përgjegjësia është në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila do të absorbojë mjetet brenda kufijve buxhetor, të parapara sipas Kornizës afatmesme 2011-2013, pra gjithsej janë 59.000 euro. Konsideroj se mund të absorbohen këto mjete për një ligj të rëndësishëm për zgjidhjen e çështjeve sociale dhe për zgjidhjen e dialogut social, që ne kemi shumë nevojë në Republikën e Kosovës.

Kjo çështje në vendet e BE-së rregullohet në formë të samitit tripalësh, por nuk do të thotë se është një gjë që nuk duhet të kalojë. Ligji është një ligj shumë specifik dhe i plotëson edhe ligjet tjera, si Ligjin e punës dhe Ligjin e skemës sociale, që do të vijnë në të ardhmen këtu në Parlamentin e Kosovës. Prandaj, unë i paraqita këtu arsyet dhe Grupi ynë Parlamentar e përkrah në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional në përpunimin e mëtejshëm të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Se a është i nevojshëm dialogu social në Kosovë, as që është e diskutueshme për arsye se nevojja për një dialog social është e evidente, sidomos për qëllimin se duhet të riafirmohet roli i pjesëmarrësve ose i akterëve kryesorë socialë dhe ekonomikë të Kosovës në jetën shoqërore, si dhe të ndikojnë në zhvillimet sociale dhe demokratike të Kosovës.

Mirëpo, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës shtron pyetjen për ministrin dhe presim përgjigjen, zoti ministër. Meqenëse kjo sferë deri më sot ka qenë e rregulluar me akte nënligjore, siç e përmendët ju vet, dhe ekziston vendimi i Qeverisë i datës 13.03.2009, në të cilin pothuaj se teksti i atij vendimi është tekst i projektligjit, është sfida, ashtu siç e kuptojmë ne, se nuk është zbatuar. Prandaj, lidhur me sigurinë se do të zbatohet projektligji të cilin e keni sjellë në Kuvend, cilat do të jenë arsyetimet e juaja pse nuk është zbatuar vet vendimi i Qeverisë deri me sot, domethënë po flasim për më shumë se një vit e gjysmë nga marrja e vendimit të Qeverisë. Në qoftë se mendoni se Projektligji e rregullon më mirë se sa vendimet, atëherë së paku duhet të na jepni arsyetime.

Dispozitat ligjore të cilat përcaktohen me këtë projektligj, përfshijnë organizimin, fushëveprimin, punën dhe funksionimin e përgjithshëm të Këshillit Ekonomiko-Social, përcaktimin e detyrave dhe të përgjegjësisë të këtij këshilli, kushtet dhe kriteret për përfaqësimin e partnerëve socialë. Por çka është vetë Këshilli Ekonomiko-Social? Do të thotë, me këtë projektligj, Këshilli Ekonomiko-Social merr karakterin institucional dhe institucionalizon zhvillimin dhe avancimin e dialogut

social. Prandaj, për një institucion të tillë përfaqësimi ka një rëndësi fundamentale. Me projektligj janë paraparë 15 anëtarë, 5 nga Qeveria, 5 nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe 5 nga përfaqësuesit e punëmarrësve.

Ministri i numëroi se cilat ministri janë, udhëheqëse është, natyrisht, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, kjo definohet si një trup autonom, pra, i pavarur, i cili ka një rol këshillëdhënës për Qeverinë dhe Kuvendin për çështje socio-ekonomike dhe nga marrëdhënia e punës. Ka edhe një rol tjetër, mund të merret me iniciativa ligjore për nxjerrjen ose ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore nga sfera e punës, nga politikat ekonomike, ato të punësimit dhe të mbrojtjes sociale.

Po ashtu, janë përcaktuar kriteret për përfaqësimin e anëtarëve në këtë këshill. Ka edhe organet me të cilat funksionon, siç janë komisionet profesionale, grupet negociuese, kurse punën e tij e ndihmon dhe e mundësin Sekretariati KES-it. Financimi bëhet nga tri burimet, nga buxheti i Kosovës, organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve dhe donacionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Përndryshe, në Evropë kjo rregullohet përmes një udhëzimi, përmes themelimit të Këshillit konsultativ trepalësh.

Nevoja për këtë projektligj, në qoftë se qëllimi ka qenë për shkak të situatës së rëndë ekonomike, për shkak të papunësisë së lartë dhe të varfërisë dhe të një mirëqenieje të ngritjes sociale, atëherë projektligji duhet të sigurojë edhe elemente tjera, të cilat do t'i numëroj në vazhdim. Një e mirë e projektligjit të cilën e theksoj, është se siguron transparencën, domethënë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ndryshëm ekonomikë dhe socialë, që eviton rrezikun potencial nga konsultimet dhe marrëveshjet joformale. Sa i përket kostos buxhetore, do të absorbohet brenda buxhetit të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, por mund të llogaritet në kosto shtesë për shkak se parashihen pagesat paushallë për anëtarët Këshillit Ekonomiko-Social, të cilët takohen një herë në dy muaj, domethënë brenda një viti takohen thuaja 6 herë.

Ndërsa, sa u përket vërejtjeve të veçanta, në emër të Grupit Parlamentar po i paraqes në vijim: Votimi duhet të jetë i hapur apo i fshehtë dhe jo votim ndaras. Projektligji ka paraparë votim ndaras. Ky institucion juridik është i panjohur në procedurat e votimit dhe të vendimmarrjes. Duhet të definohet qartë përgjegjësia e anëtarëve të KES-it, ashtu siç janë përcaktuar kriteret. Për zgjedhjen e tyre duhet të përcaktohen edhe kriteret për shkarkimin e tyre, sidomos nga baza deleguese, e cila i dërgon përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punëmarrësve, do të thotë ata duhet të vlerësojnë punën se a kanë kryer përfaqësuesit e tyre punën apo kanë dështuar në kryerjen e përgjegjësisë. Duhet saktë të përcaktohet buxheti për KES dhe pagesa për anëtarë dhe jo pagesa mujore paushallë. Duhet të përcaktohen mënyra e menaxhimit të mjeteve që do t'i ketë KES-i, duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike. Gjithashtu, duhet të përcaktohet saktë, propozojmë si grup parlamentar në formë të përqindjes kontributet e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, sepse kështu siç e keni përcaktuar në projektligj, përmes aktit nënligjor lehet mundësia të caktohet një vlerë absolute ashtu sipas dëshirës ose grupe të veçanta të interesit.

Meqenëse është trup autonom i pavarur dhe ne insistojmë të jetë kështu, atëherë nuk duhet të ketë zgjidhje siç ka ofruar Qeveria që brenda një viti, pra neni 19.2, kryesuesi i KES-it të jetë ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale. Konsiderojmë se kjo do ta vë në varësi KES-in, i cili duhet të jetë trup i pavarur.

Propozojmë si grup parlamentar që komisioni përkatës të mbajë dëgjim publik me palët e interesuara. Me vërejtjet e përmendura, Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Është e vërtetë që të gjitha ligjet që vijnë në Parlamentin e Kosovës kanë nevojë për plotësime dhe ndryshime. Edhe ky projektligji ka nevojë për plotësime. E dimë shumë mirë që ka ekzistuar Këshilli konsultativ trepalësh, i cili nuk ka funksionuar asnjëherë siç duhet dhe ne jemi të vetëdijshëm që në mungesë të krijimit të politikave të Qeverisë sonë, mundohen që vazhdimisht çdo ditë të bëjnë dialog social, po ashtu është krijuar edhe Ligji për dialogun social.

Grupi Parlamentar i AKR-së është dakord që ky projektligji të shkojë në leximin e parë sepse kemi nevojë vërtet për dialog social dhe e dimë që ekziston një kohezion në mes sociale dhe ekonomikes, zhvillimit ekonomik dhe gjendjes sociale në Kosovë, andaj jemi për Ligjin për dialogun social, por me shpresë, zoti ministër, që ky ligj do ta funksionalizonte këtë grup apo këtë këshill. Kemi disa vërejtje të kushtet dhe kriteret e përfaqësimit të ky projektligj, po ashtu edhe tek anëtari apo kryesuesi i këtij këshilli trepalësh apo Këshillit Ekonomiko-Social, i cili nuk duhet të jetë nga institucioni i cili e ka themeluar apo i cili është nisur dhe e ka sponsorizuar ligjin. Meqenëse këtu kemi të bëjmë me organizatat të cilat e përfaqësojnë punëdhënësin, po ashtu edhe punëmarrësit, gjithashtu e kemi edhe Qeverinë, atëherë do të duhej që të gjendet një mes dhe të gjendet një person i cili është i pavarur dhe konsiston në rolin e këtij institucioni dhe të zgjidhet si drejtues i këtij grupi apo i këtij Këshilli Ekonomiko-Social. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova. Më falni, deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Edhe pse kemi paqartësi për Projektligjin për Këshillin Ekonomiko-Social a do të duhej të rregullohej kjo çështje me ligj, duke pasur parasysh që në Bashkësinë Evropiane, Këshilli Ekonomiko-Social themelohet me samit. Mirëpo, duke pasur parasysh nga kërkesat që dalin nga dokumenti - Letra e bardhë, por edhe Raporti i progresit të vitit të kaluar, si dhe duke pasur parasysh që ka vite me radhë që ky këshill nuk po arrin të jetë funksional, andaj bazuar në të gjitha këto të dhëna, ne konsiderojmë se mund të arsyetohet një Projektligj për Këshillin Ekonomiko-Social, me qëllim që më në fund të kemi një këshill funksional.

Rëndësia e këtij Projektligji për Këshillin Ekonomiko-Social ngase rregullon dhe përcakton organizimin e këtij këshilli, fushëveprimin, si dhe përcakton kushtet dhe kriteret për përfaqësimin e partnerëve socialë, që është në funksion të zhvillimit dhe të punësimit, gjithmonë duke pasur parasysh papunësinë e lartë në vendin tonë.

Vërejtjet tona lidhur me këtë projektligj janë: neni 7, të kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES për organizatat e punëmarrësve, qëndron numri i përgjithshëm të anëtarëve që mund të jetë

10% nga numri i tërësishëm i të punësuarve në Republikën e Kosovës. Ne konsiderojmë se duhet të përcaktohet ky numër nga ndërmarrjet e regjistruara në Administratën Tatimore, duke pasur parasysh se Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë përcillet me shumë parregullsi, është vërejtur se nuk paraqitet numri i saktë i ndërmarrjeve të cilat janë të regjistruara, biznese në Kosovë janë edhe ato që kurrë nuk kanë filluar së punuari, ose ato të cilat kanë ndërprerë aktivitetin e tyre.

Në këtë drejtim kemi edhe blic paraqitjen e ndërmarrjeve fantome, të cilat për një kohë të shkurtër po regjistrohen dhe pastaj po zhduken. Kështu, konsiderojmë se Administrata Tatimore do të duhej të mbetet burimi më i saktë për ndërmarrjet e regjistruara të cilat janë funksionale, por njëkohësisht i paguajnë tatime buxhetit të Kosovës.

Në nenin 14, nuk është e qartë se Zyra e Sekretariatit a do të themelohet në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Këtë do të duhej ta sqaroni, zoti ministër. Ne konsiderojmë se sekretari i KES-it është në kuadër të organeve trepalëshe dhe kjo Zyrë duhet të punojë si e pavarur dhe t'i përgjegjet vetëm KES-it.

Gjithashtu, në nenin 17, pika 2, duhet të fshihet fjala “disponon” dhe të zëvendësohet me fjalën: “menaxhon me mjete”, ngase kryesuesi i KES-it nuk disponon me mjetet e KES-it, por ai i menaxhon ato mjete. Në fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë mbështet, në parim, Projektligjin për KES-in, gjithmonë duke pasur parasysh se themelohet një organ shumë i rëndësishëm për politikën e punësimit dhe të mirëqenies sociale në vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ka folur deputeti Sadik Idriz.

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili e ka fjalën

MURSELJ HALILJI: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

Članovi Vlade,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS-a pozdravlja ulazak ovog Nacrta zakona u skupštinsku proceduru obzirom na činjenicu da ova materija nije bila regulisana u formi zakona, već podzakonskim aktima, to su i prethodni govornici veoma iscrpno objasnili. Problem, mehanizam funkcionisanja prethodnog tela nam govori da je ovaj zakon neophodno potreban. Vidimo konstataciju da je ovaj Nacrt zakona usklađen sa zakonodavstvom Evropske unije, što daje posebnu pozitivnu komponentu ovom nacrtu zakona. Evidentno je da je socijalni dijalog neophodno potreban i smatramo da će ovim nacrtom zakona, odnosno sutra već u bližoj budućnosti usvajanjem ovog nacrta zakona da se suspostavi jedna komunikacija između predstavnika poslodavaca, predstavnika zaposlenih i Vlade, što je neophodno potrebna za rešavanje gorućih problema u ovoj materiji.

Takođe smatramo da je veoma dobro regulisano i ostavljena je mogućnost uticaja na donošenje odluka od strane Vlade, znači sve u svemu jedan pozitivan dokumenat i SLS će u načelu podržati ovaj nacrt zakona, međutim pridružićemo se primedbama Parlamentarne grupe „7+“ koje se odnose na greške u verziji na srpskom jeziku, znači postoji dosta rečenica koje su dvosmislene, čak i slovnih grešaka i tako dalje, ali smatram da će to u daljem radu da bude manji problem, da se sve to ispravi. Znači, ponavljam, Parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa ponovo na datu reč!

Pred nama imamo jako važan Zakon o osnivanju Ekonomsko-socijalnog saveta. Mi kao grupa razmatrali smo ovaj nacrt zakona, podržavamo ovaj nacrt zakona i mišljenja smo da ovaj delokrug treba da se rešava putem zakona a ne putem podzakonskih akata. Na osnovu ovog zakona, mogu posle da dođu podzakonska akta, jer smatramo da je zakon malo, malo se bavi, ne konkretizuje socijalni dijalog, ali pošto sam ja kao član Komisije za zdravstvo i socijalna pitanja, potrudicu se tamo maksimalno da dam svoj doprinos kada je u pitanju ovaj zakon i mi kao grupa isto podržavamo zakon, rekla sam, ali imamo neke primedbe koje se odnose kada je u pitanju sam sastav Ekonomsko-socijalnog saveta gde je potrebno da ovaj savet sačinjava 15 članova i gde se kaže da je to po 5 članova iz predstavnika koji se određuju iz organizacije poslodavaca, posao primaoca ili organizacija radnika i Vlade. Mi znamo da ovaj zakon definiše, znači da je trougao odnosa između Vlade, poslodavca i radnika. Znači, sređuje tržište rada i nadležnost Vlade koliko je spremna i sposobna da to tržište prati.

Kao jako važno, hoću da dam do znanja da od ovih pet predstavnika, kada su u pitanju radnici poslodavci ili Vlada, mi kao zajednica koja je, da kažem više nacionalna zajednica, zahtevamo da dva člana obavezno budu iz ostalih zajednica zato što Ekonomsko-socijalni savet uspostaviće dijalog na Kosovu, socijalni dijalog gde će se vršiti analiza od strane saveta, kolektivnih ugovora, grandskih ugovora, ugovora za privatizaciju, ostalih ugovora gde se drastično krše prava radnika na Kosovu i gde želimo da imamo svoje predstavnike kako bi imali informacije is prve ruke.

Kada je u pitanju predsednik Komisije, gde ima mandat ovog saveta, socijalnog saveta, daje se u zakonu da to bude na početku ministar za rad i socijalno pitanje i da to bude mandat od godinu dana. Mi dajemo kao grupa predlog da to uvek bude ministar za socijalno i zdravstveno pitanje, jer znamo da se ministri menjaju i da kada su u pitanju izbori i ostalo i da to neće biti većito jedan čovek, ali je bitno da to Ministarstvo prati ovu oblast. Jedno što je jako važno, kada su u pitanju kriterijumi, kada sam rekla kod ovih zakonodavnih stvari, zato što je jako bitno, zato što će biti organizovana razna udruženja, koja će se učlanjivati, imati obavezu učlanjivanja u međunarodne organizacije, kao što je Međunarodna organizacija radnika, sindikata, poslodavaca i ostalih i gde će svako preduzeće i svaki poslodavac ovde na Kosovu mora biti učlanjen u ovom savetu i gde će morati da plaća, normalno, članarinu i ovaj zakon praktično će izlistati preduzeća koja aktivno sada rade na Kosovu, koja su aktivna, aktere, radnike, jer na ovom tržištu mi nemamo statistiku i mislim da sa ovim zakonom, da ćemo da regulišemo ovu jaku važnu oblast. Meni je mило da je ovaj domaći zadatak dala Evropska unija, da više ne možemo, kada je u pitanju Zakon o zapošljavanju, Zakon o radu i ostalim pitanjima da se ponašamo kako smo se do sada ponašali ovde na Kosovu. Hvala! Mi ćemo dati svoj doprinos, kao grupa podržavamo zakon.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatoh që në emër të grupeve parlamentare janë paraqitur të gjithë të interesuarit për diskutim. Sipas Rregullores, tani e kanë radhën deputetët e paraqitur...

(Reagime nga salla)

... po e kryejmë këtë dhe po shkojmë. Besoj, në qoftë se nuk diskutoni gjatë, kryhet shpejt. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj që ky është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili rregullon raportet edhe institucionale, po edhe obligimet që i kanë institucionet e vendit ndaj politikave sociale, punëtorisë, punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe si grup parlamentar zyrtarisht e dhamë mbështetjen, por dua të theksoj që Këshilli Ekonomiko-Social, pas miratimit të këtij ligji do t'i ketë sfidat përballë dhe fakti që Këshilli konsultativ trepalësh për vite të tëra nuk ka funksionuar, nuk ka qenë aktiv, nuk ka dhënë imputo, ky institucion tani, se qëllimi këtij ligji është që KES-in ta institucionalizojë që të merret me bilancin e trendëve të zhvillimit ekonomik, të hartimit të politikave sociale, të zbatimit të politikave ekonomiko-sociale dhe të veprimtarive tjera ekonomike, që kanë ndikim direkt në zhvillimin ekonomik, në ngritjen e cilësisë së shërbimeve që përfshijnë edhe pjesë tjera të legjislacionit që inkorporohen. Andaj, është një obligim i ministrit të Punës dhe Mirëqenies sociale që vërtet të krijojë kondita normale të funksionimit të këtij institucioni shumë të rëndësishëm që determinon mbase politikat më sensitive për pjesën dërmuese të popullatës së Kosovës, popullatës aktive që tek e fundit kontribuon edhe në organizimin e jetës, por edhe në mbushjen e buxhetit të shtetit. Andaj, hartimi i strategjive, hartimi i politikave racionale konform trendëve socio-ekonomike dhe dialogu në kushtet të pavarura, do thotë, pa imponime, pa ndikimet e politikës, por edhe pa ndikime të sferës dhe interesave që vijnë nga fokus grupet e komunitetit të biznesit dhe pa presione nga ana e punëmarrësve në këtë rast, thjeshtë ky mekanizëm institucional duhet sa më shpejtë të funksionalizohet, të marrë obligimet e veta dhe vërtet të fillojmë me hartimin e strategjive, të politikave që i kontribuojnë edhe mirëqenies sociale, edhe zhvillimit ekonomik. Andaj KES-in e shoh si një traktat marrëveshje e tre partnerëve të barabartë, të cilët vërtet do të duhej në të ardhmen, zoti ministër, që të hartojnë politika kohezive dhe të ndërmarrin veprime konkrete për një balancë, tani duke përfshirë edhe interesat e komunitetit të biznesit, edhe duke ruajtur balancën e trendëve të zhvillimit ekonomiko-social, por edhe të veprimtarive tjera që kanë impakte direkte. Ky institucion nuk duhet të keqpërdoret dhe të bëhen ndikime për blerje të paqes sociale apo edhe për nxitime të ngutshme qoftë nganjëherë edhe kur po hartojmë ligje të pa analizuara mirë për strategjinë e zhvillimit dhe mirëqenies sociale në vend.

Uroj që ky ligj gjatë procedurave të amendimit, vërtet të konkretizohet, të precizohet dhe të funksionalizohet, sepse zbatimi i këtij ligji do të ketë impute shumë pozitive për trendet ekonomike dhe sociale dhe për një fokus grup të madh të shoqërisë kosovare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Parimisht e përkrah këtë projektligj, por vërejtja ime kryesore në lidhje me gjithë debatin që po bëhet, dhe jo vetëm për këtë ligj, për të gjitha ligjet është bërë një praktikë që deputetët kur e marrin fjalën, po e bëjnë përshkrimin e projektligjit të cilin ne e kemi. Unë do të apeloja që të gjithë deputetët, atëherë kur kanë ndonjë propozim, ndonjë vërejtje, ndonjë sugjerim apo ndërhyrje konkrete në lidhje me një projektligj, strategji apo çfarëdo lloj debati që e kemi në Kuvend, t'i japin propozimet e veta, por ne nuk kemi nevojë të na përsëritet, të na përshkruhet e gjithë ajo që shkruhet dhe që figuron brenda një projektligji, qoftë dekorata buxhetore, qoftë pjesa përshkruese, qoftë harmonizimi me *acquis communautaire*, të gjitha janë këto çështje të cilat ne i kemi në ligje, i lexojmë vet dhe nuk kemi nevojë edhe njëherë që në emër të të një fjalimi apo në emër të vlerësimit të KDI-së, të merret fjala dhe të na përshkruhen të gjitha në detale. Apeloj te deputetët të jenë më konstruktiv, të jenë më konkret në sugjerimet dhe vërejtjet të cilat i bëjnë në lidhje me debatet për projektligje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputetja Zylfije Hundozi e ka fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Për dallim prej Mimosës, unë po flas direkt për projektligjin. Shumë projektligje kanë kaluar në leximin e parë në Parlament dhe çdo herë i është kushtuar vëmendje e posaçme deklaratës financiare, përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, por rrallë është analizuar se si një ligj do të ketë ndikim në përmirësimin e jetës së qytetarëve me zbatueshmërinë e tij në praktikë.

Edhe për këtë projektligj duhet të pyetemi se si do të përmirësojë jetën e qytetarëve të Kosovës, apo edhe një herë Qeveria po bie ligje në Parlament sa për të thënë se po biem ligje dhe po kujdesemi për mirëqenien e qytetarëve tanë. Ky është një përfundim i kuptueshëm, nëse analizojmë situatën e mëhershme, kur e dimë që Këshilli Ekonomiko-Social është formuar me vendimin e Qeverisë së 13 marsit 2009 dhe me këtë është shfuqizuar Udhëzimi administrativ 2001/17 për strukturën dhe funksionimin e Këshillit konsultativ trepalësh. Të dy këto struktura nuk kanë qenë kurrë funksionale dhe kjo ka qenë vërejtje në Raportin e progresit. Raporti i progresit nuk ka lypë ligj të ri, por ka lypë të funksionojë njëra prej këtyre.

Ndryshimi i vetëm në mes të Këshillit Ekonomiko-Social dhe Këshillit konsultativ trepalësh qëndron te emri dhe me këtë ndryshim nuk është arritur një dialog social, prandaj edhe me këtë projektligj tentohet të blihet koha nga ana e Qeverisë, me pretekst se zbatimi i kontratës kolektive nuk është bërë pasi që ka munguar infrastruktura ligjore. Këshilli Ekonomiko-Social i cili ka qenë përgjegjës për hartimin e politikave të qëndrueshme të punësimit dhe garantimit të mirëqenies sociale, nuk ka mund të jetë efikas, se nuk mund të ketë mirëqenie sociale pa zhvillim ekonomik, për të cilin edhe dita-ditës nuk ekziston një strategji e mirëfilltë ose së paku një vizion se si do të ndryshohet situata ekonomike për të mirë në vendin tonë.

Edhe me këtë projektligj nuk ka asgjë të re, çka nuk ka qenë e definuar më herët. Ky është përplot me nene që kanë vetëm definicione. Pra, me këtë projektligj përmbushet forma e jo përmbajtja. Edhe pse pas tri vjet qeverisjeje të kësaj Qeverie, Kosova është ende vendi më i varfër dhe me papunësi më të madhe në Evropë, me këtë projektligj kjo situatë nuk do të zgjidhej. Po prapë se prapë, edhe pse i thashë të gjitha këto vërejtje dhe dyshimet e mia për funksionimin e këtij ligji në praktikë edhe më tutje, prapë shpresoj se ndoshta ligji do të jetë ai që do të zbatohet në të ardhmen dhe së paku me të do të mbrohen të drejtat e punëtorëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Sa i përket dialogut social, rëndësisë, mendoj se nuk ka nevojë të flitet. Ndryshe, unë e kam pas një oportunitet, iu kam pas drejtuar edhe Kryesisë së Kuvendit për ta udhëzuar Qeverinë për ta përgatitur këtë dokument, mbase do ta kishte bërë Qeveria këtë edhe pa mua, pa dyshim, por është një dokument me rëndësi. Por, megjithatë si parakusht për realizimin e këtij akti atëherë kur do të miratohej, konsideroj që do të duhej të ishte kontrata kolektive e përgjithshme, niveli shtetëror, se bëhet në tri nivele.

Disa vërejtje parimore në dispozitat konkrete. Te neni 2, janë përcaktuar 3 partnerë, tripartiti, mirë, këto dihen, punëdhënësi, punëmarrësi, Qeveria. Ndërsa, me nenin 7 janë përcaktuar anëtarët,

që të gjithsej e bëjnë totalin 15. Sa i përket totalit, mund të flitet shumë, pak, e tjera. Mirëpo, te neni 17 shtohet pyetja parimore: - a thua a do të duhej tri vota, sepse është fjala për tri subjekte, apo do të duhej numri, shumica relative, absolute apo e kualifikuar ajo që do të kërkohej me këtë dokument.

Gjykoj se do të duhej të koncentroheshim në këtë pikë edhe në çështje parimore, tri vota, se tre subjekt janë apo, si të them, të shkohet me vota, që konsideroj se nuk do të ishte zgjidhje e pranueshme. Me nenin 5, paragrafin e dytë, thuhet ndër të tjera se Këshilli Ekonomiko-Social është organ trepalësh apolitik. Nuk duhet të operojmë me terma të tilla kur janë inegzistente, sepse Qeveria nuk është apolitike. Nuk ishte, nuk është, nuk do jetë dhe nuk është e arsyeshme që të quhet apolitike Qeveria, që është 100% politike dhe duhet të jetë politike. Prandaj, a mund të jetë ky këshill ekonomik - social apolitik? Nuk mund të jetë. Fundi i fundit, secili partner i ka politikën e veta, por synimi që mos të jetë nën influencën e politikave ditore apo të kësaj apo të asaj partie politike.

Te neni 11, vërejtje parimore, ku thuhet se organet e Këshillit Ekonomik- Social janë komisionet, që në rregull mund të jenë, mund të jenë komitete, mund të jenë pleqësitë e tjera e tjera, grupet punese, por nuk mund të jetë edhe sekretariati, sepse edhe me nenin 14 është përcaktuar se është shërbim administrativ profesional. Pra, nuk është edhe nuk mund të jetë organ i KES-it.

Edhe, zotëri kryesues, përfundimisht, pa ndonjë pretendim të them që në Rregulloren e Kuvendit nuk është përcaktuar koha se deri kur mundet deputeti për ta kërkuar fjalën, mund ta kërkojë deri në shterjen e diskutimeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Nuk mund të diskutosh deri në shterjen e diskutimeve. Kur të them unë që është i fundit, i fundit është dhe unë e interpretoj Rregulloren, jo ju. Sipas radhës, është Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë, në fillim do të deklaroj se në parim e mbështes këtë projektligj për shkak të rëndësisë që ka Këshilli Ekonomik - Social. Siç dihet, është standard për inkuadrimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtar, me theks të veçantë në Organizatën Ndërkombëtare të Punës, pra në ILO.

Por, megjithatë, të nderuar kolegë, edhe ky ligj apo projektligj, më falni, çalon në shumë sfera të rregullimit, ashtu siç çalojnë edhe ligjet tjera të rëndësishme, si bie fjala Ligji i punës. Në veçanti, ky projektligj çalon në aspektin e qartësimit të kompetencave. Merreni, shikoni nenin 8 dhe 9, do të shihni se kemi të bëjmë me fjalë, si për shembull: “këshillime”, “udhëzime”, “vlerësime”, “nxitje”, “promovime”, “shqyrtime” e tjera, tjera, por nuk kemi të bëjmë apo nuk hasim në fjalë: “obligime”, nuk hasim në fjalën “detyrime”.

Siç jemi dëshmitarë, shumë institucione të rëndësishme tonat, të cilat në ligj i kanë këto kompetenca, pra konkrete me fjalë, domethënë: “obligime”, “detyrime”, ato në praktikë nuk i implementojnë, domethënë edhe pse de jure i kanë ato kompetenca, de facto nuk i implementojnë, tash paramendoni se çfarë do të rregullojë KES-i, ku as de jure nuk i ka këto kompetenca.

Dialogu social nuk është dekor, por është një obligim që na imponohet nga standardet ndërkombëtare, është obligim edhe duke pasur parasysh situatën në Kosovë. Prandaj, po them, të futem tash një nene, neni 14.5, ku flet për Sekretariatën e KES-it, është përgjegjës për kryerjen e punëve profesionale e tjera e tjera, shtrohet pyetja - cilat punë profesionale, gjithmonë duke pasur parasysh ashtu siç u përmend këtu, nenin 11.2.

Pastaj, ju lutem, merreni, lexojeni, nëse nuk gaboј është neni 10.4, po ua lexoj, thotë: “ Në rastet kur vlerësimet, rekomandimet janë të papranueshme për Ministrinë përkatëse, KES-i mund t’ia paraqesë Qeverisë së Kosovës vlerësimin, rekomandimin lidhur me çështjen në fjalë”. Tash shtrohet pyetja - ministria çka paraqet, Ministria përkatëse. Programin e kujt mban, a të opozitës, non sens është kjo, pa kuptim, është kontradiktore. Unë mendoj se duhet të hiqet fare këtu dhe mos të jetë sa për ta mbushur një projektligj, të duket sa më voluminoz që është modë në Kosovë e të hartuarit e ligjeve.

Por të mos e zgjatur, se shumë sende u thanë këtu, në parim edhe një herë po deklaroheј se e pranoј, e votoј në realitet, më falni, me shpresë se komisionet gjegjëse do t’i kenë parasysh të gjitha vërejtjet që i dhanë deputetët e nderuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Ibrahim Selmanaj e ka fjalën.

IBRAHIM SELMANAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nuk do të zgjatem shumë përpos një mesazhi që do e sjelli nga praktika që është zhvilluar prej datës 13 mars 2009 e deri sot, kur kemi projektligjin para vetes. Pa e analizuar dhe pa hyrë në detaje të projektligjit dhe nevojat e dialogut social, do të përcjell shqetësimet që vijnë nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura, si pjesë e dialogut social në Kosovë dhe si mekanizmi më i fuqishëm, që është me mbi 100.000 anëtarë. Shkresa zyrtare që dërgohet nga ky bashkim i sindikatave reflekton në faktin se dialogu social është i bllokuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, çka do të thotë se Sindikata e Pavarur nuk prezanton ose nuk ka mundësi që të mbrojë interesat e sindikalistëve në Qeverinë e Kosovës.

Ministri sqaroi shumë mirë harmonizimin e Ligjit me standardet e Bashkimit Evropian, por ana praktike në terren, dialogu i cili është dashur të zhvillohet dhe e ardhmja që do të na sjellë pas, ndoshta, aprovimit të këtij projektligji dhe zbatimit në praktikë, do t hapë prapë dilema se a do të përkrahen vërtet sindikalistët, njerëzit që përfaqësojnë interesat e punëtorëve apo do të jetë prapë një lojë politike që do të luhet me atë kartën sa më të lehtë, t’i mbështesë njerëzit, t’i afrojë njerëzit që nuk ta prishin shumë terezinë dhe, nëse kritikohet Qeveria e nderuar për veprimet e mira ose të pamira nga sindikalistët, atëherë ata janë armiq edhe nuk bën të jenë pjesë e dialogut social. Sugjeroј që të jeni shumë të kujdesshëm në këtë zhvillim, se injorohen 140.000 sindikalistë edhe ashtu të papunë dhe e drejta e punëtorit është e mohuar në Kosovë, këtë e dini më së miri, edhe kjo Qeveri tash në shtetin e Kosovës, dhe duke provuar që të jap kontributin tim në vazhdimësi në rritjen e dialogut, unë në parim e mbështes ligjin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Naim Rustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit për fjalë!

Do të jem konkret, sepse pajtohem plotësisht me deputeten në fjalë, edhe pse ajo nuk tha kurrigjë për ligjin, do me thënë ishte jashtë rendit të ditës, por pajtohem që e ngriti si çështje që mos të flasim kot.

Unë do të ndalem te neni 7, ku bëhet fjalë për kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES dhe mendoј që kushtet nuk janë shumë të..., nuk janë kushte, përpos pikës 1.1, ku përcaktohet si kusht

pika 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, janë pak sa pezull. Numri i marrëveshjeve kolektive të lidhur me ndërmarrjet. Më mirë kishte qenë që në ligj të përcaktohet si numër, që të përcaktohet si kusht, se është shumë e lënë pezull. Nuk e dimë sa, cili është numri i saktë i marrëveshjeve, me të cilin të bën anëtar apo ta jap të drejtën që të jesh anëtar i KES-it, apo anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të punëtorëve. Ky manipulim me anëtarësim në organizatat ndërkombëtare është shumë i shprehur në Kosovë, është shumë i shprehur jo vetëm në organizime të tilla konkretisht, në sindikata e tjerë, por prezantohet edhe është i pashëm dhe në shumë drejtime tjera të organizimit të jetës shoqërore e politike të Kosovë. Me fjalë të tjera, gjenden organizata ndërkombëtare të cilat nuk kanë reputacion. Ato trajtohen si organizata ndërkombëtare, apo edhe po e flas veç kështu, në mënyrë banale po e them, botime ndërkombëtare, ndoshta gjenden diku nëpër Bullgari apo diku në shtete ku munden t'i blejnë, por këtu do të duhej të ishte anëtarësimi në organizatat relevante ndërkombëtare të punëtorëve, me fjalë tjera të ketë një hierarki se për të cilat organizata ne referohemi.

Gjithashtu, edhe kushtet për kritere, përfaqësim nga organizatat e punëdhënësve, përpos pikës së parë, të gjitha kushtet tjera janë të lëna pezull. Sa, kishte qenë mirë të jetë sa, të jetë një prag, që nuk do të trajtohen, jo numër, mund të jetë një, zero, nëse e pranojnë si numër, dhe prapë këtu paraqitet anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve. Kisha pasur dëshirë që mjetet, as të punëdhënësve, e as të punëmarrësve, po as të Qeverisë së Kosovës të jepen para kot, ndoshta me vizita jashtë vendit nëpër organizata që nuk qojnë kurrfarë peshe, ato megjithatë mbesin organizata ndërkombëtare. Ne kemi raste të shpeshta në Kosovë, që edhe udhëtimet zyrtare bëhen me ftesa të organizatave shumë jo relevante, ndoshta edhe të njerëzve që janë në pushtet dhe kanë fuqinë e pozitës, kanë fuqinë e pozitës dhe realizojnë vizita, realizojnë anëtarësime në organizata kot, që një qytetar i zakonshëm mund të jetë pjesë e atyre organizatave. Me fjalë të tjera, veç nëse duam të themi, veç ndërkombëtarë, nuk do të thotë që e bien peshën me veti, se edhe organizata ndërkombëtare e kanë një hierarki nga aspekti i peshës së saj.

Edhe gjithashtu në nenin 8, kur flitet për funksionet e KES-it, e kemi pikën 1.1, Këshillimi dhe udhëzimi i institucioneve, kur flasim për funksionet e Këshillit Ekonomik Social, nxitja e konsultimeve në mes palëve, si dhe nënshkrimi i kontratave dhe marrëveshjeve kolektive, mirë kishte qenë që të jetë pak më saktë, që ta shtojmë edhe fjalën “sipas Ligjit të punës” sepse me Ligj të punës, atje në leximin e parë që e kemi kaluar Ligjin e punës, i kemi të përcaktuara rregullat edhe hierarkinë e marrëveshjeve, të ligjeve, të marrëveshjeve kolektive dhe të marrëveshjeve tjera, kështu që të kemi në harmoni dhe që të kemi një harmonizim të legjislacionit në mes vete, në mes ligjeve tona, që ta vendosim edhe një fjalë “sipas Ligjit të punës”.

Gjithashtu, te pagesa më duket pak sa jo shumë e saktë, sepse anëtarët e KES-it paguhën 15% nga paga bruto e ministrave, kurse në nenin tjetër më poshtë e kemi se në rast se nuk merr pjesë 3 herë radhazi, nuk do të bëhet pagesa, do të përjashtohet, por detyrimi për mbledhje është së paku njëherë në 2 muaj, që matematikisht nga aspekti aritmetikor e bënë të mundshme që 6 muaj mos të shkojë dhe aty nuk ka problem, kështu që ndonjë formulë tjetër është dashur të gjendet, që mos të lihet zbrazësi në funksionimin e Këshillit Ekonomik Social, se mundësitë, mundësitë ligjore janë që 6 muaj mos të shkohet dhe nuk ka problem, se këtu më pastaj kur fillon të implementohet ky ligj, problemet dalin në terren, kështu që është më mirë të zgjidhet derisa ne i kemi letrat përpara por, sidoqoftë, komisioni përkatës do t'i marrë këto vërejtje të mia parasysh dhe mund t'i inkorporojë në ligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Sanije Alijaj, nuk është. E fundit, deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Unë vetëm shkurt, se atë që kam menduar ta them, kanë qenë në diskutimet e kolegëve deputetë, ju përshëndes. Vetëm disa fjalë.

Sa për ligj, të gjithë thanë se është shumë i nevojshëm, edhe unë po them se është shumë i nevojshëm, se neve na vyen dialog trepalësh, por baza për punën e këtij Këshilli dhe që të jetë sa më i suksesshëm, është infrastruktura ligjore. Të gjithë thanë, edhe unë mendoj se Ligji për punë është një prej ligjeve më të rëndësishme dhe është në procedurë dhe nuk duhet lënë gjatë aprovimin e tij, edhe ligjet tjera sikur që kemi aprovuar Ligjin për grevat, pastaj kemi ende disa ligje për organizimin sindikal. Deri diku veprimi i këtij këshilli mund të jetë i suksesshëm sa për anën e ligjeve. Por, unë mendoj se do të ketë pak problem te formimi i këshillit me këtë ligj dhe me kriteret të cilat janë paraparë për punëdhënësit dhe punëmarrësit, e jo për palën e tretë, për Qeverinë. Te punëdhënësi janë do kriteret të cilat mund të merren dhe zbatohen sa taksapagues, do kriteret ekonomike, por për punëmarrësin, për sindikatat është kriteri, po më duket pak i ashpër, se aty duhet dëshmuar sindikata se i ka 10% anëtarë të punësuar dhe unë mendoj se duhet të shikojmë se a është e mundur të përfshihet edhe kjo strukturë e cila është..., më së pari ky ligj është për ta, se kemi sindikata të shpërndara dhe do të ketë vështirësi. Kjo është një.

E dyta, për punën e Këshillit, janë tri palë. Ne kemi pasur një herë kontratën kolektive të nënshkruar nga Oda Ekonomike, Qeveria dhe Sindikata para disa vitesh, por në mungesën e ligjeve nuk ka mundur kurrë të zbatohet. Çka është roli i këtij Këshilli? Roli është që t'i zgjidhë më së pari konfliktet nga më të ndryshmet, nga puna apo mirëqenia sociale apo politikat ekonomike. Sa për bazë ligjore, ne do ta bëjmë, por unë kam një dilemë me këto kriteret të cilat janë këtu për të trepalët, pos Qeverisë që nuk ka problem, a mund të dalim me..., janë pak ma të ashpra. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatohet se nuk ka tjera diskutime. Ministri e ka kërkuar fjalën, 2 minuta për një sqarim të vogël.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Samo sam još jednom za kraj hteo da kažem da sam čuo vaša pitanja, stvarno na neka mogu da odgovorim sada, na neka možda ne mogu u ovom momentu, ali sigurno ono što sam uvek rekao, kažem i sada, ako vam treba bilo koje pojašnjenje, ja vas molim samo pošaljite zahtev kod nas, mi ćemo vam dati.

Od jednog pitanja koje se postavilo kao vremenski rok od datuma usvajanja u Vladi, do ovog samog datuma kada danas razgovaramo o zakonu, da je taj rok bio dug, slažem se da jeste, mi smo trebali to ranije uraditi, ali je baš to temeljno prikazivanje pravog stanja zastupljenosti bilo sindikata, bilo poslodavaca, bilo neophodno. Ja sam sa namerom rekao da je zadnja komisija za evoluciju ili za zaključak radila 60 sati da bi utvrdila po pravilima, po kriterijumima ko je ustvari predstavnik, sa kojim brojem svojih članova. Tako da zato postoji zapisnik, procesverbal, koji je potpisan od svih strana učesnika u toj evoluciji. Prema tome, ja mislim da možemo i da dokažemo da način utvrđivanja članova i samog KES-a, i poslodavaca i zaposlenih je bio stvarno na jednom adekvatnom profesionalnom nivou. Naravno, još jednom pozivam da bilo koja pitanja koje budete imali, da slobodno možete da nas pitate. Hvala unapred na svemu!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, në vazhdim do të deklaroj me votim për miratim, në parim, të Projektligjit. Në sallë janë 71 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Me 64 vota “për” 2 abstenime, asnjë “kundër”, konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Këshillin Ekonomiko-Social.

Tani shkojmë në pauzë deri në orën 15:00. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimit e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, debatit mund t’ia fillojmë, kemi numër të deputetëve që mund t’ia fillojmë debatit.

Në radhë kemi pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin për Tregti dhe Industri, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh problemet ekonomike që mund të shkaktohen nga kushtet e përkeqësuar natyrore, nevojën për të pasur një treg stabil sa iu përket produkteve bazë për një..., nevojën për të krijuar një strukturë institucionale e cila do të jetë përgjegjëse për krijimin, sigurimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e rezervave shtetërore të mallrave, si dhe obligimin institucional për të mbrojtur dhe për t’u kujdesur për popullatën në rast të krizave të ndryshme, sot para jush paraqesim për shqyrtim Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave.

Projektligji rregullon një fushë të rëndësishë të posaçme për funksionimin normal të shtetit në rast të krizave të ndryshme që mund të ndikojnë në çrregullimin e tregut me artikuj të domosdoshëm për jetesë.

Më lejoni që në vazhdim të elaboroj fushëveprimin, esencën dhe mënyrën se si do të funksionalizohet kjo fushë përmes këtij projektligji. Projektligji përcakton procedurat për krijimin, sigurimin, financimin, deponimin, ruajtjen, menaxhimin dhe shpërndarjen e rezervave shtetërore të mallrave në Republikën e Kosovës.

Rezervat shtetërore të mallrave krijohen për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, ekonomisë në rast të çrregullimit të tregut, mbrojtjes së vendit në situata të gjendjes të jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake në gjendje lufte, të cilat sjellin dëme të menjëhershme të rënda për jetën, shëndetin e popullatës, gjësë së gjallë, pasurisë, trashëgimisë kulturore, mjedisin, si dhe për dhënien e ndihmave humanitare në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare. Për t’u funksionalizuar dhe për t’i realizuar detyrimet e parapara me këtë projektligj, është paraparë të themelohet Departamenti i Rezervave Shtetërore si institucion për administrimin e rezervave shtetërore, struktura funksionale dhe mënyra e organizimit të të cilit rregullohet me akte nënligjore. Parakusht për operacionalizimin e tij

është hartimi i planit strategjik afatmesëm trevjeçar dhe programit vjetor, të cilat aprovohen nga Qeveria me propozim të MTI-së, pas harmonizimit me ministritë relevante në këtë fushë. Plani strategjik përcakton formën e aktiviteteve që nga krijimi e deri te shfrytëzimi i rezervave shtetërore, si dhe mënyrën e sigurimit të depove për vendosje dhe ruajtjeve të rezervave shtetërore të mallrave. Ndërkaq, plani vjetor i rezervave përmban llojin dhe... të rezervave, burimin e financimit, shpërndarjen territoriale, sasinë minimale të rezervave e tjera. Si plani strategjik, ashtu edhe plani vjetor konsiderohen sekret shtetëror. Rezervat shtetërore të mallrave përbëhen prej prodhimeve themelore bujqësore, prodhimeve të caktuara jo ushqimore industriale, mjeteve monetare, si dhe makinerive dhe pajisjeve tjera për intervenime emergjente.

Projektligji parasheh që rezervat shtetërore të mallrave të krijohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, mallra që vijnë si ndihmë humanitare, donacionet në mallra dhe ndihma financiare dhe mallra të konfiskuara që kalojnë në pronësi të shtetit nga veprat kundërvajtës, administrative dhe kryerja e veprave penale që janë të destinuara për rezerva shtetërore të mallrave.

Projektligji po ashtu përcakton obligimin e personave fizikë dhe juridikë që merren me prodhimin e mallrave që konsiderohen rezerva shtetërore, që në kohë lufte apo rreziku të prodhojnë mallra me qëllim të plotësimit të rezervave shtetërore. Mosveprimi sipas vendimit të Qeverisë konsiderohet vepër penale. Projektligji përcakton se rezervat shtetërore mund të shfrytëzohen në rast të luftës apo rrezikut të drejtpërdrejtë nga lufta, fatkeqësive natyrore të përmasave të mëdha dhe katastrofave tekniko-teknologjike dhe ekologjike, si dhe dhënies së ndihmave emergjente shteteve tjera të goditura.

Në kohë të gjendjes së luftës apo rrezikut të drejtpërdrejtë të integritetit territorial të Republikës së Kosovës, Qeveria suspendon kompetencat e departamentit lidhur me rezervat shtetërore të mallrave, si dhe ia bartë ato Grupit ndërmnistror qeveritar.

Projektligji përcakton që Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes ministrit përgjegjës së paku një herë në vit t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për gjendjen dhe administrimin e rezervave shtetërore të mallrave.

Në fund, më lejoni të theksoj se duke marrë para sysh koston për implementimin e këtij projektligji, me dispozitë të veçantë është përcaktuar që implementimi i tij do të bëhet në përputhje me mundësitë buxhetore të vendit, që është në pajtim edhe me qëndrimet e institucioneve ndërkombëtare financiare në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rezultatet e pritura me miratimin e këtij Projektligji në mbrojtjen e popullatës, të ekonomisë dhe të vendit në situata të jashtëzakonshme, ju rekomandoj që këtë projektligj ta miratoni në këtë seancë të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Radha është e kryetarit të Komisionit. Deputetja Muzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritet për të gjithë të pranishmit dhe për ministrin që prezantoi Projektligjin për rezervat shtetërore.

Në bazë të nenit 52, rregulla 2, të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjikë, Transport, Telekomunikacion, me datën 21.09.2010, e shqyrtoi në parim Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave dhe nxori këtë:

REKOMANDIM

Kuvendi i Kosovës të miratojë, në parim, Projektligjin nr. 03-L-244 për rezervat shtetërore të mallrave.

Arsyetim

Kryesia e Kuvendit të Kosovës, me përfundimin numër 03-P-278 të datës 18.09.2010, ka ngarkuar Komisionin të shqyrtojë Projektligjin për rezerva shtetërore të mallrave dhe t'i paraqesë raport preliminar para shqyrtimit të tij, në parim.

Komisioni, në mbledhjen e tij të rregullt, në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, me datën 22.09, shqyrtoi Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave, të cilin e miratoi në parim dhe njëherësh kërkon që Kuvendi të vendos si në dispozitë të këtij rekomandimi. Arsyetimi eventual i këtij rekomandimi, në mbledhje plenare, paraqitet nga vet Komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ndonjë kryetar i komisionit tjetër nuk e ka kërkuar fjalën. Atëherë, shkojmë sipas... Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Ju faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me koston e këtij Projektligji, na habit një fakt që do ta lexoj komplet në mënyrë të qartë se çka shkruan në letrën që na e kanë dërguar. Sigurimi i mjeteve buxhetore, është fakt thotë edhe konstatim, se kostoja buxhetore e vlerësuar në këtë vlerësim të ndikimit buxhetor për Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave, në asnjë dokument ligjor që ka të bëjë me buxhetin e Kosovës, përkatësisht buxhetin e Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë për vitin 2011-2013, nuk trajtohet dhe nuk parashikohet.

Ne i dimë arsyet pse nuk mund të konstatohet, trajtohet dhe të parashikohet kostoja e implementimit të këtij ligji në të ardhmen, por së paku ne do të duhej të kishim, se kjo bëhet mbi bazë të një strategjie të përcaktuar të krijimit të këtyre rezervave dhe shfrytëzimit të këtyre rezervave së paku përafërsisht, përafërsisht të kemi një vlerë të caktuar, një vlerë minimale të kësaj kostoje, në mënyrë që ajo të përcillet pastaj vit pas viti dhe në rast kur ne do të miratojmë këtë projektligj dhe në rast kur mbi bazë të atij projektligji do të dalë një strategji për krijimin e këtyre rezervave, atëherë mund të përcaktohet saktë edhe kostoja buxhetore e implementimit të këtij ligji. Kështu, si të tillë, ne mund ta miratojmë dhe është e domosdoshme që të miratohet me kushtin që Ministria përkatëse, në afatin sa më të shkurtër, pas miratimit të këtij Projektligji, të dalë me strategjinë që e parasheh edhe vetë ligji, nxjerrjen e strategjisë së krijimit të rezervave shtetërore dhe të kemi edhe pasqyrën e qartë të kostos financiare, sepse ka një kosto, nuk po them marramendëse, por bukur shumë të papërballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit!

A ka tjerë? Nuk ka. Shkojmë, në emër të Partisë Demokratike, deputetja Sala Berisha – Shala.

SALA BËRISHA SHALA: Ju faleminderit, kryetar!

Përsëndetje, Kabinet qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës vlerëson lartë punën e Qeverisë, në këtë rast të Ministrit për Tregti dhe Industri, me rastin e draftimit të Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave. Është një ligj që i mungon infrastrukturës ligjore në Kosovë, rëndësia e tij është e padiskutueshme.

Duke e ditur se rezervat shtetërore të mallrave krijohen për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, ekonomisë në rast të çrregullimeve të tregut, mbrojtjes së vendit në situatat e jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake në gjendje lufte të cilat sjellin dëme të menjëhershme për jetën dhe shëndetin e popullatës, pasuritë, trashëgiminë kulturore e tjera, si dhe rezervat shtetërore të mallrave krijohen edhe për dhënien e ndihmave humanitare në harmoni me normat e së drejtës ndërkombëtare. Të gjitha këto arsye kanë bërë që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ta mbështes, në parim.

Megjithatë, ka disa vërejtje në këtë draft dhe do t'i përmend vetëm dy prej tyre, si më të rëndësishme që i konsiderojmë. Arsyeja financiare, që e përmendi edhe kryetari i Komisionit për Buxhet, që është një arsye shumë e fuqishme që paraqitet edhe në këtë material, por edhe arsyeja e rëndësisë qeverisëse menaxhuese.

Ua përkujtoj se në seancat e mëparshme të këtij sesi vjeshtor janë miratuar, në parim, disa projektligje të sponzoruar, respektivisht të draftuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e që në vlerësimin e ndikimit buxhetor janë cilësuar të pazbatueshme në kuptimin financiar me implikime buxhetore, e që këto mjete për zbatimin e ligjeve në fjalë, nuk janë të pasqyruara në planifikimin e buxhetit të Ministrit për Tregti dhe Industri, e as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Edhe ky projektligj përballlet me implikime të tilla, bile edhe më të larta buxhetore. Kjo është një arsye shumë e fortë për MTI-në, e cila nuk mund t'i përballojë financiarisht të gjitha këtyre draftligjeve që i ka sjellë në Kuvend me këto paqartësi buxhetore.

Prandaj, ne si grup parlamentar e shohim një rrugëdalje të tillë, duke bërë amendamente në Ligjin në fjalë, përkatësisht njëri që e shkarkon nga obligimi financiar Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë është edhe neni me të cilin paraqitet formimi i një departamenti për mallrat, për rezervat e mallrave shtetërore, që ai departament sipas draftit është i paraparë në kuadër të Ministrit për Tregti dhe Industri, ndërsa ne mendojmë se ai departament duhet të jetë në nivel të Qeverisë edhe për arsye tjetër menaxhuese, sepse çështja e rezervave shtetërore të mallrave është e një rëndësie më të lartë shtetërore, meqenëse zbatues i këtij ligji përmes atij departamenti do të jetë direkt Qeveria përmes dikastereve, siç janë: Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Forcës së Sigurisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Shëndetësisë, pothuaj se të gjitha ministrinë, prandaj nuk mund të jetë edhe si kompetencë brenda në kuadër të kësaj ministrie, po të vendoset ai departament në nivel më të lartë. Prandaj, mendojmë se vërejtjet tona do t'i japim në komisionin parlamentar përmes deputetëve tanë gjatë fazës së amendamentimit, pikërisht në nenet 6, 7, pothuajse ndërrimi i kompetencës së këtij departamenti reflekton në të gjitha nenet me radhë në këtë projektligj.

Edhe një herë po them se e mbështesim në parim. Vërejtjet tona, kontributin tonë do ta japim më tutje në fazën e amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratik të Kosovës, deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim Projektligjin, si dhe arsyetimin që e dha Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, bashkë me vlerësimet në vijim lidhur me rëndësinë e veçantë që e ka Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave, qëllimet dhe veprimtarinë të cilën ky Projektligj vendos që ta kodifikojë në strukturën e tij.

Është i punuar mirë dhe Projektligji në krejt strukturën e tij po ashtu adreson saktë institucionet të cilat janë bartës të monitorimit, mbikëqyrjes dhe mbajtjes të rezervave shtetërore të mallrave, qoftë në rrethana normale, që i takon departamentit të ministrisë përkatëse, po ashtu e ka dhënë zgjidhjen tjetër në rrethana të tjera, në situata të tjera të krijuara, pra nuk është më departamenti ai i cili e bartë këtë punë në kuadër të ministrisë, por ai kalon në nivel ndërministror, çka është me vend, ajo zgjidhje është menduar mirë dhe ne mendojmë që kështu të mbetet në projektligj. Po ashtu, në strukturën e tij janë përcaktuar sakatë edhe rrethanat lidhur me mbrojtjen e ekonomisë, situatat e popullsisë dhe, normalisht, të vendit. Kur duhet të ndërhyhet në rastet e caktuara, pra, që sjellin deri te rreziku për jetën, për shëndetin, për pasurinë e tjera e tjera, deri te ajo për florën dhe faunën e vendit, që po ashtu janë përcaktuar në projektligj. Prandaj, ajo çka ka mbetur e hapur dhe që ne po ashtu do të kërkojmë dhe do të marrim pjesë përmes deputetëve tanë deri në leximin e dytë, që ka rëndësi të veçantë është kjo pjesa që u ngrit këtu lidhur me strategjinë e hartimit, pra të atij projekti të kostos së këtij projektligji, i cili duhet të fillojë të implementohet edhe në vitin 2011.

Pse bie fjala të aprovohet ligji tani dhe të thuhet se ai duhet të hyjë në fuqi në vitin 2014. Është pak, po mendoj, e paharmonizuar, sepse nevojat e vendit mund të paraqiten ndoshta edhe në vitin 2011 për situata të caktuara. Dhëntë Zoti të mos të jetë, të mos ndodhin por, sido që të jetë, ne për atë po e aprovojmë ligjin. Prandaj, mendojmë që kjo duhet të përmirësohet dhe të shihet nga ana e Ministrisë, të propozojë edhe Projekt - buxhetin e këtij viti, pra një plan dhe të jetë një kërkesë e cila shtrohet në përmbushje dhe aprovim në seancën e Parlamentit, që edhe për vitin në vijim të kemi mundësinë e implementimit të këtij projektligji. Besoj se përgatitje tjera, sa i përket ministrisë, nuk janë ndonjë telashe e madhe, qoftë në ngritjen e departamentit, në strukturën tjetër menaxhuese e kështu me radhë. Prandaj, mendojmë që këto mund të bëhen tash në ndërkohë në leximin e dytë. E përkrahim në parim dhe do të procedojmë në aktivitetet tjera që i takojnë komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se me këtë ligj fillon të mbulohet rregullimi i një sfere për të cilën Qeveria e Kosovës deri me sot nuk e ka pasur dhe për të cilën ka pasur nevojë që të ketë akt ligjor që e rregullon këtë lëmi, sepse në të kaluarën kemi pasur raste kur ka pasur nevojë që vendi ynë të ketë rezerva shtetërore të mallrave, por për shkaqe objektive nuk i kemi pasur.

Edhe pse Ligji për kah natyra e vet nuk e përmbyll krejt lëmin dhe lë shumë pjesë të papërfunduara, konsiderojmë që vetë natyra e materies ka imponuar që ligji mos të jetë i përmbyllur. Për shembull, ne nuk e dimë se cilat mallra do të konsiderohen mallra të nevojshme për rezerva shtetërore dhe nuk e dimë sasinë e tyre, por kjo besoj që do të bëhet në hapat tjerë të mëtejshëm, të cilët do të kushtëzohen nga disa faktorë, por që konsideroj që më të rëndësishmit janë: nevoja e vlerësuar për raste të jashtëzakonshme dhe mundësitë financiare për të përmbushur këto nevoja. Andaj, si pasojë e kësaj del edhe mungesa tjetër e ligjit, që nuk është faji i Ministrisë, ajo që është kusht për çdo ligj, vlerësimi i kostos buxhetore për implementimin e ligjit. Pra, pa e ditur këta indikatorë që i përmenda, është e pamundur që të përcaktohet edhe kostoja buxhetore.

Prandaj, kur të bëhen hapat tjerë në rrumbullakimin e kësaj materie, me siguri që do të gjendet edhe kostoja dhe atëherë duhet të gjejmë një mesatare të arsyeshme të mundësive për mbulesë dhe nevojave dhe atëherë do të kemi edhe përgjigjen në dilema që na po i shtrojmë. Sido që të jetë, Grupi ynë Parlamentar e mbështet në parim, për fazën që jemi në diskutim do të japim kontributin tonë dhe më tutje, me siguri koha do t'i zgjedhë edhe problemet tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për dy ministrat që janë prezentë!

Duke marrë parasysh se Grupi parlamentar i AKR-së ka shqyrtuar Projektligjin për rezerva shtatore të mallrave, duke marrë parasysh se ky ligj është kthyer edhe një herë nga kjo seancë plenare, e dimë kërkesën e Komisionit Evropian për Raportin e progresit, i cili kërkon miratimin e Ligjit për rezervat shtetërore të mallrave, mund të them shumë sinqerisht se Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në parim Projektligjin, me të cilin rregullohet infrastruktura ligjore dhe caktohet mundësia për raste emergjente dhe për çdo rast të cilën, dhëntë Zoti që Kosova të mos e përjetojë, se edhe ashtu është me mungesë mjaft të madhe buxhetore. E gjithë esenca e këtij ligji, shihet si janë renditur nenet dhe mund t'i them ministrit se shumë pak ndërron prej ligjit të kaluar, jo me dëshirën tonë ndoshta që është kthyer edhe atëherë, por me dëshirën e kësaj kostoje që deri pas vitit 2013, duke marrë parasysh Kornizën afatmesme të shpenzimeve në bazë të planit strategjik, në nenin 8 të cilin e ke, ministër, në këtë projektligj, është shumë e vështirë që t'i mund të arrish ta zbatosh këtë projektligj, pavarësisht cili ministër do të jetë atëherë në pushtet.

Duke marrë parasysh gjithë deficitin buxhetor nga viti 2010 deri në vitin 2013, ne do të kemi një ligj të cilin do ta amendamentojmë dhe do ta çojmë në lexim të dytë, mirëpo esenca e zbatueshmërisë së tij do të jetë shumë e vogël, kur dihet se nuk ka buxhet që të mbulohet zbatueshmëria e këtij ligji.

Në parim, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah dhe të gjitha mundësitë që do të jenë për amendamentimin sa më të mirë të këtij ligji, do t'i japim në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni që në fillim të shpreh konsideratën e LDD-së për ardhjen e këtij ligji në Parlamentin e Republikës së Kosovës, sepse me këtë ligj në njëfarë forme rumbullakohen edhe vakuumet juridike dhe ligjore që një shteti ia japin në kuptimin e plotë të fjalës kuptimin e të qenit shtet.

Rezervat shtetërore të mallrave krijohen për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë në rast të çrregullimit të tregut, të mbrojtjes së vendit dhe në situata të caktuara, që në njëfarë forme ndikojnë në stabilitetin e vendit dhe në jetën dhe shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ky është një ligj i hartuar mirë në përmbajtje dhe në strukturë dhe adreson dhe precizon në mënyrë shumë të qartë detyrat, obligimet e institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës kur është e nevojshme që të ndërmerren hapat e tillë.

Edhe Departamenti i Rezervave të Shtetit është një mekanizëm i cili, edhe pse në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, thjeshtë e luan rolin e vet të një institucioni kompetent, i janë përcaktuar edhe detyrat, edhe përgjegjësitë, edhe obligimet, por edhe kostoja financiare. Tani, te kostoja financiare, te vlerësimi i ndikimit buxhetor, sigurisht që është një ligj që në vete ngërthen edhe implikime të një sasive të konsiderueshme buxhetore, të mjeteve buxhetore, por është momenti inicial, është fillimi kur Parlamenti i Republikës së Kosovës dhe institucionet e shtetit po e marrin hapin e parë drejt rregullimit të kësaj fushe me ligj. Pastaj, janë projeksionet e veçanta, zoti ministër, duhet në strategjitë afatshkurtra dhe afatmesme në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, si dokumente valide që kalojnë dhe e marrin miratimin formal po nga ky Parlament, të krijojnë projeksione buxhetore të caktuara. Në raste të caktuara edhe nuk ka nevojë të emërohen me specifike, por të destinohen për rezervat e shtetit, domethënë për rezervat shtetërore të mallrave strategjike dhe pasi që ta hartoni planin strategjik dhe programin vjetor, të inkorporohen në dokumentet valide, që do ta marrin gjithashtu miratimin e këtij Parlamenti.

Më lejoni që në emër të Grupi Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë të shpreh mbështetjen e plotë për këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në procedurat e mëtutjeshme parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” nuk është paraqitur askush.

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili e ka kërkuar fjalën.

MURSEL HALJILJI: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvaženi ministre,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna Grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona i smatra da je neophodno potreban i istovremeno pozdravljamo ulazak u skuštinsku proceduru ovog nacrta zakona. Vi znate da momentalno ne postoji neki zakon koji reguliše ovo polje, samim tim je ovo značajnije. Svedoci smo da su moguće česte vanredne situacije i okolnosti koje mogu da prouzrokuju poremećaj na tržište i iz tog razloga smatramo da će donošenje ovog zakona biti korisno za sve.

Mi opet upućujemo neke primedbe što se tiče samog teksta i grešaka koje su evidentne. Međutim, smatram da će stručna služba da obrati više pažnje i u ovom prilikom je ohrabrujemo da to uradi. Međutim, u članu 8. imamo konkretno jedan prigovor ili jedno pitanje. Nejasnoća se odnosi na član 8.tačka 1.4. nije nam poznato bar u našoj grupi šta znači reč „znavljanje“. Možda smo pokušali da prevedemo to „obnavljanje“, „osveženje“ i tako dalje, ali već postoji reč „obnavljanje“ pa s toga

smatramo da bi trebalo da se pojasni značanje ove reči. Ponavljam, mi smo zadovoljni u principu ovim tekstom i mi ćemo ga u načelu podržati. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka kërkuar Vladimir Todorović.

VLLADIMIR TODOROVIC: Hvala, predsedniče!

S obzirom da sam poslednji od diskutanata, a prethodni diskutanti su u Skupštini rekli sve nedostatke u ovom zakonu, tako da preostaje samo da pozdravimo ovaj zakon i da u načelu podržimo ovaj zakon. Hvala, puno!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kemi 6 deputetë që kanë kërkuar fjalën. Por, pasi nuk ka transmetim, mendoj që ju mjaftoheni me 5 minuta. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar! Veç Ganiu është lëshuar në këtë lajthim, e ka marrë fjalën për transmetim, e nuk e ka ditur që nuk ka, se po shkruan.

Unë, së pari konsideroj që edhe Qeveria, edhe Kuvendi po e bëjnë një punë jashtëzakonisht të mirë sot, kur me këtë ligj po e rregullojnë një çështje që jep edhe atributin e shtetit, siç e tha edhe një kolegë paraprakisht. Janë tri çështje për të cilat unë konsideroj që ministri duhet të na japë një mendim në fund, që komisionet parlamentare ta kenë të qatë se si të veprojnë.

Te neni 15, kur flitet që në kohën e jashtëzakonshme, në kohën e luftërave, do të suspendohen kompetencat e drejtorit të Departamentit dhe këto kompetenca do t'i marrë një këshill ndërministror, më intereson si është e mundur që në atë këshill ndërministror të mos parashihet drejtori i departamentit, i cili do të ishte përgjegjës gjatë gjithë kohës për vite të tëra, kurse në Këshillin ndërministror të mos jetë anëtar i këtij këshilli dhe ta marrin në dorë komplet Këshilli ndërministror, është në rregull, por të mos e kenë njeriun më kompetent në kuadër të këtij këshilli. Është çështje e cila është në përmbajtje dhe duhet ta mendojmë, sepse në të ardhmen na sjellë dilemë. Një çështje tjetër për të cilën kemi folur edhe më herët, thuhet se kompetencat drejtorit, neni 18.6, thotë: “drejtori zgjedhjet në bazë të Ligjit të shërbimit civil” dhe kjo është krejt në rregull, mirëpo te përshkrimi i kompetencave të drejtorit e keni shkruar, së paku ashtu, mos ta lexoj, thotë: “drejtori do të udhëheq me Departamentin vetëm me autorizim të ministrit”. Autorizimin drejtorit të Departamentit ia jap ligji dhe asnjë ministër. Përndryshe, atëherë nuk do të kishte logjikë, për çdo ditë drejtori i Departamentit duhet të jetë në zyrë të ministrit, ma jep një autorizim për ta përfaqësuar Departamentin atje, këtu dhe do të sjellë një situatë që në praktikë nuk do të zbatohej.

Dhe, krejt në fund, e kemi një problem të cilin e kemi përsëritur disa herë dhe është mirë ndoshta me Qeverinë ta diskutojmë apo së paku ju në Qeveri ta diskutoni. Kuvendi i Kosovës vetëm në këtë mandat ka aprovuar diku 170 ligje dhe nëse në të gjitha këto ligje përcaktojmë vepra penale, kundërvajtje, nuk e di cili sistem i drejtësisë kishte për t'i zbatuar. Po e lexoj vetëm nenin 28, thotë: “mosveprimi sipas vendimit të përcaktuar nga Qeveria, sipas nenit 16 të këtij Ligji”, që ka të bëjë, domethënë mos të shiten ato rezerva dhe mos të prodhohet në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme, thotë “është vepër penale dhe personi juridik apo përgjegjësi për te dënohet me një vit burg ose 5 vjet”. Mandej, edhe neni 29 pak për veprat tjera një vit deri në 3 vjet. Sipas kësaj logjike qysh jemi duke shkruar, duhet të themelohen edhe nja 50 gjykata dhe mos të merren ata me kodin penal, por të merren krejt ligjet ku kemi paraparë vepra penale dhe mandej mos të

thirremi fare në Kodin penal. Ne nuk po e kuptojmë që ligjet mund të parashohin gjobat, dënime, mund të parashohin delikte ekonomike qysh e kemi paraparë. Çështja kur të ngritet në institucionet e drejtësisë, i kanë ligjet bazike ato, e kanë Kodin penal, e kualifikojnë veprën penale që është bërë e më pastaj e kanë edhe në procedurë penale atje se sa duhet dhënë dënimi dhe cili është dënimi maksimal dhe cili minimal.

Paramendoje, nëse dikush gjatë kohës kur preket integriteti territorial i Kosovës, i shet këto mallra, i lë njerëzit pa bukë dhe dënohet një vit burg, nuk ka mundësi, kjo është vepra më e rëndë e cila mund t'i bëhet një shteti, apo sabotazha më e madhe e cila mund t'i bëhet një shteti. Prandaj, nuk duhet shkuar me kualifikim një vit, dy vjet, e tre vjet, sepse mund të jetë vepra më e rëndë e cila mund të parashihet atje tash në Kod penal. Unë nuk po flas përmendësh, por ndër veprat më të rënda si sabotim i luftës apo krijimi i situatës që ndoshta të preket integriteti territorial. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Nerxhivane Dauti e ka fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër prezent,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju përsërisht të gjithëve!

Ligji për rezervat shtetërore të mallrave, i propozuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, rregullon një materie të rëndësishme, siç është ajo e rezervave shtetërore të mallit, e cila gjër më tani nuk është rregulluar me Ligj të veçantë.

Rregullimi ligjor i rezervave shtetërore në Republikën e Kosovës eviton zbrazësitat ligjore që kanë ekzistuar gjër më tani në vend lidhur me këtë çështje dhe ky ligj rregullon dhe përcakton në mënyrë precize procedurat e krijimit, financimit të rezervave shtetërore të mallit. Ligji i propozuar mbulon çështjet kapitale që kanë të bëjnë me:

1. Deponimin,
2. Përdorimin,
3. Menaxhimin, dhe
4. Shpërndarjen e rezervave shtetërore të mallrave në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Rezervat shtetërore të mallrave krijohen për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë në raste të çrregullimit të tregut, në situata të jashtëzakonshme të cilat shkaktojnë dëme të rënda për jetën dhe shëndetin e qytetarëve të Republikës.

Duke marrë parasysh faktin se rezervat shtetërore të mallrave janë me interes të veçantë për shtetin, Ligji përcakton se rezervat e tilla sigurohen në bazë të planit strategjik, afatmesëm tre vjeçar dhe programit vjetor, që aprovohen nga Qeveria e Kosovës.

Unë mund të theksoj se marrë në përgjithësi, Ligji për rezervat shtetërore të mallrave është hartuar mirë, përmban një gjuhë juridike të përsosur dhe mund të konstatoj se gjatë analizimit të të gjitha ligjeve të sferës ekonomike gjatë këtij viti, mund të konstatoj se ligjet janë punuar mirë, kanë një teknikë të lartë juridike dhe mendoj se është realizuar një pjesë e madhe e legjislacionit që rregullon sferën e ekonomisë në përgjithësi. Edhe ky ligj, të cilin po e shqyrtojmë sot, e bën kompletimin edhe më të mirë të kësaj sfere.

Megjithatë, konsideroj se edhe në ligjet tjera është përmbajtur një fushë e gjerë e dispozitave ndëshkuese, jo vetëm e gjobave, por edhe sanksioneve tjera penale, më konkretisht të dënimeve që kanë të bëjnë me shkelësit apo me ata persona, qoftë fizikë apo juridikë të cilët bëjnë jo vetëm kundërvajtje, por edhe vepra penale.

Është mirë që bëhet ky sanksionim dhe unë jam për këtë sanksionim, megjithatë e kemi Kodin penal, i cili është miratuar në këtë Kuvend dhe nuk guxojmë ne t'i duplikojmë rregullat juridike të po të njëjtës materie. Prandaj, zoti ministër, këtë vërejtje parimore, më të rëndësishmen duhet ta përcillni që ligjet tjera të mos na vijnë në këtë mënyrë.

Çështja tjetër është se ligji të cilin jemi duke e shqyrtuar është në tërësi i harmonizuar me ligjet tjera që janë miratuar në Kuvend dhe, po ashtu, janë krahasuar me shtetet tjera që e kanë nxjerrë Ligjin për rezervat shtetërore të mallrave. Kjo krijon një garanci të madhe për shtetin tonë dhe unë pajtohem me vërejtjen të cilën e bëri zoti deputet Rexhepi, që theksoi se ligji duhet zbatuar jo në vitin 2014, por në vitin 2011, sepse krijon një garancion të madh, sepse çdo shtet duhet ta ketë rezervën e vet që po të ndodhë ndonjë ngjarje e jashtëzakonshme, të jetë i përgatitur dhe mendoj se edhe në këtë çështje duhet të ketë kujdes Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë.

Vërejtja tjetër konkrete, të cilën do ta paraqes, normalisht, lidhur me dispozitat ndëshkuese, ka të bëjë me nenin 28, 29 dhe 30, të cilat nene rregullojnë çështjet e gjobave.

Deliktet ekonomike e përcjellin çdo sferë të ekonomisë. Personat juridikë dhe fizikë që merren me qarkullimin mallrave, dhënien e shërbimeve, natyrisht që shkaktojnë edhe delikte të cilat mund të jenë të shpeshta gjatë këtij qarkullimi të përmendur. Megjithatë, ligji të cilin jemi duke e shqyrtuar, duhet ta përmbajë dhe ta rregullojë çështjen e gjobave, normalisht, mirëpo këto gjoba të cilat përcaktohen në nenin 28, nuk janë të njëjta sikurse për personin fizik, ashtu edhe për personin juridik sepse këtu bëhet një analogji. Analogjia nuk është e nevojshme në rastin konkret, sepse duhet marrë specifikat e nevojshme që ekzistojnë për persona fizikë dhe për personat juridikë. Një gjë të tillë nuk e ka bërë ligji në fjalë.

Dhe, sa i përket dispozitave ndëshkuese, duhet bërë harmonizimi dhe duhet përjashtuar ato dispozita që kanë të bëjnë konkretisht me nenin 29 dhe 30 dhe kjo duhet të jetë një vërejtje që do të merret parasysh edhe në ligjet tjera po që se janë në përgatitje nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri kryetar,
Do të isha angazhuar, për rëndësinë nuk po flasim se me të vërtetë ky dokument është i nevojshëm, bile unë e kam pasur kënaqësinë, me kohë e kam pas dhënë një mocion për këtë dokument që të përgatitet, është bërë punë shumë e mirë, mirëpo do të isha përqendruar në një çështje të cilën zotëri Hyseni e theksoi me vend. Nuk është praktikë e mirë legjislative që veprat penale të përcaktohen me akte ligjore tjera pos me Kodin penal. Eh tash, Ministria, MTI, bie fjala, apo cila do e ka mundësinë, e ka infrastrukturën, e ka idenë, këtë tematikë në qoftë se vlerëson s nuk është sanksionuar sa dhe si duhet, ta iniciojë për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit penal, e do të ishte punë shumë më e mirë se sa me këtë, sepse nuk është praktikë e mirë, nuk aplikohet kjo formë në shtetet moderne. Do të isha angazhuar, ju lutem, te neni, konkretisht kështu, te neni jo 10, ka tjera, por unë shkurtimisht, 10 që të përcaktohen detalisht edhe raportet reciproke të ndërsjella edhe

obligimet, përgjegjësitë e ministrive dhe do të ishte zgjidhje shumë e mirë që titullare e të gjitha këtyre aktivitete, si me krijimin, sortimin, ruajtjen e tjera, e tjera, ndërrimin, freskimin e rezervave shtetërore të ishte Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe të përcaktoheshin me nenin 28, masa, ju lutem, masa ndëshkimore për ato ministri që nga sfera e tyre nuk do t'i kishin përmbushur obligimet që do të klishin rezultuar nga ky ligj, se pa atë, besoni, deshëm apo nuk dashëm, mund të dështojnë shumë aktivitete shumë të rëndësishme, e një shtet që nuk ka rezerva shtetërore, me të vërtetë ka një deficiencë tepër serioze. Prandaj, do të isha angazhuar që kjo çështje në parim, apo jo, edhe të sanksionohet. Po e zëmë, Ministria e Shëndetësisë, duhet të bëjë këtë, këtë, këtë, nuk e kryen, apo të ketë dispozitën ndëshkimore, se pa atë, nuk ka edhe ligj. Ai mbetet në nivelin e një dokumenti moralistik që duhet, duhet, mirë është e tjera e tjera. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Harrova të them se përveç mungesës së transmetimit, edhe KDI sot nuk është kësajde. Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit për fjalën e dhënë!

Unë, fillimisht vetëm te përkufizimet, shumë vërejtje e shkurtër, shpeshherë përkufizohet ministri e herë ministria, por nëse përkufizohet cila ministri, atëherë ministri është e vetëkuptueshme që është ministri i asaj ministrie, domethënë në kontest. Vërejtja ime e dytë është lidhur me nenin 25, ku Departamenti nuk merr në posedim mallra me afat të skaduar ose përafërsisht që janë para skadimit. Do të duhej të ishte më mirë e precizuar në ligj dhe të thuhet “sipas planit strategjik”, sepse disa mallra, skadenca e mallrave nuk është e njëtrajtshme nëpër të gjitha mallrat, por koha është variable, varësisht prej mallrave, disa mund të qëndrojnë më shumë, disa më pak e kjo harmonizohet ndoshta në Planin strategjik për ndërhyrje emergjente.

Sido që të jetë, për të mos folur për rëndësinë e ligjit, do të komentoj vetëm te pozicionet lidhur me shitjen, blerjen dhe huazimin e rezervave shtetërore të mallit. Ministri është mirë të na tregojë me cilin ligj është e rregulluar shitja, sepse shitja domosdoshmërisht, shoqëria e Kosovës edhe në këtu ballafaqohemi me një situatë ku ka vakum ligjor, me të cilin ligj bëhet shitja e këtyre mallrave, sepse ose duhet të kemi ligj për ankand, ose të mendohet që të vendoset një ligj për ankand, ose të mendohet që të vendoset një ligj për shitje, sepse Ligji i prokurimit... mund të merren, të përdoren dosjet nga Ligji i prokurimit apo nga KRPP-ja, por nuk është sferë që është rregulluar me Ligjin e prokurimit. Kështu që, edhe ato që shiten momentalisht, ndoshta nuk kishte qenë adapt me Ligjin për shitjen e mallrave, sepse këtu ndoshta mund të jemi në situatë kur kemi të bëjmë me shitje të sasive shumë më të mëdha, e tjera. Të mendohet të bëhet një ligj, mund të na jep përgjigje ministri.

KRYETARI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit, deputeti Driton Tali, e ka fjalën!

DRITON TALI: Faleminderit, shumë!

Të them të drejtën, tash s'më mbeti edhe shumë çka të them, se kolegët e nderuar i thanë. Ndonëse, të them të drejtën, pak edhe u çudita nga deputetja e nderuar zonja Mimoza Ahmetaj, që nuk reagoi sepse ajo na qortoi pak më herët që mos t'i lexojmë aspektet e përgjithshme nga projektligji, e këtu na u lexuan. Po, si do qoftë, po them, ky ligj ashtu me plotë të drejtë i dhanë vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve të nderuar, unë po habitem pse nuk na e kanë sjellë një listë të mallrave, listë apo edhe të shërbimeve strategjike, dhe në mungesë të kësaj liste, ne më shumë merremi me një ligj apo projektligj që i përngjan më shumë tekstit shkollor, ku ka definicione të ndryshme, rregullon procedura por konkretisht çka – nuk mund të themi.

Po them, ne nuk e dimë sa kushtojnë apo sa do të kushtonte ajo listë e produkteve apo e shërbimeve, pastaj kush do tregtonte në rastet e përtëritjes, apo freskimit, apo plotësimit, apo ruajtjes dhe

mirëmbajtjes, sidomos kur kemi të bëjmë me listën e mallrave strategjike ushtarake, por ngjashëm edhe me listën e mallrave tjera. Pastaj, të them të drejtën, unë edhe po e ndiej si një most ë them – ofendim, po po them si një nënçmim të këtij parlamenti pse nuk na është sjell kjo listë, duke marrë parasysh se këtu në parlament kemi kuadro të kualifikuara, kemi ekspertë të profileve të ndryshme të cilët madje edhe kishim mund t'i ndihmojmë listës, ta shtojmë po ta tkurrim, gjithmonë duke pasur parasysh mundësitë tona që i kemi dhe situatën në Kosovë.

Në mungesë, po them edhe një herë, të këtyre listave apo disi ka mbetur si gjysmë ligj apo ligj pa esencë, votojmë, në parim të gjithë u deklaruan se do ta votojmë në njëfarë procedure, se si bëhen apo çka do të bëjmë, nuk e dimë. Ju faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

MYRVETE PANTINA: Përsëritës ardhjen e këtij projektligji për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës, pasi që krijimi i rezervave shtetërore të mallrave është me interes të veçantë për qytetarët e Kosovës. Rezervat shtetërore përbëhen prej prodhimeve themelore bujqësore, prodhimeve të caktuara jo ushqimore, mjeteve monetare, makinerisë si dhe pajisjeve tjera, me të cilat intervenohet në situatë emergjente, për të mbrojtur interesat e qytetarëve dhe shtetërore. Me miratimin e këtij projektligji do të krijohen kushtet, në kuadër të sistemit juridik të vendit, për furnizim të rregullt të qytetarëve në rastin e situatave emergjente dhe të jashtëzakonshme, çrregullimeve në treg etj. Kemi të bëjmë me një projektligj i cili do të ketë implikime të mëdha buxhetore, dhe, ato implikime do të jenë të vazhdueshme, për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale. Mirëpo, dobësia e këtij projektligji është se nuk përmban vlerësimin për koston buxhetore të rezervave shtetërore të mallrave. Madje, kjo kosto buxhetore nuk parashihet me asnjë dokument ligjor të buxhetit, nuk parashihet as me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013, e as me Qarkoren Buxhetore për vitin 2011. Në mungesë të mjeteve financiare vjen në dyshim implementimi i këtij projektligji. Andaj, Qeveria duhet më parë të sigurojë burimin e financimit të këtij Ligji nëse dëshiron që ai të jetë i implementueshëm. Përndryshe, ky kriter duhet të vlejë për të gjitha ligjet, në të kundërtën ato do të jenë të dënuara të dështojnë, apo të mbesin ligje vetëm në letër.

Përveç vërejtjes se cekur me lartë, unë kam vërejtje edhe në nenin 31 të këtij Projektligji, paragrafi 1, ku thuhet se: "Me gjore në shumë prej 5,000 € deri 10,000€ do të dënohet agjenti ekonomik apo subjekti tjetër juridik, i cili nuk mban evidence për mallrat e dhëna në ruajtje dhe deponim dhe atë evidence nuk ja jep në shikim në shikim drejtorit të Departamentit apo personit të autorizuar nga ai", mendoj se në këtë nen duhet të precizohet me një paragraf kush është personi i autorizuar nga drejtori, nuk mundet secili person të autorizohet për një punë të tillë. Po ashtu, mendoj se Projektligji në fjalë do të duhej të përmbante edhe listën e mallrave që do të përfshiheshin në kuadër të rezervave shtetërore të mallrave. Ju faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Pasi nuk kemi numër të mjaftueshëm për votim, votojmë pasi t'i kryejmë ligjet në parim, në lexim të parë.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2004/33 për blegtorinë e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Në emër të Qeverisë, Projektligjin e prezanton ministri i Tregtisë, Industrisë, zoti Zharku. Urdhëroni, zoti Lutfi.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurt ta paraqes Projektligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/33 për blegtorinë e Kosovës.

Ky veprim legjislativ është ndërmarrë në përputhje të plotë me përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vendosjen e ligjshmërisë në programin e politikave bujqësore. Ligji për blegtorinë e Kosovës nuk ka gjetur implementim të plotë për shkak të mangësive që kanë ekzistuar prandaj dhe është paraqitur nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e tij. Fusha e veprimit të këtij projektligji konsiston në krijimin e infrastrukturës ligjore për zbatimin e ligjit në tërësi dhe plotësimin e vakumit ligjor që ka të bëjë me dispozitat ndëshkimore përfshirë edhe ndryshimin në terminologji e që bëhet për shkaqe profesionale praktike dhe në përputhshmëri me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Projektligji plotëson vakuumin ligjor të kontrollit dhe mbikëqyrjes së mbarështimit të kafshëve shtëpiake, ushqimit dhe aditivëve për kafshë shtëpiake dhe prodhimeve blegtorale të prodhuara në fermë sipas standardeve zooteknike.

Projektligji ka për qëllim të adresojë të gjitha çështje që kanë të bëjnë me kuptimin e strukturës komplete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore dhe është hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore në harmoni me legjislacionin e Unionit Evropian gjegjësisht direktivave përkatëse që kanë të bëjnë me ushqimin e koncentruar, përmbajtjen e ushqimit të koncentruar, kontrollin e cilësisë dhe aditivët e ushqimit të koncentruar.

Risitë dhe avancimet që sjell ky projektligj konsistojnë në organizimin më funksional dhe më të qëndrueshëm të kësaj fushe dhe është në interesin e përgjithshëm të zhvillimit të bujqësisë, duke krijuar stabilitet legjislativ për fushën të cilën e rregullon.

Hartimi i Projektligjit është në përputhje me parimet themelore të nenit 36 të Rregullores së punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës Numër 1/2007 për shqyrtimin dhe hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore.

Gjatë hartimit të këtij projektligji si model bazë është marrë legjislacioni slloven, austriak dhe gjerman.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore. Projektligji është shqyrtuar dhe përfunduar nga Grupi punues qeveritar në përbërje nga Zyra e kryeministrit, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, ajo e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Agjencia e Ushqimeve dhe Veterinës.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit të kësaj fushe, si dhe nevojën për rregullimin legjislativ në përputhje me legjislacionin e BE-së ju rekomandoj që këtë projektligj ta miratoni në këtë seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të komisionit, Naser, a e do fjalën? Jo. Atëherë, vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Elheme Hetemi e ka kërkuar fjalën.

ELHEME HETEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Projektligji për blegtorinë e Kosovës është begatuar dhe rregulluar në pajtim me praktikat më të mira për zhvillimin e procedurave gjyqësore sipas të cilave gjykatat e rregullta kanë qenë të suprimuar për të udhëhequr procedurat gjyqësore për veprimet e kundërligjshme pasi që ligji aktual i ka kufizuar sanksionet administrative.

Në pajtim me vakumin që ka pasur në ligjin aktual në fuqi këtë ndryshim-plotësim të Projektligjit që e kemi përpara, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/35 për blegtorinë e Kosovës.

Në fakt, plotësim-ndryshimi i këtij ligji synon rregullimin e dispozitave ndëshkuese nga ligji ekzistues në mënyrë që të përshtatet me standardet e Bashkimit Evropian për blegtorinë, andaj Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së deputetja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me ju thënë të drejtën, fillimisht na u befasuam që ky ndryshim i këtij projektligji ka ardhur dhe është sponsorizuar nga Zyra e kryeministrit, po më vonë e kuptuam se kjo lidhet me bartjen e Agjencionit të Veterinës që është bërë kohë më parë dhe nga Ministria e Bujqësisë në zyrën e kryeministrit, gjë të cilën ne edhe atëherë e kemi kritikuar për faktin e thjeshtë se nuk është në kundërshtim me të gjitha normat ndërkombëtare, me të gjitha ligjet, është kritikuar edhe nga Komisioni Evropian, është bërë për interesat e bartjes së të hyrave buxhetore ... pranë kryeministrit dhe jo për qëllime të rregullimit të kësaj fushe...

Ministri gjatë prezantimit tha që Projektligji siguron stabilitet dhe ne konsiderojmë se Projektligji nuk siguron stabilitet, atëherë kur nuk ka vullnet politik me zbatua ligjin. As ligji ashtu siç ka qenë deri më sot nuk është zbatuar prandaj frikohemi që edhe këto ndryshime janë sa për t'u bërë ose sa për të marrë notë pozitive me një raport i cili pritet të vjen, por në fakt nuk do të rregullojë lëmin e bujqësisë sepse nuk ka plan konkret kjo qeveri për ta bërë këtë dhe nuk ka vullnet politik për t'i zbatuar ligjet. Ne për hir të asaj që u tha më herët nga kolegët deputetë dhe nga grupe parlamentare do ta përkrahim mirëpo dyshojmë shumë që do të thotë këtë përmirësim apo avancim të këtij projektligji duke marrë parasysh mosgatishmërinë e Qeverisë me i zbatua ligjet do të ndryshojë diçka apo përmirësojë në mirëqenien e qytetarëve dhe në fushën të cilën e rregullon. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Heset Cakolli, në emër të AKR-së

HESET ÇAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2004/38 për blegtorinë e Kosovës ka për qëllim të plotësojë Ligjin ekzistues i cili gjatë zbatimit të tij ka pasur vështirësi dhe si rezultat i këtyre vështirësive apo sfidave në implementimin e tij ka lind edhe nevoja të bëhet plotësimi i disa neneve të caktuara.

Projektligji, të cilin po e shqyrtojmë sot, është përshtatur me ligjet e shteteve të Bashkimit Evropian e sidomos me direktivat e Bashkimit Evropian që kanë të bëjnë me përmbajtjen, kontrollimin e cilësisë dhe aditivëve të ushqimit të koncentruar që përdoret për ushqim të bagëtive.

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i jep mbështetje në parim këtij projektligji por kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale përmes anëtarëve tanë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fusha e veprimit të këtij projektligji konsiston në krijimin e një infrastrukture ligjore praktike e cila është vërejtur që nuk është zbatuar dhe bazë e plotësim-ndryshimit të Projektligjit për blegtorinë e Kosovës janë shtatë nene, në të cilat, gjatë monitorimit të zbatimit në praktikë të këtij ligji, janë vërejtur vakuume dhe defekte në zbatim praktik, gjithashtu nuk ka qenë në harmoni të plotë dhe në përputhshmëri të plotë me disa nga direktivat kyçe të Bashkimit Evropian.

Grupi Parlamentar i LDD-së e mbështet plotësim-ndryshimin e këtij ligji, duke uruar që vërtet këto plotësime në këtë ligj të rëndësishëm të gjejnë zbatim praktik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, nuk ka. Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili e ka kërkuar fjalën.

MURSELJ HALILJI: Zahvaljujem, gospodine predsjedniče!

Članovi kabineta, pozdrav ispred Parlamentarne grupe SLS!

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona i uglavnom se slažemo sa prethodnim govornicima koji su uglavnom rekli sve bitnije. Podržavamo promene koje će uslediti u tekstualnom delu, obzirom na izmene pojmova kao što su „administrativne sankcije“ zamenjuju se pojmom „kaznene odredbe“, zatim pojam „povreda“ zamenjuje se pojmom „prekršaj“, što recimo možda suštinski nije tako bitno, ali u kontekstu stvari mnogo razjašnjava i omogućava lakšu primenu, odnosno shvatanje značenja ovog nacrt zakona, odnosno budućeg zakona.

Kažem, Parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi për Integrim, deputeti Vladimir Todorović e ka fjalën.

VLADIMIR TODOROVIĆ: Hvala, predsjedniče!

I naša Parlamentarna grupa za integraciju podržaće u načelu ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani kemi edhe dy diskutues. Deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Nëse arsyeja e sjelljes së ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit ekzistues për blegtorinë e Kosovës Numër 2004/33 është siç thotë Qeveria që ta plotësojë këtë ligj, ta përmirësojë ligjin ekzistues dhe sidomos për shkak se nuk është zbatuar se s'ka ekzistuar mundësia e zbatimit të dispozitave ekzistuese dhe cilën në qendër e vë mungesën e dispozitave ndëshkuese dhe një arsyetim tjetër është se do ta bëjë përafrimin me BE-në.

Pyetja është se, a po arrihen me këtë ndryshim-plotësim qëllimet të cilat i ka parashtruar ose që synon t'i arrijë Qeveria me këtë ndryshim-plotësim? Do të thotë të plotësojë bazën ligjore për përgjegjësinë kundërvajtëse, të rregullojë apo mbikëqyrë inspektimin e mbarështimit të kafshëve shtëpiake, të ushqimit të kafshëve dhe aditivëve dhe të ngritë standardet e cilësisë së prodhimeve blegtorale.

Unë do ta shqyrtoj nga një aspekt shumë të rëndësishëm për ndikimin që ka ky ligj në popullatën e Kosovës, konkretisht nga aspekti i mbrojtjes së shëndetit publik. Nga aspekti i mbrojtjes së shëndetit publik ky projektligj nuk i plotëson kushtet që duhet paraparë sidomos ato të cilat duhet të jenë në harmonizim me direktivat evropiane, ato të cilat kanë të bëjnë me ushqimin e koncentruar, me përmbajtjen e ushqimit, me kontrollin e cilësisë së aditivëve të ushqimeve të koncentruar. Po ashtu ky projektligj me plotësim-ndryshim do të ishte më i plotë në aspektin e mbrojtjes së konsumatorëve, ashtu siç i përcaktojnë direktivat evropiane.

Megjithatë, meqenëse nga aspekti buxhetor është i përballueshëm dhe bile parashihen edhe të hyra, mbase në amendamentimin e tij në komisionin funksional duhet të punohet në plotësimin apo amendamentimin e mëtejshëm të tij ashtu që ligji me të vërtetë të arrijë qëllimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, s'kemi më, një herë e marrin fjalën deputetët, jo dy herë. Mësoni rregullën. E kemi pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale

Pra, për të mos e lexuar arsyetimin unë, kërkesa është për t'u tërhequr ky ligj. A jeni dakord? Vazhdojmë!

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale ka qenë i radhitur për shqyrtim të parë në mbledhjen plenare të mbajtur më 11 qershor 2009.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar shtyrjen e shqyrtimit të parë të këtij projektligji për 1 muaj. Ndërkohë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e Projektligjit nga procedura e shqyrtimit.

Ministri, nuk është këtu...!

Në bazë të nenit 56, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend deri para fillimit të votimit në shqyrtimin e dytë. Mund të kërkohet edhe deklarimi i komisionit funksional për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale si dhe grupet parlamentare. A e doni fjalën lidhur me këtë? Nuk e doni!

Mirë, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka kërkuar Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryetar,

Që në fillim dëshiroj të theksoj se është shumë joserioze dhe e papërgjegjshme nga Qeveria. Kjo është edhe një dëshmi për një veprim ad-hoc të mungesës së vizionit dhe zhvillimit të politikave sociale. Në vend që të zhvillojë politika sociale të qëndrueshme, pas kalimit në leximin e parë dhe kjo është bërë në nëntor të vitit 2009, tani në shtator të vitit 2010 Qeveria kërkon tërheqjen.

Unë po ju lexoj çka vetë Qeveria shkruan, për të dokumentuar dhe dëshmuar atë çka thashë. Thotë: “Për shkak të mungesës së disa dokumenteve politike dhe strategjike nga fusha e mirëqenies sociale, në muajin dhjetor, me iniciativën e ministrit të Minsitrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkohësisht janë pezulluar procedurat e shqyrtimit të këtij akti ligjor.” Do të thotë, vetë Qeveria e pranon se nuk ka strategji për politikat e mirëqenies sociale.

Ajo çka është dashur të ndodhë, këtu qenka zëvendëskryeministri, i cili gjithashtu mban përgjegjësinë që ministri nuk është këtu t’i japë sqarime të nevojshme Kuvendit, si dhe ishte dashur ministri të na tregojë nëse e tërheq Ministria atë, cilat ndryshime do t’i bëjë dhe kur do ta sjellë sërish në Kuvend, të mos na ngjajë pas një viti t’i bie prapë pishman e të thotë se nuk e ka strategjinë ose s’i kanë zhvilluar politikat dhe s’mund ta sjellin ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Diskutuesja e fundit, e lajmëruar natyrisht, deputetja Nurishahe Hulaj!

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Ne kemi shqyrtuar këtë ndryshim dhe plotësim të skemës së ndihmës sociale të ligjit. Gjithashtu, në bazë të dokumentit që e kemi marrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ku është cekur se ky projektligj – ndryshim dhe plotësim i skemës sociale duhet të tërhiqet, meqenëse në vitin 2009 komisioni funksional për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale e ka shqyrtuar dhe ka filluar me amendamentuar këtë projektligj dhe në ndërkohë në dhjetor të vitit 2009 është tërhequr ky projektligj. Andaj, element kryesor dhe esencial është se nuk ka mjete buxhetore për të plotësuar dhe për të qenë i zbatueshëm ky projektligj për arsye se duhet të bëhen disa ndryshime dhe të krijohen disa mekanizma tjerë ku do të përcaktohen kriteret e tjera për të futur familje të reja në këtë ndihmë sociale dhe për të shtuar moshën 6 deri 18 vjeç për ndihma sociale. Gjithashtu edhe familjet që kanë më shumë se 7 anëtarë t’u shtohet nga 5 euro, e gjithashtu edhe grupit 5 deri 18 vjeç, prandaj kjo shumë e mjeteve nuk është paraparë në kornizën afatmesme 2009-2011, por nga viti 2011-2013 konsideroj se do të plotësohen kriteret që ky ligj të hyjë në fuqi, të vijë dhe të miratohet në Kuvendin e Kosovës, andaj edhe Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar dhe jemi të mendimit që ky ligj të tërhiqet sipas kërkesës së ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim që në vitin 2011 të plotësohen të gjitha kriteret e parapara për të qenë ky ligj i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë kemi 63 deputetë. Pra, kërkesa është që të tërhiqet nga shqyrtimi i parë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 52 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale nga procedura e shqyrtimit.

Pasi jemi këtu, kthehemi te pikat shtatë dhe tetë për të votuar, në parim:

- Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 64 vota “për”, asnjë kundër, 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave.

Në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime apo edhe amendamente.

Tani, votojmë:

- Shqyrtimi i parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2004/33 për blegtorinë e Kosovës

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2004/33 për blegtorinë e Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime apo edhe amendamente.

Dhe, para se të fillojmë shqyrtimin e dytë të Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, kërkoj nga komisionet për ligjet që i kanë në shqyrtim të përgatisin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Naser Rugova apo raportuesin e komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni funksional i Kuvendit të Republikës së Kosovës për bujqësi, pylltari, zhvillim rural dhe planifikim hapësinor ka përgatitur raportin me rekomandime lidhur me Projektligjin Numër 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Konsideroj që i kemi bërë amendimet e nevojshme në bazë të një debati po edhe ekspertizës edhe vendore edhe ndërkombëtare, konsideroj që është një ligj i mirë, është në përputhshmëri të plotë me *acquis communautaire* dhe direktivat e BE-së dhe ftoj kolegët deputetë që ta mbështesin këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Para se të fillojmë me votimin, ju njoftoj se amendamentete në këtë projektligj ka propozuar vetëm komisioni funksional dhe atë gjithsej 20 amendamente. Fillojmë me votimin dhe votojmë amendamentin e parë.

Amendamenti 1.

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Regjia, votojmë amendamentin 2.

Me 50 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Urdhëroni! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova!

NASER RUGOVA: Faleminderit, kryetar!

Te amendamenti 9, neni 18, në paragrafin 1, në fund fjalia “departamentin për mbrojtjen e mjedisit” zëvendësohet me fjalën “ministra”, është lëshuar një gabim teknik, është “ministri”. Duhet të jetë “ministra”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pra, te amendamenti 9, fjala e fundit të zëvendësohet “departamenti” është në materialin që e kemi “ministri” duhet të jetë “ministra”. Me këtë ndryshim e votojmë amendamentin e nëntë.

Amendamenti 9.

Me 44 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9 me ndryshimet e cekura.

Amendamenti 10.

Me 46 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Me 46 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Me 51 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Në sallë janë 65 deputetë.

Me 49 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20, i fundit.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 20.

Tani votojmë tekstin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 59 vota “për”, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miraton Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ju faleminderit!

Para se të vazhdojmë me rendin e ditës, ministri Rashiq ka një sqarim për Ligjin që e tërhoqëm pak më parë. Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Ja se stvarno izvinjavam! Ja sam bio obavešten, moj staf me obavestio da je zakon povučen zbog toga što već duže vreme sa TAIEX-om, zajedno sa Evropskom komisijom radimo na modifikaciji zakona jer nam je tad bilo preporučeno da zakon mora biti doraden, tako da sa ove stručne strane treba da bude još bolji nego što jeste. Jer i sami znate da je zakon bitan, a imao je neke kontradiktornosti u sebi. Prema tome, izvinjavam se što ove informacije nisu onako bile... Nisam bio informisan na vreme, ali ja vas uveravam da će zakon do kraja godine da bude pripremljen tehnički od strane, kao što sam rekao, još jednom, TAIEX-a i Evropske komisije, zajedno sa nama i biće vam predstavljen. Hvala vam na razumevanje!

KRYETARI: Faleminderit, ministër për informimin! Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Propozimi i Strategjisë së sigurisë të Republikës së Kosovës

Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës.

Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri e ka shqyrtuar Propozim-strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi ta prezantojë propozim-strategjinë.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuari, kryetar i Kuvendit,

Zëvendëskryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që sot para jush të paraqes për shqyrtim dhe miratim Strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës. Siguria e shtetit është përgjegjësi kryesore e çdo shteti demokratik. Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës veprojnë me transparencë të plotë në pajtim me standardet demokratike dhe mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Kjo nuk përfshinë vetëm sigurinë dhe qetësin e qytetarëve por ka të bëjë edhe me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, sundimin e ligjit, mbrojtjen e lirive individuale dhe mbështetja individuale e të drejtave të njeriut janë elemente të domosdoshme për ruajtjen e sigurisë së shtetit.

Duke u nisur nga ky fakt dhe në pajtim me nenin 127 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 2 të Ligjit për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka përgatitur Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës.

Strategjia e sigurisë fillimisht ka marrë aprovimin nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës me datën 10 qershor 2010 dhe me sugjerimin e Këshillit të Sigurisë kjo strategji është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2010 dhe po i paraqitet sot për miratim përfundimtar Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Strategjia e sigurisë parashtron objektivat strategjike të sigurisë së shtetit dhe prezanton ministritë dhe agjencitë që të angazhohen për t'i arritur ato. Veç kësaj, identifikon sfidat e sigurisë dhe diskuton mënyrat përmes të cilave ministritë, agjencitë dhe qytetarët mund t'i adresojnë ato së bashku. Kjo strategji është pikënisje drejt rrugës për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Strategjia e sigurisë së Republikës së Kosovës përmban 3 kapituj. Në kapitullin e parë, është përfshirë konteksti strategjik dhe objektivat strategjike.

Në kapitullin e dytë është përfshirë qasja mbar-qeveritare, rendi kushtetues dhe institucionet e sigurisë.

Ndërkaq, në kapitullin e tretë janë përfshirë sfidat e ndryshme dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

Kjo strategji është pikënisje drejt rrugës për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional. Përmes saj Këshilli i Sigurisë së Kosovës do të punojë me ministritë, agjencitë dhe institucionet e sapo themeluara të Qeverisë duke i angazhuar ato në procesin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në shfrytëzimin racional të resurseve të kufizuara të Kosovës.

Strategjia e sigurisë varësisht prej rrethanave të përgjithshme të sigurisë mund të plotësohet dhe ndryshohet.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Qeveria është e vendosur t'u shërbejë qytetarëve të saj në bazë të vlerave demokratike, respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbështetjes së sundimit të ligjit. Dhe duke u nisur nga fakti që Strategjia e sigurisë do t'i kontribuojë sigurisë së të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës ju ftoj që ta miratoni Strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! A e do fjalën kryetari i komisionit funksional për punë të brendshme dhe siguri? Fjalën e ka deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në bazë të nenit 65 pika 12 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të Shtojcës numër 2 të Rregullores së Kuvendit, në bazë të përfundimit 03/P-254 të Kryesisë së Kuvendit, Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, në mbledhjen e mbajtur më 21 korrik 2010, pasi ka shqyrtuar Strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës, ka nxjerrë edhe rekomandimet:

1. Parathënia e Strategjisë së sigurisë të zëvendësohet me: hyrje.

Strategjia e sigurisë së Republikës së Kosovës nuk lidhet me një mandat dhe në bazë të kësaj nuk është e nevojshme të nënshkruhet nga liderët shtetërorë. Kjo është një praktikë e cila aplikohet në të gjitha strategjitë e shteteve të rajonit.

Komisioni i ka marrë në konsiderim të gjitha strategjitë e vendeve të rajonit dhe të vendeve që prodhojnë demokraci dhe ka dashtë që edhe vendi ynë t'iu bashkëngjitet atyre shteteve.

2. Të krijohen mekanizma që do të pengonin grupet e interesit, që kanë synim që në mënyrë jo ligjore të ushtrojnë ndikim në institucionet e Republikës së Kosovës me qëllim të dobësimit të bazës ekonomike të shtetit.
3. Edukimi të bëhet sipas standardeve të larta dhe në bazë të nevojave të shtetit për ngritjen e kapaciteteve.
4. Të ketë angazhime më të mëdha në mënyrë që të krijohet siguri për investimet e huaja si dhe të mbrohet komuniteti i biznesit.
5. Të shtohet mbikëqyrja rreth keqpërdorimit të ideologjive fetare.

Zoti kryetar,

Për këto rekomandime, edhe pse më parë nuk është lejuar të hyhet të preket në strategjisë, kemi pajtimin edhe të mekanizmave ndërkombëtarë, siç jeni të njoftuar edhe ju.

Komisioni ka ardhur në përfundim se dokumenti është dokument i mirë, është dokument modern. E mira e dokumentit është se është dokument lëvizës. Në krijimin e mekanizmave tjerë institucional të sigurisë ne mund të ndërhyjmë në projekt-strategjinë dhe është dokument që flet për sigurinë e vendit me terminologji të duhur dhe me terminologji të butë. Flet për zhvillimin dhe edukimin institucional të gjithë njerëzve në vendin tonë.

Pra, komisioni i rekomandon Kuvendit dhe deputetëve që ta miratojnë Strategjinë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Janë edhe dy rekomandime, edhe nga Komisioni për mbikëqyrje e Agjencionit të Kosovës për Inteligjencë. Kryetari, nuk është këtu! Mimoza Ahmetaj, e ka fjalën!

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse kryetari doli dhe po ashtu edhe zoti Buçinca si nënkryetar i Komisionit nuk është këtu, u morëm vesh që në emër të Komisionit t'i them unë disa fjalë.

Strategjia e sigurisë kombëtare është një dokument të cilin Kosova për herë të parë e harton dhe i cili ngërthen në vete të gjithë faktorët dhe mekanizmat e sigurisë dhe të tjerë, që qoftë të drejtpërdrejtë apo indirektë, janë të përfshirë në çështje të sigurisë.

Kjo strategji ka një rol për të tanishmen dhe për të ardhmen, pasi që skicon interesat bazë të vendit dhe përcakton udhëzimet për trajtimin e rreziqeve dhe mundësive aktuale dhe të ardhshme. Normalisht strategjia është një hierarki superiore ndaj politikave të tjera të sigurisë si doktrinës ushtarake, strategjisë së sigurisë së brendshme e tjera, të cilat merren me sigurinë kombëtare në bazë të agjencive apo të çështjeve të veçanta.

Strategjia është një dokument gjithëpërfshirës, e cila i trajton të paktën 3 tema: rolin e shtetit; sfidat dhe mundësitë që perceptohen brenda dhe jashtë shtetit; si dhe përgjegjësitë e akterëve zbatues për trajtimin e këtyre sfidave dhe mundësive.

Janë pesë arsye pse shtetet duhet të kenë një politikë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të sigurisë kombëtare edhe pse një numër i madh i shteteve nuk i bëjnë publike dokumentet e politikave të tyre ose nuk i kanë të shkruara politikat gjithëpërfshirëse për sigurinë apo mbrojtjen në përgjithësi.

Atëherë, arsyet pse duhet ta kemi një strategji janë: që të sigurohet që Qeveria do t'i trajtojë të gjitha rreziqet në mënyrë gjithëpërfshirëse; që të rrisë efikasitetin e sektorit të sigurisë duke optimizuar kontributet e të gjithë akterëve të sigurisë; që të drejtojë zbatimin e politikës; që të ndërtojë konsensusin e brendshëm të vendit, dhe që të rrisë besimin dhe bashkëpunimin regional dhe ndërkombëtar.

Sfidë kryesore gjatë hartimit të një strategjie, është baraspesha në mes të hapjes dhe fshehtësisë, me një fjalë sa guxon një çështje të bëhet publike dhe deri ku.

Nuk dua të përmend Kushtetutën sepse ministri në fjalën e vet e përmendi, mbi bazën e cilit nen të Kushtetutës dhe cilës pikë obligohet Këshilli Kombëtar i Sigurisë që ta sjellë strategjinë, por dua të them se edhe Komisioni për mbikëqyrje të acqui-s e ka trajtuar strategjinë dhe kemi analizuar dhe rekomandon që Strategjia të miratohet si e tillë sa më shpejt, si dhe acqui-a t'i ndërtojë kapacitetet e veta të plota në mënyrë që të jetë funksionale sa më shpejt që është e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kush e do fjalën. Ose, e konsideroni të kryer! Mirë, faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, Berim Ramosaj, e ka fjalën!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Unë këtë herë do e mbështes Strategjinë edhe në emër të Komisionit për mbikëqyrjen e FSK-së dhe në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Duke marrë parasysh principiellisht komponentën e participimit të gjithë akterëve relevantë të sigurisë së Kosovës në hartimin e kësaj strategjie dhe aspektin gjithëpërfshirës të strategjisë së sigurisë nacionale të Kosovës, ne kemi shqyrtuar të gjithë komponentët relevantë dhe mendojmë, edhe si komision, se i plotëson të gjitha karakteristikat e një dokumenti mjaft të gjallë në kuptimin e ndërtimit të tij dhe në kuptim të perfeksionimit në aspektin e strategjisë së këtij fenomeni që është vërtet shumë i ndjeshëm, e po ashtu edhe në kuptimin e edukacionit në sigurinë dhe krijimin e kushteve apo të një mjedisi mjaft heterogjen që ndodhet Kosova, andaj aspektet që përfshihen në këtë strategji i plotësojnë të gjitha karakteristikat për të vepruar të gjithë akterët relevantë në Kosovë.

Edhe një herë them se e mbështesim edhe si Grup Parlamentar, edhe në emër të Komisionit për mbikëqyrjen e FSK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Me gjithë respektin, Grupi ynë Parlamentar e ka pasur një synim të mirë kur e ka marrë para veti strategjinë. Qëllimi ka qenë me e studiua mirë dhe me provu me ndihmu, mirëpo realisht i kemi disa dilema serioze tani në lidhje me këtë dokument.

Për mos me pas dilema te deputetët e partive në pushtet pse jemi kundër, po ju them, janë disa arsye zakonisht pse deputetët e opozitës munden me qenë kundër. E para është se ndoshta nuk pajtohen dhe në këtë rast nuk pajtohem me këtë dokument dhe e dyta është se, që është e ndërlidhur me të parën, nuk domi me u identifiku me votimin e këtij dokumenti. Do të thotë janë arsye në daçit filozofike, në daçit praktike, tepër të kjarta.

Tani mund të themi se dokumenti është shkruar mirë. Në fakt, përkthyesi e ka ditur mirë gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, po nuk e ka dit mirë materien. I keni dy ose tri pika në të cilat shihet kjartë pse, për shembull, në gjuhën shqipe nuk përdoret fjala “drogat e paligjshme” për shkak se të gjitha drogat janë të paligjshme në gjuhën tonë qysh e përdorim, përderisa në anglishte droga iu thuhet edhe barnave kështu që ka edhe droga të ligjshme dhe të paligjshme. Domethënë, për ne ka fjalë barna dhe ka fjalë drogë, dhe droga e paligjshme është përkthyer drejtpërdrejt, që do me thënë që përkthyesi ka qenë i mirë po nuk e njeh materien. Do të thotë, e njeh gjuhën por nuk e njeh materien, që na bën me dyshu se mundet me pas elemente tepër interesante këtu.

Tani, unë krejt çka duhet me bë për me diskutu për Strategjinë në emër të Grupit, është me lexu strategjinë në mënyrë që kushdo që nuk e ka lexu e ndëgjon dhe e sheh se çka thuhet në Strategji, por për mos me ju lodh juve shumë due me i lexu vetëm disa pjesë, shembull ta marrim, kushdo që e ka përpara le të shkon në faqe 12 flet për sundimin e ligjit dhe thotë kështu:

“Qeveria e Republikës së Kosovës po përmirëson, modernizon dhe reformon institucionet e saj gjyqësore dhe institucionet tjera në përmbushjen e sundimit të ligjit. Zbatimi efektiv i legjislacionit mbetet në qendër të përmbushjes së këtij objekti të rëndësishëm. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative do ta avancojë përafrimin dhe zbatimin e standardeve evropiane” dhe në fund “ndaj pohimeve për korrupsion në gjyqësi, do të vepohet menjëherë dhe do merren masa për përmirësimin, në përputhshmëri me ligjin.”.

Domethënë, kjo është provizion i Strategjisë që i ka diku nja 17 faqe, me përshkrime.

Çështja tjetër që do ta lexoj prapë, flet për korrupsionin. Pika 3.5 e njëjta faqe, menjëherë paragrafi vijues, thotë kështu: “Korrupsioni ka ndikim të madh në siguri dhe zhvillim ekonomik. Ai i dëmton vlerat shoqërore, zbeh besimin ndaj institucioneve qeveritare, ngadalëson reformat ekonomike, politike e ligjore dhe dekurajon investitorët.

Qeveria e Republikës së Kosovës është gjithashtu e vetëdijshme se korrupsioni, së bashku me krimin e organizuar është pengesa kryesore e zhvillimit të qeverisjes së mirë dhe vonon procesin e integritetit në strukturat ndërkombëtare.

Për të luftuar korrupsionin, korniza legjislative dhe institucionale do të përforcohet nga Agjencia kundër korrupsionit dhe prokurorit do të kërkohet të përmirësojnë bashkëpunimin.

Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Vendimit Numër 02-110 ka ngritur Grupin punues ndërministror kundër korrupsionit në mënyrë që të japin rezultate konkrete...”

Mundem me vazhdue edhe më tutje, vetëm edhe një paragraf për mos me ju lodhë, e keni në faqe 14 – ekonomia.

Do të thotë, po përmend sfidat e sigurisë dhe thotë kështu: “Qeveria e Republikës së Kosovës po punon në krijimin e një ambienti që tërheq investimet e huaja...”. Domethënë ajo ke më përpara kush po i ndalë, kjo tjetra kush po i afron investimet e huaja. “...të cilat janë parakusht i domosdoshëm për stimulimin e rritjes së ekonomisë dhe për t’i kontribuar zbutjes së varfërisë.

Aftësia e Kosovës për të siguruar burime stabile të energjisë është bazament i kësaj, siç është krijimi i infrastrukturës publike të besueshme dhe furnizimi me ujë, koordinimi i vazhdueshëm i politikave dhe forcimi i mëtejme i sundimit të ligjit po vazhdon në mënyrë që të reagohet ndaj këtyre sfidave.

Luftimi efektiv i korrupsionit dhe reduktimi i burokracisë konsiderohet prioritet i të gjitha institucioneve të shtetit”.

Për mos me vazhdue më tutje, ju dhashë një ide se cila është fryma e dokumentit. Strategjia nacionale për siguri i ka, ju thash edhe një herë, nga 16 – 17 faqe, me gjithë letrën që ia ka çu Kuvendi kryeministrit bashkë me presidentin. Nëse dikush prej historianëve, edhe ka të bollshëm në Kuvendin e Kosovës, ka mbërri me i lexua elementet e sigurisë në mbretërinë e mbretit Zog të Shqipërisë e sheh se ajo ka qenë më kombrehensive, më gjithëpërfshirëse, e përmendi dikush këtu po jo vetëm aq gjithëpërfshirëse por edhe më e thuktë, që do të thotë se ka pas ma shumë sfida të identifikuar në atë kohë, ka pas ma shumë mekanizma, ka pas ma shumë analizë dhe të gjitha këto kanë qenë në mënyrë shumë më të detajuar të shpjeguara se sa në Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për siguri të cilën ne e kemi marrë sot në vitin 2010, do me thënë në fund të vitit 2010.

Mendoj se për Kuvendin e Kosovës është pak e çuditshme nëse sot, megjithë respektin edhe një herë po them, e aprovon këtë strategji të sigurisë, në cilën ka mungesa serioze, shembull ta marrim – qysh mundet Kosova me pas strategji të sigurisë dhe mos me iu qas pak më me kujdes veriut të Kosovës? Qysh mundemi me pas na strategji të sigurisë dhe me folë, shembull ta marrim, për investimet e huaja që kanë ndikim në siguri, është shumë e vërtetë, e me folë për qeverisjen e mirë që ka definitivisht ndikim dhe mos me fol hiq për veriun e Kosovës?

Nëse dikush prej deputetëve di me ma shpjegue mu këtë çështje, unë kisha me qenë më se mirënjohës. Prej Qeverisë nuk pres, për herë të tretë po e përmendi, përkundër respektit që mbaj për ministrin e cili e paraqiti Strategjinë, e kisha thirr Kuvendin e Kosovës që të mos e votojmë për shkak se ky është vetëm një non-peiper, një dokument i bardhë që i paraqet disa sfida në mënyrë shumë të tërthortë, në mënyrë shumë të cekët dhe i cili nuk përmban asnjë element të vetëm i cili mundet me u quajt si element i një strategjie për me mbërri prej një pike a, në të cilën gjendemi sot, ose prej një gjendje në të cilën jemi sot në një gjendje në të cilën synojmë të jemi dhe të cilën e ka projektuar Qeveria përmes një strategjie.

Edhe një herë po them, nëse dikush në Kuvendin e Kosovës di me më tregu mu se prej cilës gjendje në cilën gjendje na dërgon kjo strategji ose do të na dërgojë eventualisht, ndoshta Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ndërron mendjen. Përndryshe, ne ju thërrasim, jo pse jemi opozitë, jo pse duhet me qenë gjithmonë kundër qysh po aludon dikush, por për shkak se nuk është mirë me e votu dhe ne nuk po domi me u identifiku me këto far strategji që janë bërë vetëm sa me ardhë e me u votu në Kuvend, dhe as edhe një element të vetëm të mirë nuk ia sjellin vendit. Është krejtë kot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar... Jo, është mirë, kryetarët e komisioneve kur të raportojnë, të raportojnë a është me konsensus, sepse çdo grup parlamentar i ka anëtarët e vet nëpër komisione. Prandaj, unë mendoj se duhet këtu të ceket. Urdhëro, Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Unë kam harruar ta cek, bile kanë bërë punë të mirë edhe të Partisë së zotit Gjini që foli, kanë bërë punë të mirë në komision. Me konsensus ka shkuar, me të gjithë votuesit “për”, por unë po dua të them edhe diçka për parafolësin. Ai nuk është duke kuptuar që është strategji për sigurinë e vendit. Ai po mendon që është strategji për një pjesë të Prishtinës, ose të një komune tjetër. Nuk guxon, në dokument për sigurinë e vendit të identifikohet një pjesë, të flitet për një pjesë, kështu që unë po dua të besoj se e ka keqkuptuar për cilën strategji po flet, dhe nuk e di se për çka po flitet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Fillimisht, duhet me thënë se nuk pat të drejtë zoti Rustem Mustafa me më repliku se nuk e përmenda dhe s’ka nevojë me më spjegju.

E dyta është, zoti kryetar, nëse e pyet komisionin se a ka pas konsensus pse s’po na pyet edhe neve në Grup dhe pyeti grupet tjera a kanë konsensus ndonjëherë për shkak se shkaktohet konflikt në mes të ideve aty.

Dhe e treta, realisht ne e dimë çka lexojmë, e dimë edhe çka bëjmë, dimë me lexu, kemi kry ngapak shkollë edhe na dhe e marrim vesh çka është strategjia. Edhe na po ju themi këtu që nuk mundet me pas strategji të sigurisë së Kosovës pa u përmend veriu. Duhet me ma shpjegue dikush se pse nuk po bëjka me u përmend veriu në strategji, se koka pjesë partikulare ose koka si Prishtina veriu. Mendoj, nuk bën me bë kesi far krahasimesh, nuk janë të mira! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli e ka fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Unë, fillimisht nuk do të pajtohesha me rekomandimin e komisionit, rekomandimin numër 1, ku thuhet atje që nuk do të duhej të ketë nënshkrim të liderëve shtetërorë. Unë po e them që është shumë e nevojshme, madje e domosdoshme, sepse besoj është një dokument i mirë për libra të historisë, me hy në histori që e kanë bërë një strategji këta dy njerëz, por ndoshta edhe në ndonjë lëndë diku të mbrojtjes dhe sigurisë. Si duket e kanë mani me hy nëpër libra të historisë kur shpallin shtete ose kur krijojnë diçka, prandaj besoj se do të duhej me qenë këtu, e ka vendin, ju flenë këtyre njerëzve me hy në libra të historisë që kanë bërë strategji të mëdha.

Po kthehem në materie. Kolegu Gjini tha, i ka nja 17 faqe, e unë po them që Strategjia i ka nja 4 faqe e gjysmë dhe atë deri në gjysmë diku, sepse i keni nja 7 faqe ku ka përshkrim, përshkrim të fushëveprimit të institucioneve. Nëse i merrni, na keni shpëtuar. Faleminderit shumë! Se, u dashke me i marrë krejt ligjet dhe me këqyrë fushëveprimtarinë e këtyre institucioneve, tash i kemi në një vend se çka është aquí-a, çka është policia, se çka është agjencioni antikorrupsion, i keni 7 faqe të mbushura me këto përshkrime. Faleminderit shumë, na keni shpëtuar, sinqerisht. Na keni kursyer në kohë.

Dhe, nëse e shikoni këtu mbrapa, kjo pjesa ku flet për strategjinë, nuk e di, ndoshta këto që i keni pasur parasysh mund të quhen, diçka janë shkrime të mira, por në asnjë rast nuk të çon mallin dhe nuk e ka pamjen e një strategjie. Thjeshtë, nuk është paraparë dhe nuk e besojmë asnjë prej nesh, e së paku unë s'jam i bindur, nëse na jemi të bindur se kjo strategji e garanton sigurinë e vendit ashtu sikur që ju e keni paraparë në këto dokumente, dhe së paku mund të ballafaqohet me këto sfida që i keni qit këtu – terrorizmin, krimin e organizuar, korrupsionin e tjera, e tjera. Po them, është një dokument që ndoshta do të vlente me rishikuar edhe një herë, me përmirësuar në mënyrë që sinqerisht ky vend të ketë një strategji e cila e përfshin komplet sigurinë e vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDD-së, deputeti Naser Rugova!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar zoti ministër i Punëve të Brendshme, doktor Rexhepi,

Vërtet fjala strategji, e kur bëhet fjalë për strategjinë e sigurisë nacionale, do të duhej të ishte një dokument i përgatitur mirë, substancial, i sofistikuar, me dinamikë kohore, kosto buxhetore dhe me hapa konkretë të veprimit.

E kemi marrë një material, i cili vërtet, po ta hartonin dy maturantë që s'kanë lidhje me as... të sigurisë, me politikë, me gjeopolitikë, me aspekte ekonomike e sociale do të dilte një dokument më i mirë. Mua po më habitin kolegët e pozitës që i thonë vetit intelektualë e tjera, e tjera, si guxojnë t'i thonë po këtij dokumenti që mund të quhet një draft-dokument e kurrësi strategji, lëre më strategji e sigurisë nacionale.

Po e citoj faqen 4, shihni çka thotë në fund të pasusit të parë: “Duke pasur parasysh konfliktin nga e kaluara, populli i Kosovës është i vendosur për të zhvilluar një shoqëri multi-etnike të bazuar në besim dhe pajtim reciprok”. Kjo është gabim në qasje, në përmbajtje dhe në substancë. Në një strategji nacionale të sigurisë, zoti ministër nuk guxoni me shkruar kështu. Nuk guxoni! Do të duhej të dukej kështu: “Për të zhvilluar një shoqëri demokratike, ku sundon rendi dhe ligji” dhe pastaj vijjnë këto togfjalëshat tjerë që vërtet, nëse është hartuar nga një njeri që jeton në Kosovë, atëherë kjo është për shqetësim.

Shikoni, te objektivat strategjike! Nëntitulli për punë të përbashkët në shërbim të publikut çka thoni: “Kërkesa për të mbrojtur gjithë qytetarët është përgjegjësi e Qeverisë. Me përgatitjen e kësaj strategjie, Qeveria e Republikës së Kosovës është dhe ndien nevojën për t'i integruar ministrinë dhe agjencitë e sapo-themeluara ta Qeverisë dhe t'i përfshijë ato në procesin e bashkëpunimit ndërinstitucional”. Kjo bëhet me përshkrimin e detyrave të punës të këtyre ministrive dhe të futet ky tekst në strategjinë nacionale të sigurisë është më tepër se jo seriozitet, është jo profesionalizëm dhe këtu shihet do të thotë që më së paku bëhet fjalë për një strategji.

Prej kapitullit të dytë, në faqe 6 deri në faqe 11, keni përshkruar rolin kushtetues institucional dhe përshkrimin e detyrave të punës të institucioneve. Dhe, vërtetë, zoti ministër, me gjithë konsideratën që kemi për ju, nuk di a e keni lexuar këtë strategji. Nëse e keni lexuar dhe një forum i caktuar ka diskutuar për këtë strategji dhe e ka sjell si të tillë në Parlament, atëherë, thjeshtë: no comment! Në kuptimin më pozitiv, jo si opozitë, por si deputet dhe njerëz me përgjegjësi, si njerëz të zgjedhur, ky dokument do të duhej të kthehej prapa, të hartohej tamam si duhet, me masa veprimi, me impute konkrete, me dinamikë kohore dhe me kosto buxhetore. Asnjë strategji nacionale, më së paku ajo e sigurisë, që nënkupton artikullim gjithëpërfshirës të të gjitha nevojave, në të gjitha fushat, sektorët që

kanë të bëjnë me siguri nacionale, do të duhej t'i kenë një dy-tri fjalë në ato shtylla kyçe që janë garanci e implementimit të kësaj strategjie. Do të thotë, bëni përshkrime që vërtet kjo më së paku mund të quhet edhe draft, sepse për strategji as që bëhet fjalë.

Te Agjencioni i Kosovës për Inteligjencë, po citoj, “Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, është themeluar sipas ligjit”. Thotë, “Strategjia”! Të gjithë po e dimë, edhe që duhet me integruar institucionet, me i koordinuar dhe me krye punën e vet. Po tash, një pyetje për presidentin e vendit dhe kryeministrin që kanë përgjegjësi në këtë këshillin e lartë të sigurisë: A është kompletuar aquie-a? Çfarë të dhënash i ka ofruar Këshillit të Sigurisë të Kosovës aquie-a? Çfarë objektivash ka paraparë aquí në këtë strategji? Faktikisht, asgjë. Nuk ishit në gjendje për një vit e 8 muaj të zbuloni kush e bëri atë vjedhjen historike në dhomën e dëshmime, në trurin e institucionit më të lartë të sigurisë së vendit – në Policinë e Kosovës, në kryeqytetin Prishtinë.

Zoti ministër,

Vërtet, sjellja e një draft-dokumenti të tillë na qet në pozita joserioze edhe si institucion më i lartë ligjvënës.

Te faqja 11, kapitulli III, Sfidat dhe përgjegjësitë, po citoj: “Qytetarët e Kosovës janë më së shumti të prekur nga varfëria, papunësia dhe lidhur me këtë prarinë e vazhdueshme të korrupsionit dhe të krimit të organizuar...”. Po bie ndesh me fjalët e shefit tënd që po thotë “zero tolerancë, e kemi luftuar krimin e organizuar, e kemi luftuar korrupsionin dhe Kosova është një nga vendet më të zhvilluara dhe më të lumtura në botë”. Faktikisht, nëse jeni konsultuar ndonjëherë dhe keni diskutuar për një çështje të tillë, ky pasus nuk ishte dashur të shkruhej dhe më së paku këto konstatime që nuk iu ngjajnë as diagnozave të mjekëve pas vitit 1945, nuk ishte dashur të vijë në organin më të lartë legjislativ të vendit.

Dhe, sa i takon strategjisë së sigurisë nacionale, deshëm s’deshëm, në 30% të territorit të Republikës së Kosovës, shteti i Kosovës s’ka mund me vë dorë. S’funksionon Kushtetuta, as legjislacioni. Dhe, tani kemi hy nëpër do mjegulla të tjera, dofar dialogje, ku po përmenden edhe diskutimet për gjykatën. Mund të diskutojë dikush për dokumente udhëtimi, për regjistra civilë, për ngastra kadastralë, po se çfarë gjykatave dhe ku i organizon shteti i Kosovës dhe sa Forcat e Sigurisë i dislokon Ministria e Punëve të Brendshme në një pjesë të territorit të saj, nuk guxon as që të mendohet e lë më të vihet në shqyrtim.

Faktikisht, kjo strategji të bën përshtypje me lëvizje të fundit politike diplomatike po edhe është në inkorporim të plotë me planin gjashtë-pikësh të famshëm që erdhi në Kosovë dhe herë e mohuat e herë e pohuat, por që fatkeqësisht kjo strategji po e rreh atë tel.

Unë kërkoj nga deputetët që të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij dokumenti dhe ky dokument të kthehet prapa, të hartohet një strategji normale e një shteti që pretendon që është shtet dhe ka institucione shtetërore dhe bashkërisht do ta votojmë. Kësi drafti të çuditshëm nuk mund ta marrim obligimin dhe përgjegjësinë që e kemi si njerëz të zgjedhur t’i themi “po”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po vërtet është mirë ju grupet parlamentare, nëse keni debat dhe demokraci të brendshme t’i shqyrtoni në grupet parlamentare... Jo ju lutem! I kemi dy komisione, dhe komisionet thanë që duhet të miratohet. ... Tri komisione, dhe komisioni që udhëhiqet nga opozita thotë “Komisioni vlerëson që strategjia e sigurisë së Republikës së Kosovës të miratohet”. Bile rekomandimi i dytë s’ka të bëjë me strategjinë, e po ashtu edhe rekomandimi i dytë dhe

rekomandimin e dytë s'po e lexoj, por i pari thotë të miratohet. Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar 7+, fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zotëri kryetar i Parlamentit, doktor Jakup Krasniqi që ma dhatë fjalën!

E përshëndes zëvendësin e kryeministrit,

Përshëndes ministrat,

Përshëndes të gjithë juve, edhe pse po shoh pak kemi mbet.

Unë s'po mundem me kuptua pozitën dhe opozitën kur flasim për strategjinë e Kosovës. Çfarë strategji po lypni? Unë kisha thënë një send, të gjithë që jemi këtu, që ne i mbrojmë të drejtat e Kosovës, që na ka zgjedhur populli. Cilat të drejta? Po këto trupa që jemi kaq shumë, edhe ata jashtë këtij Parlamenti, të bashkohemi, të bëhemi një shpirt dhe kur të vjen puna te interesi i Kosovës të jemi një. S'ka ku të ndahemi, dhe pse ndahemi gabojmë. Opozita thotë një, pozita thotë tjetrën. Unë e di që një jemi krejt kur është interesi i Kosovës. Mirëpo, në këtë mbledhje, në këtë seancë diçka do të flitet, që të jetë njëri, interesant unë e thash këtë, ai e tha këtë, e këtë, e ku të di unë tjera. Unë nuk jam këtu që t'i jap mend dikujt, por jam këtu vetëm të ju them – kur është interesi i Kosovës, të gjithë ne të bëhemi shumë trupa, një shpirt, atëherë do të dalim fitues në tëra anët sepse e kemi dikë pas nesh. E kemi Evropën. BE-në, e kemi Amerikën, e kemi shumë miq tjerë, Kuintin, që ne të jemi të kënaqur dhe jo atyre tash t'u themi ku të di unë, aty e këtu, por një send ta dini krejt, prej askujt nuk domi t'ia marrim 10 centimetër vend, por askujt nuk do t'ia japim 2 centimetra tona, sepse ne jemi që vendosim. E qysh do të vendosim? Sikur që thash më parë, të jemi shumë trupa e një shpirt dhe atëherë kemi fitim. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, deputet Merxha! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, a e ka kërkuar ndokush fjalën? Jo, po më duket! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Mi smo pažljivo razmatrali Strategiju bezbednosti Republike Kosova. Malo smo bili kao grupa, da kažem, zbunjeni zato što u ovoj strategiji, sama strategija opisuje pojedine delove kao što je I. poglavlje posvećeno napretku, gde se daje do znanja koji su sve segmenti napretka Kosovske vlade i ja ću da čitam. Tačka 1. stav 7. kaže: „Siromaštvo, nezaposlenost i nizak nivo obrazovanja su izazovi za socijalno jedinstvo. Visoka stopa nezaposlenosti na Kosovu i veliki broj građana koji žive u siromaštvu najveći su nacionalni izazov. Stvaranje povoljnih uslova za zaposlenje i investiranje direktno su uslovljeni uspešnom borbom protiv korupcije i organizovanog kriminala i obezbeđivanjem vladavine zakona na Kosovu“.

Meni je žao što moram... Mi smo u grupi dosta analizirali ovaj stav i mogu da kažem da je u ovom stavu opisano možda što je opisano dalje u 4, 5 stranica kada je Agencija o korupciji i ostalo... Međutim, ovde samo opisuje situaciju, ne daje nikakva konkretna rešenja. Strategija je rešenje. Znači, ovaj papir nema rešenje. Mora od nečeg da se počne.

II. poglavlje je – jačanja institucija. Svi, verujem da sus vi naši poslanici ovde, kolege, pročitale. Koja je zajednička perspektiva svih nas na Kosovu, kao što je na primer kada se ovo grade, kao što je Savet bezbednosti Kosova, Centar za situacije i Sekretarijat Saveta za bezbednost Kosova, Ministarstvo unutrašnjih poslova i ostali mehanizmi u slučaju vanrednih slučajeva, kao što je Policija

Kosova... ovde možemo samo da pozdravimo da se svuda traži i kod carina Kosova, da se svuda traži zastupljenost, manjinska zastupljenost, međutim kako znamo, i ovde je ostalo samo na papiru. Dobro znamo svi koliko su manjine zastupljene u svim ovim institucijama.

Dalje, kada gledamo odgovornosti agencija i među ministarska saradnja, gde se daje do znanja da stvarno ovde nema ove preko potrebno saradnje.

Kao III. poglavlje, imamo zajedničko rešavanje izazova i mogućnost za napredak, kao što je borba protiv organizovanog kriminala, kao što je borba za vladavinu zakona, borba protiv korupcije, borba za dobro upravljanje i, kao što smo danas imali dva zakona, kao što je za nelegalno nošenje oružja i ostalo i gde se dotiče u ovom napretku privreda, integracija svih zajednica, obrazovanje i istraživanje, nezaposlenost, ponovo, i siromaštvo, poljoprivreda. javno zdravlje i ostalo, Verujte mi... sa nekoliko rečenica je sve ovo tako stavljeno pred nama poslanicima da sam ja sve ovo čitala zajedno sa grupom i ništa nam nije bilo razumljivo. Znači, nema metodu, nema cilj, nema sredstvo. Strategija, mi kao grupa, iako smo deo Vlade, voleli bi da se vrati i da funkcionalne komisije dobro i pažljivo razrađuju i traže od Vlade više konkretna rešenja kada su u pitanje strategije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi edhe 6 deputetë të lajmëruar për diskutim. Po kërkojmë të na kurseni kohën. Do të thotë, ne u morëm vesh për 5 minuta për diskutim. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Me vëmendje e kam lexuar Strategjinë 2010 për sigurinë e Republikës së Kosovës. Më pozitive nga të gjitha është se për herë të parë Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të ketë një strategji për sigurinë. Është bërë kujdes i jashtëzakonshëm në atë çka thuhet në këtë strategji sa që nga kujdesi shumë i madh kjo ka mbetur një strategji që mund të them, në radhë të parë, është një strategji strukturore. Përballja me rreziqet për sigurinë e Kosovës do të bëhet në mënyrë ligjore institucionale. Ajo çka vërehet është mungesa pak a shumë e përmbajtjes autentike për strategjinë e sigurisë së vendit. Pak a shumë, të gjitha shteteve mund t'u shkojë si strategji e përgjithësuar, domethënë si tekst.

Rekomandimet që janë dhënë nga Komisioni parlamentar për punë të brendshme dhe sigurinë, për mendimin tim, i ka dhënë Strategjisë kuptimin e vet, e ka bërë atë më autentike. Kosova më së shumti është e rrezikuar nga rrjetet e interesit që e synojnë kontrollin e ekonomisë dhe resurset e Kosovës, që e dëmtojnë ose ngadalësojnë zhvillimin ekonomik të vendit dhe si aleat e kanë korrupsionin.

Unë me përmbajtjen – amendamentin që është dhënë në këtë rekomandimin numër 2, pajtohem plotësisht. Mos zhvillimi me hapa të nevojshëm ushqen tensionet sociale që është një sfidë tjetër për sigurinë, që gjithashtu, thuhet qartë në Strategji dhe e mbështes, për mendimin tim provë e vërtetë për sigurinë është ekzistimi, përkatësisht është ekstremizmi fetar dhe ekstremizmi kulturor që është identifikuar jo vetëm nga pak njerëz por nga shumë këtu në Kosovë, ndërkaq rreziku i jashtëm nga aktivitetet e ish pushtuesit normalisht se ekziston, por është në rënie e sipër dhe dihet përfundimi i tij, dështimi i tij total në të ardhmen.

Edhe me kaq, unë i përgëzoj hartuesit dhe të gjithë ata që kanë kontribuar për marrjen e formës së strategjisë dhe kështu siç është në tekst. Faleminderit!

Drejtimitin e mbledhjes e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Naim Rrustemi.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë, unë e kam lexuar këtë tekst, më ka pëlqyer aq shumë sa që e kam lexuar nja 3-4 herë. Ishte një tekst, moti s'kam lexuar kaq tekst zbavitës, dëfryes. Dhe, faqen e parë kur e kam lexuar, kjo po them, nëse e shihni këtë paragrafin 3 dhe këto janë fjalët e kryeministrit Thaçi dhe presidentit Sejdiu, thotë se “ky dokument i parashtron objektivat strategjike të sigurisë së shtetit dhe prezanton ministrinë...”, e tjera, e tjera. Kur ta lexoni mirë këtë tekst, do ta shihni që as kryeministri Hashim Thaçi, as presidenti Fatmir Sejdiu nuk e kishin lexuar këtë strategji apo këtë tekst, se përndryshe, nuk kishin për t'i thënë këto fjalë.

Këtu u përmendën, kapitulli III, që ishte me të vërtetë shumë zbavitës, ku thotë “adresimi i përbashkët i sfidave”, që ata që ndonjëherë kanë shkruar apo kanë lexuar strategji, e dinë që rrjedhimisht duhen edhe t'i japin rrugë të zgjidhjes së sfidave, apo caktimin e objektivave dhe mënyrën e realizimit të objektivave.

Dhe, kur t'i lexosh këta nëntituj këtu, s'ke si mos të qeshesh! Që mu tekstin kur ta lexosh, është me të vërtetë një komedi kështu, shumë e mirë. U lexuan këtu, sundimi i ligjit, korrupsioni, e të tjera, e të tjera. Unë sa për freskim, se jemi lodhur, po ua lexoj bujqësinë. Ja se çka shkruan: Është te objektivat, domethënë. Pra, thotë: “Adresimi i përbashkët i sfidave”... që do të duhej të caktoheshin objektivat dhe mënyra se si të arrihen ato objektiva, si të zgjidhen këto sfida. Ja se çka shkruan: “Shumica e qytetarëve të Kosovës jeton në zonat rurale dhe sektori i bujqësisë vlerësohet se kontribuon me 25% të GDP-së së vlerësuar” – Eureka! Për më tepër, thotë: “... është vlerësuar se përafërsisht 25% e punësimit mund të gjendet në këtë sektor, që karakterizohet nga...”, dhe e lexon – lexon – lexon, s'ke qare pa u kthye te faqja 3 dhe ta lexosh këtë që ka thënë kryeministri apo presidenti: “ky dokument i parashtron objektivat strategjike të sigurisë së shtetit” dhe, të vërtetën se, s'e kanë lexuar. Tash dikush mbase e ka nënshkruar fallso, në emër të tyre dhe për këtë jam i garantuar dhe shumë i bindur që nuk e kanë lexuar, se përndryshe po ta kishin lexuar, s'kishin thënë kështu. Për aq sa i njoh, po mendoj nga larg!

Pastaj, edhe këta që e kanë përfunduar, faqe 16, pika 3.19, as këtë s'e kanë lexuar. Ja se çka thotë: “Kjo strategji e sigurisë së shtetit ka identifikuar objektivat”... O, cilat objektiva? Këtu s'ka objektiva! Kurrfarë objektiva këtu s'ka. Ka përshkrime të situatës, të institucioneve, e tjera, e tjera.

Edhe një pyetje e kam. Mbase na kanë prurë këtë strategji ta votojmë në parim, që pastaj më 27 shtator të na e sjellin përsëri për debat. Nëse është ashtu, se është hy në modë kjo strategjia e PTK-së, ndodh e votoj me kusht që të na sjellin me 27 shtator dhe e debatojmë përsëri dhe i marrin të gjitha këto... Përndryshe, këtë strategji nuk mund ta votoj, sepse s'është strategji.

Edhe një. Kështu, si porosi miqësore. Mos ia kallëzoni ndokujt, se qeshë me këtë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Vazhdon deputeti, Naim Rrustemi!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

Vërtet është shumë e vështirë me fol për substancën se çka u shkruar sepse s’e meriton me e diskutua.

Fillimisht, dua të them se ka mundësi që është shkruar në gjuhën angleze, sepse edhe përkthimi është shumë i dobët. Është një përkthim qesharak. Strategji nënkuptohet të jesh në një gjendje, dëshiron me shkua në një gjendje tjetër, kalimi prej një gjendje në gjendje tjetër. Edhe studentët e dinë një gjë të tillë.

Vendosja e objektivave strategjikë! Po asnjë objektiv strategjik nuk është i vendosur këtu.

Me punë të përbashkët, në shërbim të publikut! Po edhe përkthimi nga gjuha angleze është qesharak. Jo veç fjalja e përdorur, por edhe përkthimi është qesharak. Duhet me ua kthye, me u thënë përktheje edhe një herë, një përkthim tekstual nga gjuha angleze. Edhe titujt... edhe titujt e krejt strategjisë janë të përkthyer nga gjuha angleze.

Po unë desha me transmetuar një mesazh shumë të rëndësishëm, që unë mendoj është shumë i rëndësishëm. Edhe në rast se është ndërtuar nga të tjerët, është shkruar nga anglo-folës apo siç jemi mësuar me i thënë – kemi pas mbështetjen e miqve ndërkombëtarë, së paku le të jenë profesionistë ata që e shkruajnë. Se ata e dinë si duhet me e shkruar. Kjo është pak sa, dhe le t’me falë ministri i Punëve të Rendit por është pak sa fyese me trajtua këtë dokument në gjuhën shqipe.

Një fakt tjetër që më ka ra në sy gjatë leximit në gjuhën angleze të kësaj strategjie, shihet në sy është se parathënia, e nënshkruar nga presidenti dhe kryeministri, e vetmja faqe që është shkruar në shqip. Sepse vërehet përkthimi në anglisht i kësaj parathënie tregon se është i përkthyer prej shqipes në anglisht. Materiali i tërësishëm, nga ana tjetër, është e gjitha e shkruar në anglisht, e përkthyer në shqip. Dhe strategjitë nuk mund të implementohen kur nuk ka pronësi mbi dokumentin e prodhuar. Në rast se paraqitet situata kur s’ka pronësi, nuk e ke pa dorën tënde që është punuar në përpilim të strategjisë nuk mund të ketë mundësi që të flasim për implementim të suksesshëm të strategjisë.

Mund ta ketë emrin dhe mund t’ia japim emrin disi në ndonjë fletë që kujt do me i interesuar, por s’janë të interesshme dhe informatat nuk janë shumë të mëdha, janë përshkruese shumica, po kurrësi të trajtohet si strategji.

Sa për humor, kolegu im e përmendi shpesh, por sa për humor po i përmendi disa prej titujve, tituj qesharakë: “Me punë të përbashkët në shërbim të publikut”; “Rendi kushtetues ruajtja e demokracisë”. Nëntituj... Çfarë nëntituj, s’po di qysh me iu thanë, nëntituj. Duhet me i lexuar në versionin në gjuhën angleze, dhe bëjnë kuptim, kanë kuptim, sepse janë kështu slogane – mission statements, që janë të këndshme për vesh, që transmetojnë njëfarë mesazhi. Por në gjuhën shqipe nuk transmeton kurrfarë mesazhi. Ju kisha lutur që mos me trajtuar si dokument fare dhe normalisht se nuk do ta votoj se po më duket e çuditshme pse me votua. Në parim, nëse është në pari me votua, po për parim e me shqyrtuar në leximin e dytë, po.

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, ju vendosni, që e keni mendjen sonte, se s’ka më votim! Vazhdojmë me deputeten Gjylnaze Syla...

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Siguria është parakusht dhe kusht për zhvillimin e shoqërisë së Kosovës. Prandaj, strategjia e sigurisë së Kosovës duhet të jetë një udhërrëfyes për veprimet të cilat duhet t’i ndërmarrin

institucionet e Kosovës për krijimin e një Kosove stabile, të sigurt dhe të prosperuar dhe kjo strategji do të duhej të ishte një udhërrëfyes se si do të integrohemi në NATO, BE dhe struktura tjera.

Strategjinë e kam lexuar me shumë kujdes dhe me vëmendje të veçantë, duke marrë parasysh se kanë kaluar gati 2 vjet e gjysmë nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, vlerësoj se dokumenti është shumë i vonuar pasi ka pasur në ndërkohë kërcënime për sigurinë e vendit.

Çfarë në të vërtetë është ky dokument? Është një përpjekje për t'u bazuar në një koncept modern, që ka të bëjë me sigurimin ose sigurinë e lartë në vend, përmes fuqizimit të kapaciteteve institucionale, bashkëpunimin dhe koordinimin në mes të institucioneve të vendit duke i shfrytëzuar resurset e kufizuara të Kosovës. Kjo natyrisht është një bazë e mirë duke marrë parasysh nevojën për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës një nga një dhe në tërësi.

Gjithashtu, ky bazohet në koordinimin ndërinstitutional dhe në integrimin rajonal e global. Dokumenti përpiqet të identifikojë disa nga kërcënimet si korrupsioni, krimi i organizuar, fuqizimi i aquie-s e tjera.

Megjithatë, draft-strategjia e sigurisë kombëtare është një dokument shumë i përgjithësuar. Duhet të jetë i konkretizuar. Nuk ka asnjë fjalë se si do të zhvillohen politikat e sigurisë në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve institucionale të sigurisë me theks të veçantë të FSK-së e cila, duke marrë parasysh se KFOR-i po e redukton praninë në Kosovë. Drafti është i mangët sepse nuk ka elemente të sigurisë kombëtare.

Paradoksi tjetër është se kemi pasur strategji të ndryshme, si strategjia e veriut, strategjia për menaxhimin e integruar të kufijve. Është dashur të punohet ndryshe. Së pari shkon strategjia e sigurisë kombëtare nga e cila rrjedhin strategjitë që i përmenda. Është dashur të definohet çka është strategjia kombëtare e sigurisë. Dhe po e definoj: strategjia është përdorimi i të gjitha resurseve kombëtare për zbatimin efektiv të planit për siguri; kombëtare definohet përkushtimi për interesat nacionale dhe siguria është liria nga rreziku ose kërcënimi. Me një fjalë dokumenti duhet të tregojë se çka përfshin siguria jonë kombëtare, si është dashur të punohet ose të përpilohet dokumenti. Duhet të definohen qartë interesat vitale të Kosovës, prioritetet kombëtare nacionale, kombëtare të sigurisë dhe objektivat prioritare të sigurisë. Në bazë të tyre, më tej të hartohet strategjia për mbrojtjen dhe ruajtjen e interesave nacionale. Zhvillimi i procesit për strategjinë e sigurisë nacionale duhet të përfshijë katër shtylla: shtylla e parë, përcaktimi i kërcënimeve, gjegjësisht të rreziqeve të sigurisë së Kosovës brenda dhe jashtë vendit; shtylla e dytë është zhvillimi i planit për t'iu kundërvënë këtyre rreziqeve dhe shtylla e tretë është zhvillimi i strategjisë afatgjatë për ndërtimin e sistemit për situri të qëndrueshme.

Kërcënimet për siguri është dashur të definohen qartë në tri kategori: kërcënimet e brendshme, rajonale dhe trans-nacionale. Kërcënimet e brendshme, disa janë identifikuar por janë shumë të mangëta. Janë përmendur mungesa e sundimit të ligjit, shkalla e lartë e papunësisë, korrupsioni dhe krimi i organizuar. Nuk janë marrë parasysh kërcënimet për sigurinë e brendshme të Kosovës, siç është qeverisja jodemokratike, rritja e tensioneve sociale, kufijtë e tejkalueshëm, prezenca e mekanizimeve të sigurisë, të MUP-it të Serbisë dhe strukturave të shërbimeve sekrete të Serbisë në veri. Dhe nuk ka asnjë fjalë për SHIK-un. Unë kisha qenë shumë e interesuar me ditë se si do të zhvillohet lidhur me këto struktura ilegale. Kërcënimet rajonale, është dashur të definohen lidhur me rrezikun potencial që vijnë nga kërkesat për ndryshimin e kufijve në rajon, por edhe kontrabandën në veri, krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe drogës. Kërcënimet transnacionale është dashur të përfshijnë kontrabandën, ekstremizmin, ekstremizmit e llojeve të ndryshme,

terrorizmin dhe krimin kibernetik, megjithëse ky i fundit vetëm përmendet në dokument. Nuk ka asnjë fjalë në dokument për praninë ndërkombëtare, siç është i KFOR-it, EULEX-it, ICO e tjerë, por vetëm nënkuptohet se sektori i sigurisë duhet të ketë një partneritet të gjithëmbarshtëm në ...

(Ndërprerje nga regjia)

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Shiko, regjia për të gjithë e bën këtë, sepse është urdhëruar për 5 minuta dhe s'po kthehem më te ajo.

(Ndërhyrje)

Zonja deputete, nëse e përmbyll fjalën, unë mund ta jap edhe një minutë, por jo edhe dhjetë minuta. Atëherë, thuaj kryetarit të Kuvendit, të lutem. Ai ishte duke e udhëhequr mbledhjen kur u mor vendimi për 5 minuta. Vazhdojmë me diskutuesen e fundit, Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Pas gjithë debatit i cili u bë, mendoj se edhe një herë kemi nevojë t'i sqarojmë disa çështje. Ju lutem, qetësi pak!

E para, mendoj se dokumenti si i tillë duhet sqaruar edhe një herë, se si shtetet e ndryshme në botë e kanë të organizuar çështjen e strategjisë së sigurisë. Zakonisht në shumë shtete ky dokument bëhet në formë të një letre të bardhë dhe punohet nga komisionet apo grupet e caktuara të cilat në raste të caktuara i raportojnë presidentit të shtetit apo qeverisë dhe veprimet e tilla i harmonizojnë në mes veti. Shtete të rralla janë ato të cilat i debatojnë në parlament dhe marrin pëlqimin nga parlamenti për implementimin e një strategjie të tillë. Mirëpo, ligji i cili është ekzistues në Kosovë e obligon që strategjia e tillë pasi që kalon në qeveri të silllet në Parlament dhe të debatohet.

Befasohem me disa deputetë që presin që strategjia si e tillë dhe një strategji e sigurisë të përfshijë në vete elemente apo, të them, detale të cilat do të përshkruhen në imtësi se si do të hartohet një strategji e caktuar, si do të organizohet një veprim apo si do të ndërmerret një aksion i caktuar për të luftuar një dukuri të caktuar që e cenon sigurinë e shtetit tonë.

Pres dhe është rregull që pas një strategjie të krijohet një plan i veprimit nëpërmjet të cilit do të luftohet dhe integroheshin të gjithë mekanizimet e shoqërisë që janë në Kosovë në mënyrë që të luftohet një dukuri e caktuar.

Befasohem nga disa deputetë kur e përmendën fushëveprimin dhe situatën në të cilën është Agjencioni i Kosovës për Inteligjencë dhe nuk besoj dhe e nuk shpresoj se deputetët janë që gjërat e tilla që i takojnë Agjencionit të Kosovës për Inteligjencë do të duhej të bëheshin publike. Dhe është larg mendjes që një gjë e tillë të bëhet e njohur për opinionin.

E dyta, u përmend çështja e bujqësisë. Mendoj se edhe bujqësia sikur të gjithë sektorët tjerë, janë përfshirë në këtë strategji sepse sot në botë nuk luftohet vetëm me pushkë dhe me armë, por luftohet edhe me armë biologjike dhe me armë kimike të cilat janë edhe më të rrezikshme se sa armët e zjarrit, të cilat i dimë. Por për këtë arsye përmendet bujqësia sepse jo pak, besoj, deputetët e dinë se një ndër luftërat më të rrezikshme në botë bëhen me virusin e antraksit i cili është mjaft i rrezikshëm dhe e kërcënon b botën në përgjithësi.

Edhe një vërejtje e pata, për të dy deputetët, për Dritonin dhe për Naimin. Unë këta i di si ekspertë, po e them “ekspert” nën thonjëza për ekonomi, por sot na dolën edhe ekspertë për siguri. Nganjëherë po më duket sikur, kur ka qenë një seri më herët, “Mapet Show” dy pleq të cilët njëri qet e tjetri pret dhe e plotësojnë dhe kombinojnë vetveten dhe i japin aq shumë të drejtë vetes të flasin dhe të deklarojnë edhe për çështje të sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zonja deputete! Unë nuk kam rrugë tjetër, vetëm në njëfarë mënyre ta përjashtoj veten nga udhëheqësi, sepse kisha kërkuar fjalën të diskutoj lidhur me këtë pikë derisa kryetari e udhëhiqte seancën dhe nuk po dua t’ia marr këtë të drejtë vetes, që me rregullore më lejohet.

Unë po dua, shumë i liruar nga pozicioni i të qenunit opozitar dhe aspak i ndikuar nga ato që dëgjova deri më tash, me të vërtetë kam bindjen se fjala strategji është fjalë e madhe, është dokument, mandej për një çështje tepër jetike qysh është fusha e sigurisë dhe nuk konsideroj se janë inkorporuar në këtë strategji, sa pash unë, vetëm me një paragraf dhe atë jo paragraf në fakt po me një sentencë, me një fjali të zgjeruar segmentet komplementare të sigurisë në Kosovë të cilët e dimë të gjithë cilat janë, e ato janë determinantë që do të duhej të zinin vend në këtë strategji ose kjo strategji do të duhej të harmonizohej me fushat që mbulojnë edhe KFOR-i, edhe EULEX-i edhe segmente tjera. Domethënë ato përmendën veç shkarazi dhe kjo nuk të lë pastaj, ose është bërë me qëllim duke ditur ndjeshmërinë e këtij sektori që aktualisht... domethënë ndjeshmërinë dhe mungesën e kompetencave të plota që kanë institucionet e vendit në këtë fushë, ose thjeshtë është mungesë e kësaj strategjie, por kjo nuk mund të shkojë kësaj me një fjali të vetme e tërë kjo.

Pastaj, po dua, por që zoti kryetar i funksional nuk është prezent. Ai na e çon një dokument me rekomandime dhe nuk e shkruan edhe një fjali të vetme që do të duhej të zë vend në këto rekomandime, që të na bëjë thirrje ta miratojmë. Shumë interesant, nuk është fjalia që na fton ta miratojmë si deputetë. Vetëm i qet rekomandimet.

Ndërkaq, komisioni tjetër na e bën një rekomandim tepër të përgjithësuar – Komisioni për Agjencionin e Inteligjencës. Rekomandimi i parë na fton ta miratojmë, rekomandimi i dytë thotë duhet të ndërtojë sa më shpejt kapacitete. Ne të gjithë e dimë që duhet të ndërtojë, po a mjafton ky formulim që të futet si rekomandim në Kuvend, se është tepër i përgjithësuar.

Domethënë, këto ishin pa dashur me komentuar asgjë që dëgjova këtu, e që s’kam edhe të drejtë me komentua, me këto vërejtje në njëfarë mënyre e rezervoj që të kam qëndrim se Kosovës i duhet strategji e sigurisë por i duhet edhe seriozitet në hartimin e kësaj strategjie, që kjo si e tillë fort s’ma mbush mendjen se ne si deputetë ndihemi komodë kur dalim pas kësaj seance se kemi bërë një dokument të qëndrueshëm me të cilin mund ta përkthejmë edhe në gjuhë të huaja, që dikush tha është përkthyer prej andej e këndeje, por ne duhet të llogarisim që ky përkthehet menjëherë si i tillë dhe a është i dinjitetshëm për një shtet që pretendon me qenë demokratik dhe funksional, është çështje që duhet të na shti me menduar të gjithëve.

Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministri. E keni fjalën, i nderuari zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni shumë shkurtimisht t’i them tri-katër gjëra, edhe pse tash është vonë, lidhur me strategjinë por edhe me qasjen për këtë strategji.

E para. Për Qeverinë duket shpeshherë që është më së lehti me prezantuar strategjinë, se janë gjërat e përgjithësuara. Ndërsa, mendoj se për opozitën është më së lehti me kritikuar strategjinë. Unë mendoj që këtu, në mes të këtyre dyjave, ka diçka të vërtetë.

Nëse më lejoni, dua të them se kjo strategji është rezultat i kompromisit dhe gjendjes së sigurisë në Kosovë. Gjendja e sigurisë në Kosovë nuk është vetëm në Qeverinë e Republikës së Kosovës ose nuk është kompetencë vetëm e jona por edhe e të tjerëve.

Ne kemi bërë kompromis në këtë strategji dhe me të drejtë dikush e tha, është përkthyer prej asaj ane në këtë anë, por nuk kisha thënë se vetëm është përkthyer, por është negociuar për dokumente të tilla.

Zoti Xhemajli e tha me të drejtë në një fjali. Tha duket që ka pasur një kujdes të shtuar. Dhe unë jam i bindur, pajtohem plotësisht, kujdesi i tillë ka lënë edhe disa fjali mangu. Prej frikës që ne mund t'i tejkalojmë limitet e parapara, janë mbetur edhe disa fjali mangu. Ajo çka duhet të them, me një fjali, krejt vërejtjet që i tha opozita me bë me hy në këtë strategji, gjë nuk e ndryshojnë.

Shikoni, nuk e ndryshojnë logjikën e sigurisë së këtij vendi. Nuk e ndryshojnë absolut. Mund të kenë përmbajtje në formë, në sintaksë por nuk e ndryshojnë strategjinë. Dhe ajo çka dua të them sot, është mirë që në strategji të tilla Kuvendi të shkojë pak më shumë se Qeveria.

Unë ju ftoj ju, që në momente të caktuara për veprime të tilla shkoni pak më shumë. Përndryshe, vërejtjet që u thanë sot, jemi të gatshëm t'i inkorporojmë që të gjitha. Asnjë vërejtje nuk e tangon aspektin e kësaj strategjie.

Dhe krejt në fund, më lejoni të them edhe këtë. Në vlerësimin që u tha sot, ka vlerësim nga këndi i pozitës dhe opozitës. Po bëj pak shaka, komisionet duket kanë pirë kafe edhe janë pajtuar. Ju do, që s'keni pi kafe, keni mbet ende pa u pajtua. Po unë besoj se, është fjala me faktorin ndërkombëtar. Mos të keqkuptohet këtu. Ndërsa, ju të tjerët, unë besoj, në momente të caktuara ta tangoni strategjinë si strategji dhe logjikën e sigurisë në Kosovë që unë mendoj duhet të jetë më e avancuar se sa ajo që e kemi afuar ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Diskutues tjerë nuk kemi të paraqitur, veç se kemi dy që kanë reaguar me vonesë për replikë. Nga një minutë replikë, dy deputetëve! Driton Tali, i ka apostrofuat...

DRITON TALI: Unë, sinjerisht po e ftoj çdokënd që merr vesh pak në kësi sende, unë po flas në strategji, s'po flas në aspektin e sigurisë, po të strategjisë, mënyra e të shkruarit, nëse kësaj i thonë strategji, krejt OK. Atëherë, paskemi diçka dallim në kuptimin e edukimit. Ku ta dimë çka keni mësuar këtu në fakultetet e Kosovës, nëpër bodrume.

Po nëse, zonja Mimoza thotë se kjo është strategji, unë pajtohem se i ka flokët e bardha dhe e kam teze, s'mund t'ia prishi qejfin asaj.

KRYESUESI: Zoti, Naim Rustemi, e do fjalën, për një minutë!

NAIM RRUSTEMI: Fare shkurt, do ta marr fjalën. Dokumenti nuk mund të quhet strategji se s'ka mundësi me u quajt.

Deputetja mund të manipulojë me fjalë ose ndoshta tash së voni i ka shkuar në mend të lexojë diçka çka është strategjia, çka është plani i veprimt. Por, nëse strategjia, me definicion jepet, nuk jepet qysh ta merr ty mendja. Je në një gjendje aktuale, je në një gjendje të dëshirueshme, të gjitha veprimet i merr janë veprime strategjike për me shkuar në gjendjen e dëshirueshme. Edhe kur e kemi pasur bisedën te objektivët strategjikë. Objektivët strategjikë janë diçka metrike, të matshme. Nëse nuk janë metrike, nuk janë të matshme, nuk mund të jenë objektivë strategjikë. Por Kuvendi nuk duhet me u trajtua dhe me u sjell në situatë të tillë ku duhet me u trajtua çështjet nga aspekti shumë shkollor. Paraprakisht, para se me ardhë, nëse do me diskutua, është mirë me qenë i pajisur me së paku dije minimale rreth teknikave për....

(Ndërprerje nga regjia)

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Faleminderit! Ju falënderoj për debatin e nxehtë që e keni pasur, por tash duhet të shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim...

(Ndërhyrje)

76 deputetë janë të pranishëm. E votojmë Strategjinë me rekomandimet e komisionit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Faleminderit! Me 45 vota “për”, 19 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës me rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për rishqyrtimin e ankesave

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të flas në emër të Komisionit, po edhe në emër të Grupit Parlamentar, në përkrahje të rekomandimeve të Komisionit, me qëllim të sqarimit të këtij propozimi por edhe të përmirësimit të performancës time në raportet e KDI-së dhe rritjes së notës, ndoshta i kaloj këta të Mapet Show-ut këtu.

Në bazë të nenit 78 të Ligjit Numër 03/1, qysh thonë këta të Shqipërisë, për administratën tatimore dhe procedurat e Rregullores së punës të Kuvendit, Komisioni për buxhet e financa, në mbledhjen e mbajtur më datë 2.9.2010 shqyrtoi Propozim-vendimin e Qeverisë së republikës së Kosovës, të datës 02.07.2010 për emërimin e anëtarëve të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave dhe Kuvendit i paraqet këtë

REKOMANDIM:

I rekomandohet Kuvendit që të miratojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave, si në vijim:

- Arben Canolli,
- Sami Leshi,
- Arben Avdiu,
- Agim Bivolaku,
- Nexhat Hasani,
- Përparim Hoxha,
- Lulzim Zeka,
- Afrore Rudi,
- Faik Çollaku dhe
- Ismajl Kovaç

Dua të jap një sqarim, se Komisionit për Buxhet e Financa dhe Kuvendit i ka ardhur edhe një propozim para këtij propozimi që Komisioni e ka refuzuar për shkak se propozimi i Qeverisë nuk ka qenë në përputhje me nenin 78 të Ligjit të prokurimit publik dhe pikërisht për shkak të kësaj ne jemi detyruar ta refuzojmë dhe Qeveria ka proceduar një propozim të dytë dhe që është në përputhje me Ligjin, rregullat dhe kriteret që janë të vendosura lidhur me zgjedhjen e këtyre anëtarëve të Bordit. Paragrafi 3 i këtij ligji thotë se 7 nga 16 anëtarët e Bordit të ankesave duhet të jenë nga fusha e biznesit dhe pikërisht kjo ka qenë arsyeja e refuzimit të propozimit të parë dhe në propozimin e dytë është plotësuar ky kusht ligjor dhe Komisioni me shumicën e votave, me përjashtim të dy votave abstenuese dhe një kundër, e ka miratuar këtë propozim dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë sot në këtë seancë, prandaj lus deputetët që ta votojnë.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë me grupet parlamentare, apo a do kush ta marrë fjalën? Jo. Atëherë, votojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën Gjylnaze Syla, apo Ardiani.

ARDIAN GJINI: Duhet të diskutojmë kryetar, mos na paragjyko kështu!

Para se të kaloj te kjo, duhet të ju them se nëse kishte me ndodhë diçka e ngjashme çka ndodhi më herët prej deputetëve të opozitës kishit me kërkuar me tërheq fjalë, kishit me kërkuar me u përmbajt prej fjalëve fyese dhe kualifikimeve dhe para jush, udhëheqësi i seancës e edhe ju sa jeni këtu, ka qenë dashur me ia vë veshin pak kur flasin deputetët e partive në pushtet dhe kur bëjnë kualifikime për deputetët tjerë dhe duhet me kërkuar edhe prej tyre me tërheq fjalën.

Meqenëse nuk e kam në plan me i përsërit fjalët që i thanë dy deputetët të Partisë Demokratike, merreni transkriptin e lexoni, dhe herën tjetër kërkoni prej tyre me u tërheq prej fjalës që e thanë për dy deputetë tjerë. Unë nuk dua me u bë avokat i tyre, por vetëm po ju them se kur po ndodh prej nesh, po bëhet nami në Kuvend.

Tash po kaloj te kjo, për çka jemi ardhur me folë. Sikur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës t'ish kërkuar me votua një nga një për këta kandidatë që na janë sjell këtu, për disa kishin me votua. Mirëpo, këta votohen an-blok dhe Ligji për administratën tatimore thotë se duhet me qenë profesionistë, e në mes të këtyre që i keni sjell ju ka edhe të atillë që thonë – jam i papunë dhe mund t'ia nis punës nesër, se kam nevojë për punë. Domethënë, nuk është çështje e opozitës, prapë po ju them, por nuk mundet Kuvendi me vota me thye ligjin kësaj dhe me pritë prej nesh me iu bë servis thyerjes së ligjit. Pse pos qellni kesi lista të njerëzve këtu? Pse nuk po ia vëni veshin vet pak. Domethënë, nuk guxojmë me kalua kështu shpejt e shpejt kur në listë të njerëzve kemi njerëz që kërkojnë punë në institucione tepër të rëndësishme dhe më vonë na del që këta njerëz bënë vaki edhe iu bëjnë favore bizneseve kur i qesin në komision, se ku e dimë na që këta po lypin punë. Këta njerëz nuk kanë me hëngër ndoshta. Dhe vetëm për me hy në punë lypin me qenë në komisione të cilat janë tepër të rëndësishme për funksionimin e atyre elementeve që na i votuam pak më përpara në strategjinë për siguri nacionale. Na thamë se duhet me pas kujdes me funksionim të institucioneve, me luftua korrupsionin, ekonominë jo formale, administratën e shtetit dhe çka bëjmë tash, çka bëjmë tash menjëherë me vota. Domethënë nuk ka koment që jemi kundër. Nuk është mirë me bë kështu. Nuk është mirë as me iu tërheq vërejtjen kur fyejnë dhe nuk është mirë me votuar lista të cilat e thyejnë ligjin drejtpërdrejt dhe Aleanca nuk i bëhet dëshmitar as nuk i bëhet mbështetje kësaj forme të punës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo, nuk ka sqarim! Unë sa kam qenë, realisht nuk kam dëgjuar... Shiko, unë po flas që sot, sa unë e kam udhëhequr, nuk ka pasur fyerje dhe po më vjen keq që ka ndodhur dhe realisht është mirë ta korrigjojmë secili nga pak fjalorin, se kemi nevojë. Dhe, sidomos të kemi një mirësjellje kur bëjmë debat me njëri-tjetrin, se debati mund të bëhet me fjalë të ashpra, me fjalë të rënda, por mund të thuhet me fjalë edhe më intelektuale, pak më me kulturë, pak më me edukatë, pak më njerëzisht mund të thuhet edhe mendimi i kundërt. Është mirë t'i kërkonit të dyja, edhe pozita edhe opozita fjalët pak më të zgjedhura. Vazhdojmë. AKR, nuk e ka kërkuar fjalën. Në emër të LDD-së Drita Maliqi e ka kërkuar fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, pas shqyrtimit të listës së kandidatëve me biografinë e tyre të propozuar nga Qeveria për emërimin e tyre në Bordin e pavarur për rishqyrtime, nuk e mbështet, me arsyetim të vetëm, edhe pse ka edhe arsye të tjera që u thanë edhe nga grupe tjera paraprake parlamentare, se nga Qeveria aktuale injorohet Ligji për barazi gjinore, sipas mendimi tonë, dhe vlerëson se nga kandidatët e propozuar nuk është përmbushur përqindja e cila parasheh, domethënë ky ligj shumë i rëndësishëm në Kosovë, që nga kjo qeverisje aktuale, domethënë edhe më tutje shkelet, ku parashihet, që e pamë edhe nga propozuesi i mëhershëm se vetëm një femër, do të thotë, është e propozuar dhe faktikisht ne kemi menduar dhe vlerësuar se minimumi ka qenë dashur të jetë 30% deri 40% pjesëmarrja e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Gani Koci, veç me fjalë të zgjedhura.

GANI KOCI: Do të përpiqem t'i përzgjedh, e nganjëherë nuk po i shoh se s'i kam syzat. Propozimi i parë është kthyer pikërisht nga komisioni për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të ligjit. Propozimi i dytë është në përputhje të plotë me kriteret që i kërkon Ligji për të qenë anëtar i këtij bordi për shqyrtimin e ankesave. Sa i përket asaj që ka një kandidat që e përcakton dhe e paraqet në biografinë e tij gjithë punën që e ka bë po aktualisht është i pa punë, ka një arsye sepse ky është i komunitetit turk dhe është përfillur pikërisht ajo përfshirja e komuniteteve në bordet e tilla, por po harrojmë se ka edhe 6 anëtarë që janë të zgjedhur dhe nuk di a e dini se sa prej tyre janë gra ose burra, po them tash.

(Ndërhyrje: A e di ti?)

Po e di, por të kallxoj kur të jemi në komision atje...! Prandaj, ky propozim duhet të miratohet se e plotëson edhe atë kriter që e përmendi zonja atje, zonja deputete, por edhe kriterin e etnitetit në këtë rast të komuniteteve pakicë në Kosovë.

KRYETARI: Faleminderit! Diskutuesja e fundit është deputetja Gjylnaze Sylja. Deputete, e keni fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, kryetar!

Unë, realisht e mora fjalën për të shtruar mocion procedural dhe ka të bëjë pikërisht me ju.

Më vjen mirë që u kthyet. Ju ftoj që Rregulloren ta respektoni, si kryetar i Kuvendit. Ju bëtë shkelje të Rregullores kur caktuat diskutimin 5 minuta pa kërkuar votimin nga seanca. Zoti kryetar, si kryetar i Kuvendit, nëse keni dashur që diskutimi të zgjasë 5 minuta, është dashur ta vëni në votim dhe të merrni aprovimin e seancës.

Unë ju ftoj për hir të mbarëvajtjes dhe të jeni shembull për deputetët tjerë, që mos ta përsërisni këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë mendova që jeni dakord edhe ju dhe unë dhe po e tërheq atëherë, se realisht kam menduar se është edhe pëlqimi juaj. Po më vjen keq, dhe unë po kërkoj falje për këtë.

Vazhdojmë dhe shkojmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë janë 74 deputetë.

Me 41 votë “për”, 23 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët e Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave, me mandat dyvjeçar sipas Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me nominimet për Bordin për Ankesa të Mediave nga Gjykata Supreme e Kosovës

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media e ka shqyrtuar Propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

Nganjëherë edhe lektori këto duhet t’i marrë e t’i rishikojë! Fjalën do t’ia jep kryetarit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, deputetit Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Në pajtim me Rregullën 41 dhe 46 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional, në mbledhjen e mbajtur më 8 shtator 20010, pas

shqyrtimit të propozimit të Gjykatës Supreme për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave, vendosi që Kuvendit t'i paraqet rekomandimin:

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave:

- Avdi Dinaj, dhe
- Visar Morina.

Komisioni e ka shqyrtuar listën dhe konstatoi se për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave nuk ka asnjë pengesë ligjore.

Sa për informim dhe për t'i përkujtuar kolegët deputetë, ne njëherë si Komision para kësaj liste, e kemi kthyer një listë prapa duke qenë se ka pasur konflikt interesi.

Unë ju ftoj që të votohen këta dy persona, sepse është shumë e nevojshme edhe për Komisionin e Pavarur për Media. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën po ia jap menjëherë deputetit Ardian Gjini, nga AAK.

ARDIAN GJINI: Shumë shkurt! Faleminderit, zoti kryetar!

Në të njëjtën frymë, nuk mund ta votojmë, nuk mund të jemi pjesë e kësaj forme të vendimmarrjes. Nuk mendojmë se këta njerëz mund ta kryejnë punën si duhet në bord. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe Nait Hasani e ka kërkuar fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Kryetar, unë i shoh këtu këta emra që kanë ardhur, e në biografinë e tyre njëri nga ta thotë: Prej vitit 1977, kur kam filluar me punuar, asnjëherë më parë nuk kam ra në kundërshtim me ligjin.

Është mjaft interesant... Të lutem, kryetar! Ajo ishte letra motivuese që e ka shtua kandidati. Më tutje, thotë: Jam nga Mitrovica e Titos... Dhe me vulë: Sekretari krahinor, Vesel Latifi.

Të lutem kryetar, unë kërkoj që t'i rikthehet Qeverisë dhe të zgjedh mundësinë më të mirë të kandidatëve. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, kryetari i Komisionit e dha mendimin dhe mendimin e gjithë deputetëve të grupeve parlamentare. Në sallë kemi 72 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash vendimin e Qeverisë.

Konstatoj se me 41 vota "për", 21 "kundër", 5 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët e Bordit për Ankesa të Mediave, me mandat trevjeçar, si vijon:

- Avdi Dinaj, ish gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe
- Visar Morina, ligjërues universitar.

Mirë u pafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës